



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2017 DHE 25 JANAR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. DECEMBRA 2017. I 25. JANUARA 2018. GODINE**

**DHJETOR/JANAR - DECEMBAR/JANUAR
2017 - 2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,
5. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016,
7. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës vjetore për vitin 2018,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o socijalnim preduzećima,
5. Razmatranje Izveštaja institucije Narodnog advokata za 2016. god.
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja rada Fonda penzijske štednje Kosova za 2016. god.
7. Razmatranje zahteva Fonda penzijske štednje Kosova za usvajanje godišnje takse za 2018,
8. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za jednog (1) člana borda RTK-a iz redova srpske zajednice,
9. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za člana Borda za žalbe.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës që e ka përgatitur Kryesia e Kuvendit me pëlqimin e grupeve parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2017.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Fjalën e ka kërkuar Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.
Urdhëro, Avdullah!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit kryesues i seancës, nënkryetar i Kuvendit, zoti Shala,
Të nderuar deputetë të pranishëm,
Anëtarë të Qeverisë,
Çështja që unë sot dëshiroj të ngre para jush lidhet me mënyrën se si po shpenzohen mjetet nga rezerva shtetërore.

Ju informoj që shuma e mjeteve të ndara nga rezerva vetëm për dy muaj, pra 15 shtator deri 15 nëntor të këtij viti është rreth 2,5 milionë euro. Me këtë trend, rezerva shtetërore duhet të jetë së paku 15 milionë brenda vitit për t'i akomoduar të gjitha këto ndarje buxhetore. Në çdo mbledhje të Qeverisë, mesatarisht ndahen nga 200 mijë euro.

Ne i kemi analizuar të gjitha vendimet e Qeverisë për ndarjen e këtyre mjeteve dhe vlerësojmë që është shqetësuese se si po shpenzohet paraja publike. Paraja publike po përdoret për qëllime jopublike, jo të interesit publik dhe jo në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Neni 29 i këtij ligji e specifikon qartë që në rast se ndodh një ngjarje për të cilën kërkohen shpenzime urgjente, atëherë organizata përkatëse buxhetore duhet të aplikojë te ministri për mjete shtesë dhe në aplikacion duhet të sqarohen rrethanat se si është shkaktuar ajo ngjarje, të shpjegohen arsyet për këto ndarje shtesë dhe të tregohet se pse ajo ngjarje nuk ka qenë e mundur

të parashikohet më përpara. Fillimisht të identifikohen fondet e mundshme që mund të alokohen për atë qëllim brenda organizatës dhe pastaj çështja t'i përcillet për vendim Qeverisë, pas një analize dhe arsyetimi që e jep Departamenti i Buxhetit për ministrin e Financave.

Ne kemi e parë që plot vendime nuk janë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe vlerësojmë që kjo shkelje e Ligjit të Buxhetit, Ligjit të menaxhimit të financave publike është tejkalim i kompetencave nga kryeministri dhe Qeveria, sepse është vetëm Kuvendi i Kosovës ai që mund të bëjë ndarje buxhetore në kuadër të ligjit vjetor të Buxhetit.

Ne shqetësohemi me këtë trend të ndarjes së mjeteve nga rezerva, sepse ju garantoj që kjo do të nxisë mosbindjen nga qytetarët kur ta shohin se si po përdoren taksat e tyre.

Unë i kam të gjitha vendimet që i ka marrë Qeveria në dy muajt e fundit për ndarje të këtyre mjeteve, të cilat do t'i keni në dispozicion të gjithë deputetët, mediet, shoqëria civile dhe qytetarët. Ju do ta shihni arsyeshmërinë ta zëmë të ndarjes së mjeteve nga rezerva për fëmijët në komunën e Leposaviqit për festat e fundvitit, ose për oborrin e një shkolle atje në Leposaviq, ose për nevoja nga më të ndryshmet, gjë që bie ndesh me nenin 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputetja Xhevahire Izma. Në emër të grupit, apo...?

Atëherë, së pari ia jap fjalën kryeministrit.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Hoti,
Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues, zoti Kujtim Shala,

Qeveria e Kosovës në vazhdimësi do të ndajë mjete për qytetarët serbë të vendit në të gjitha pjesët e Kosovës, po me fokus në veri. Nëse duhet thënë motivin, po ju tregoj që Gjermania Perëndimore ende investon në Gjermaninë Lindore. Nëse kjo nuk mjafton për ju si motiv i drejtë, mund të vazhdojmë diskutimin e ndërsjellë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj që kjo pjesë nuk do të llogaritet në kohë të shpenzuar, do të thotë do ta zgjasim me që 30 minuta janë vetëm për deputetët. Zoti Hoti ka kërkuar replikë,

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ndarjet buxhetore bëhen me Ligjin vjetor të Buxhetit, mjetet që ndahen në rezervë janë në diskrecion të Qeverisë për të ndarë mjete sa herë që e sheh të ndejshme, në përputhje me nenin 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe ne e kemi vlerësuar që disa nga ato,

pajtohemi plotësisht, ta zëmë një shkollë që është djegur në Mitrovicë, ose çështja e sëmundjes së gjedheve për kompensim të dëmeve, ose ta zëmë ndihma që është dhënë në Luginën e Preshevës për renovimin e një shkolle, ose për veteranët dhe invalidët e luftës për shpenzimet për proteza, janë të arsyeshme, pra janë ngjarje të cilat nuk parashikohen. Të tjerat ndarje buxhetore janë në Ligjin vjetor të Buxhetit dhe çdo mjete që ndahet nga rezervat duhet të jenë në përputhje me nenin 29 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, e plot vendime të Qeverisë nuk janë në përputhje me këtë nen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma. Të lutem, deklarohu në emër të grupit, apo në emrin personal. Faleminderit!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues! Unë flas personalisht, nuk është në emër të grupit.

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të vendit,

Ditë më parë në një edicion lajmesh në mbrëmje të gjithë e pamë një informacion kur një nxënës shtatëvjeçar i nxirren flokët nga mësuesja e klasës me justifikimin e turpshëm se kishte ndodhur në afekt pasi fëmija nuk po arrinte ta kuptonte mësimin edhe pas shumë përsëritjeve të mësueses, gjoja mësuese.

Aq më keq kur në intervistimin që e kishte bërë gazetarja, edhe drejtoresha e shkollës, e cila për fat të keq edhe ishte grua, me deklaratën e saj ajo e kishte më të rëndësishme të rrëfejë që mësuesja qenka shumë në nivel, e ngjarja e ndodhur, kur fëmijës i kishin mbetur flokët mbi krahë, mbeti periferike.

Kjo paraqitje e imja u nxit nga kjo storie, por kjo nuk është e vetmja. Aq shumë kemi brenda vitit të tilla raste, e në të cilat asnjëherë të vetme, unë së paku s'kam marrë informacion nga inspektorët e arsimit se çfarë ndodh më tutje me raste të tilla.

Kemi raste të sjelljeve joadekuate të mësueseve edhe në çerdhe. Për shembull, rasti tjetër ku një fëmije i ndalohet ushqimi, pse ai ia kishte zënë ulësen një shoku dhe detyrohet të shikojë fëmijët tjerë duke ngrënë, si shenjë dënimi për sjelljen e tij.

Unë sinqerisht nuk e di se çfarë po bëjnë inspektorët e ministrisë, apo disa nga ta e kanë hallin si ta rehatojnë veten nëpër universitete duke shantazhuar me institucione me zyrtarë, por kjo është një temë tjetër, të cilën do ta trajtoj në radhën tjetër.

Dhuna nëpër shkolla nuk vjen gjithmonë vetëm nga mësuesit, është edhe e kundërta, me ç'rast kërcënohen mësime të tjerë nga nxënësit e përgjegjshëm dhe prindër ose të afërm të tyre.

Pastaj, edhe rastet e fundit kur kemi disa fatkeqësi, edhe vrasje, nga sjellja dhe raportet e vetë nxënësve në mesin e tyre, e ku si duket roli i psikologëve është tejet i padukshëm.

Ne si ligjvënës nuk arrijmë ta kuptojmë se deri ku shkon intervenimi i organeve tona kompetente ndaj personave që ushtrojnë dhunë, qoftë ndaj fëmijëve të vegjël, në radhë të parë, dhe pastaj atyre që abuzojnë me pozitën e drejtorëve, duke e mbrojtur me çdo kusht stafin sepse duan të kenë rahat për pozitën e tyre.

Në reagimin që pata po atë mbrëmje në llogarinë time në Facebook mora shumë mesazhe, kryesisht nga nënat e fëmijëve, që i kanë në çerdhe ose në shkolla fëmijët e tyre dhe ndeshen me raste të tilla, e ku vërejnë sjellje të papërshtatshme ndaj fëmijëve dhe as që guxojnë t'i paraqesin ato, sepse ndaj fëmijëve të tyre pastaj shtohet presioni i dyfishtë.

Po ashtu, me dhimbje pashë komentet nga mësime të tjerë, që në një formë ose tjetër justifikojnë veprimet e tilla me arsyen se “ju nuk e dini me çka përballlemi ne dhe çfarë fëmije na sjellin, të padisiplinuar dhe të pamëshueshëm në klasë tona”.

Respekt për secilin mësime të tjerë se çdo ditë të jetës i falë dije një fëmije, me përgjegjësi për punën e tij aq të vlefshme për shoqërinë, por asnjëherë aspak tolerancë nuk do të ketë ndaj atyre të cilët abuzojnë me detyrën e tyre dhe e marrin rolin e një gardiani për t'i tmerruar fëmijët për tërë jetën. Sigurisht që sot është vetëm një fjalë e imja, e cila do të kërkojë vëmendjen tuaj.

Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar kryeministër,
Dhe ju përgjegjës të Arsimit në çdo nivel,
Por, unë do ta inicioj së shpejti një debat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku. Urdhëro!

LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Ka disa ditë që ministri Lekaj, e di edhe një zëvendësministër, nëpër medie dhe në seancën e kaluar të Kuvendit deklaroi se Qeveria e Kosovës do të paguajë ndëshkime në shumë prej 63 milionë euro për keqmenaxhimin tim dhe të Qeverisë së kaluar të projektit kryesor kapital në Kosovë, autostradës Prishtinë - Hani i Elezit.

Deklaratat e tij, përpos që janë jokonsistente, tregojnë edhe paaftësinë për t'u përballur me vështirësitë në ministri.

Në fillim deklaroi se do t'i paguajmë, e pastaj ndryshoi se ka kërkesë për t'i paguar, pastaj na frikoi në Kuvend se Arbitrazhi do të kushtonte sa Buxheti i Kosovës.

Sic kam sqaruar shumë herë në medie dhe në Kuvend, kontrata për ndërtimin e autostradës Prishtinë - Hani i Elezit është nënshkruar më 2 korrik 2014, që do të thotë më shumë se pesë muaj para se të emërtohet Qeveria e kryeministrit Mustafa.

Për menaxhimin e këtij projekti, dy vjet më parë, përkatësisht më 12 qershor 2012 është themeluar Komisioni Drejtues Ndërmintor për Zhvillimin e projektit, në përbërje të ministrit të Infrastrukturës, Financave, Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë e Industrisë dhe Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.

Për menaxhim operacional teknik, Komisioni Drejtues Ndërmintor e ka themeluar njësinë për zbatimin e projektit nga shërbyes civilë në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës, kurse për mbikëqyrjen e projektit është kontraktuar kompania konsulente, "Hill International".

Kjo strukturë e vendosur garanton përfshirje të gjithanshme të Qeverisë dhe mundëson realizim profesional ligjor dhe kontraktual të projektit.

Me përgjegjësi të plotë deklaroj se sa i përket menaxhimit teknik operacional, punëkryerësi "Bechtel&Enka" nuk e ka humbur asnjë minutë në punishte dhe kurrë nuk ka kërkuar as që mund të kërkojë ndonjë cent nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sa i përket aspektit financiar, duhet theksuar se të dyja palët, edhe Qeveria e Kosovës edhe "Bechtel&Enka" kanë hyrë në mirëbesim në një marrëveshje, duke ditur paraprakisht se mund të kenë vështirësi në përmblylljen e anës financiare të saj në përputhje me afatin e kontraktuar prej tre vjet e gjysmë.

Duke marrë parasysh se për periudhën 2014-2016 kanë qenë të parapara vetëm 285 milionë euro, kurse kontrata është nënshkruar në shumë prej 600 milionë euro, e cila ka mundur të rritet edhe 10%, në bazë të Ligjit për prokurimin publik.

Në këtë situatë, për Qeverinë e Kosovës kanë qenë vetëm dy opsione, zbatimi në përpikëri i kontratës dhe ndërprerja e të gjitha projekteve kapitale, jo vetëm rrugore, por edhe në sektorë tjerë, ose të arrihet një marrëveshje parimore që përfundimi i autostradës të shtyhet për një vit, duke e pranuar një kosto shtesë të bazuar në kontratë dhe të përballueshme për Qeverinë e Kosovës.

Natyrisht, Qeveria Mustafa, gjatë gjithë kohës ka qenë e përgjegjshme, duke u munduar që të bëjë zgjidhje për realizimin e kësaj kontrate me përpikëri, por pa i dëmtuar projekte tjera kapitale.

Buxheti i ndarë për ndërtimin e autostradës është publik dhe i bazuar në Ligjin e buxhetit për vitin përkatës.

Në këtë mënyrë, Qeveria ka dëshmuar transparencë me punëkryerësin, duke i mundësuar që ta përshtatë vëllimin dhe planin e punimeve me buxhetin e ndarë dhe duke kontribuar në minimizimin e kostos...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë sipas radhës, fjalën e ka deputeti Visar Ymeri, në emër të grupit.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës,
Siç jemi njoftuar të gjithë nëpërmjet medieve, dje është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit Investues “Control Global”.

Ky është njëri prej projekteve më të mëdhenj në të cilin ka hyrë shteti ynë dhe definitivisht projekti më i rëndësishëm ekonomik pas luftës. Por, është edhe procesi i negociimit më jotransparent që e kemi parë gjatë kësaj periudhe, sikur ato marrëveshjet e kontratat për ndërtimin e autostradave.

Sipas një përgjigjeje, të cilën e ka kthyer Ministria e Zhvillimit Ekonomik, termocentrali do ta ketë një bllok prej 500 megavatësh, kthimi në investime për këtë investim do të jetë diku 21,5%, siç janë dakorduar me Qeverinë, ndërkohë që ngritja e çmimit të energjisë parashikohet nga Qeveria të jetë prej 28 deri 32%, si rrjedhojë e këtij projekti.

Besoj që këto mjaftojnë për të treguar se sa skandaloze është kjo kontratë dhe ky projekt, në përgjithësi.

Ky është rasti i parë i privatizimit të kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike në Republikën tonë.

Pas privatizimit të dëmshëm e shkatërrues të rrjetit të shpërndarjes, tash po zbatohet faza e dytë e privatizimit të gjenerimit, një hap jashtëzakonisht i dëmshëm drejt privatizimit të sistemit të energjisë elektrike, në përgjithësi.

Ky privatizim nuk ka se si të jetë ndryshe, përveçse privatizim i shtetit.

Duke pasur parasysh që energjia elektrike nuk është luks, por lidhet drejtpërdrejt me sovranitetin, kur është fjala ta zëmë për sigurinë e furnizimit me energji, lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik, kur është fjala për furnizim të qëndrueshëm me çmime të volitshme, si dhe lidhet me mirëqenien në rastin e qasjes së barabartë me energji dhe çmime të përballueshme, atëherë ky lloj privatizimi është ikje e shtetit nga përgjegjësia që e ka karshi qytetarëve, sovranitetit të vet dhe ekonomisë së vet.

Me këtë kontratë dhe me këto kushte të saj, ne po heqim dorë nga pasuritë tona energjetike, po heqim dorë nga infrastruktura jonë ekonomike.

Kur sektori i energjisë është në pronësi publike, kapacitetet energjetike shndërrohen vetëm në mall tregu. Duke i shndërruar ato vetëm në mall tregu, e jo duke pasur edhe mundësinë që ta përdorimin energjinë tonë si infrastrukturë për zhvillim ekonomik, ne po heqim dorë nga një mundësi jashtëzakonisht e mirë dhe e rëndësishme që e ka ekonomia e Kosovës, që të krijojmë përparësi krahasuese me ekonomitë tjera, duke u bazuar në mundësinë e prodhimit të energjisë elektrike me çmim të volitshëm, të përballueshëm e të lirë.

Pra, me privatizim, këtë mundësi po ia heqim nga dora vetes, që nënkupton duke hequr këtë mundësi të energjisë, infrastrukturën për zhvillimin ekonomik, ne po e dëmtojmë shumë mundësinë e zhvillimit ekonomik, veçanërisht mundësinë e industrializimit të vendit edhe rritjes së kapaciteteve prodhuese brenda vendit.

Pra, e keni parë që tash ZRRE-ja e ka një kërkesë, e cila po ashtu është publikuar nëpërmjet medieve dhe në raportimin e ZRRE-së te Komisioni për Zhvillim Ekonomik, që çmimi i energjisë elektrike, tarifat e energjisë elektrike të rriten për diku 18,7%. E tash, natyrisht që ZRRE-ja do ta pranojë një rritje të çmimit të energjisë elektrike, mbase jo me këtë nivel, mbase me një nivel më të ulët, në mënyrë që pastaj të dalin në publik dhe të thonë që megjithatë e mbrojtëm interesin e qytetarëve, por sido qoftë çmimi i energjisë elektrike do të rritet për gjithë ne.

Dhe, me këtë trend, e veçanërisht për shkak të marrëveshjes me “Control Global” dhe ndërtimit të këtillë të këtij termocentrali të ri, energjia elektrike siç është parashikuar nga ekspertët rrezikon të rritet për 40% në vitet në vijim.

Pra, në momentin kur të fillojmë që të konsumojmë energji elektrike nga Kosova e Re, qytetarët e Kosovës, ekonomia e Kosovës do ta paguajnë tarifën për megavat të energjisë elektrike për 40% më të madhe sesa që e paguajnë sot.

Dhe, kjo do të shkaktojë probleme jashtëzakonisht të mëdha për ekonominë tonë, e veçanërisht do të shkaktojë probleme jashtëzakonisht të mëdha për qytetarët tanë, të cilët edhe sot e kësaj dite e kanë vështirë ta përballojnë çmimin e energjisë elektrike dhe në këtë drejtim do ta dëmtojnë drejtpërdrejt mirëqenien e Republikës së Kosovës, sepse, në njërin anën, po e dëmtojnë mundësinë për zhvillim ekonomik, që do ta rriste këtë mirëqenie, e, në anën tjetër, po e dëmtojnë koston e jetës, që e rrënon këtë mirëqenie.

Prandaj, i bëj thirrje edhe një herë Qeverisë së Republikës së Kosovës, siç kemi bërë vazhdimisht, që në projekte të tilla të ketë kujdes, energjia elektrike dhe kapacitetet e pasuritë tona minerare nuk janë pronë e kësaj Qeverie, e besa nuk janë pronë vetëm e kësaj gjenerate. Janë pronë edhe e gjeneratave që do të vijnë dhe me këto duhet të menaxhojmë kujdesshëm, në mënyrë që të garantojmë që ato do të vihen në funksion të rritjes së mirëqenies dhe zhvillimit të Republikës së Kosovës, e jo në funksion të trashjes së xhepave e llogarive bankare të individëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu. Urdhëro! Teuta, në emër të grupit apo?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,
Temën të cilën do ta trajtojmë sot në emër të grupit, është e drejta e punëtorëve në sektorin privat.

E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit është parim bazë, i përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 49.

E drejta e punës garantohet me Kushtetutë dhe secili person është i lirë ta zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Mbrojtja e përgjithshme e të punësuarve në punë është përcaktuar me Ligjin numër 03/L-212 të punës.

Neni 42 i këtij ligji përcakton se çdo i punësuar e ka të drejtën e sigurisë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe në ambientin e përshtatshëm të punës, duke theksuar se punëdhënësi është i detyruar t'i sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe shëndeti i të punësuarve në pajtim me ligjin.

Neni 1 i Ligjit 04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë i përcakton masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në vendin e punës.

Për më tepër, Ligji i përcakton parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Sipas informatave të disponueshme që kemi, numri i të lënduarve në punës është duke u rritur nga viti në vit.

Mungesa e masave mbrojtëse dhe zbatimi i pamjaftueshëm i rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë është vërtet shumë shqetësues.

Pa anashkaluar sektorët tjerë, rezulton se sektori i ndërtimtarisë prin me numrin më të lartë të rasteve të lëndimeve, si dhe vdekjeve të punëtorëve në vendin e punës.

Sipas të dhënave nga Zyra Kombëtare e Auditimit, raporti i auditimit me temën “Siguria në punë e punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë, tetor 2016, Prishtinë”, që nga viti 1999, në sektorin privat e kanë humbur jetën dhe janë lënduar një numër i konsiderueshëm i punëtorëve në vendin e punës.

Puna dhe kushtet e punës në këtë sektor përcillen me probleme, si rreziku në punë, mungesa e kontratave të punës, mungesa e sigurimit shëndetësor, mosrespektimi i të drejtës në pushim ditor, javor, vjetor, mjekësor, të lehonisë, siguria në punë, diskriminimi në paga, moskompensimi i orëve shtesë të punës, të ndërrimit të natës, puna gjatë festave e të tjera.

Masa e ndërmarra deri më tani nga organet kompetente lidhur me evitimin e shkeljeve kanë rezultuar si të pamjaftueshme.

Me gjithë kornizën relativisht të mirë ligjore, siguria e punëtorëve në vendin e punës në Kosovë mbetet ende shqetësuese.

Në çdo vit në Kosovë, si pasojë e kushteve të papërshtatshme dhe të pasigurta në vendin e punës janë shkaktuar shumë lëndime dhe me fatalitet për jetën e punëtorëve.

Gjithashtu sipas informatave, gjatë viteve të fundit 61 qytetarë e kanë humbur jetën në vendet e tyre të punës, ndërsa 534 të tjerë janë lënduar lehtë e rëndë. Mirëpo, në realitet, numri i të lënduarve llogaritet të jetë shumë më i madh, pas një numër i konsiderueshëm i tyre nuk raportohen fare.

Vetëm gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti, në vendin e punës, për shkak të kushteve të rënda, e kanë humbur jetën 9 persona.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Inspektorati i Punës nuk kanë raporte apo statistika të publikuara rreth gjendjes së punëtorëve në vendin e punës. Gjithashtu nuk ka vendime të publikuara rreth institucioneve apo ndërmarrjeve që nuk i zbatojnë kushtet e sigurisë dhe të shëndetit në punë.

Këshilli Nacional për Siguri e Shëndet në Punë ende nuk e ka ndonjë raport të publikuar rreth punës së tyre apo rekomandimeve për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për më tepër, nuk ka as adresë të caktuar për t'iu drejtuar këtij këshilli.

Sinqerisht, shumë punëtorë të cilët punësohen në sektorin privat ndoshta punësohen për ta kryer një punë profesionale, por ata shumë herë detyrohen të kryejnë edhe punë të tjera, siç është puna e pastrueses, apo edhe punë të tjera nga vetë personat, të cilët e udhëheqin një sektor të caktuar.

Në fund, Qeveria e Republikës së Kosovës, urgjentisht të ndërmarrë masa konform ligjeve dhe Kushtetutës së vendit për të drejtën e njerëzve të zakonshëm dhe për çdo individë, e drejtë kjo që është parakusht dhe garanci e lirisë dhe realizimit të zhvillimit të personalitetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Milaim Zeka. Në emër të grupit, apo në emër personal? Në emrin e tij personal, tre minuta, ju lutem!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë kam pasur sot për t'i paraqitur si deputet disa tema, në radhë të parë çështjen e pensionistëve, që vijnë të shkretit dhe presin me orë tëra për ta marrë pensionin, e shteti ynë nuk ua çon me postë nëpër shtëpitë atyre. Ky është turp.

E dyta, zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar, ju lutem, shikoni mundësinë për bursat e studentëve, gjithkund në botë u ndahen studentëve bursa dhe këto pastaj i kthejnë me një kamatë 2%, pasi këta njerëz fillojnë të punojnë. Kjo është një çështje shumë me rëndësi.

Çështja e shtrenjtimit të rrymës, Zyra e Rregullatorit në vend që të dalë në përgjegjësi penale përpara gjykatave për hajninë që u ka bërë qytetarëve të Kosovës, po kërkon prapë shtrenjtimin e rrymës me 18%.

Shqetësimi më i madh, për mua si deputet, është çështja e Kuvendit të Kosovës, çështja e laptopëve. Ne si deputetë nuk kemi laptop dhe bëjmë fotokopje që Kuvendi i Kosovës brenda një viti shpenzon diku 40-50 mijë euro fotokopje, letra. Në shekull të sodit është marre për këtë Kuvend, deputete Emilija, a mund të ngrehesh me ato letra që i ke në dorë, të lutem, ta shohë edhe Qeveria jonë se sa fotokopje bëhen këtu brenda ditës. Prandaj, kërkoj urgjentisht nga sekretaria e Kuvendit, nga Kryesia e Kuvendit, të marrin vendim që të na blejnë nga një laptop. Për ndryshe, i bëj thirrje Ambasadës Amerikane, pasi po na ndihmojnë shumë, të na e bien dhuratë nga një laptop këtu dhe të mos kemi nevojë më për fotokopje.

Po të kishte ndonjë parti ekologjike në Kosovë, kishte ardhur përditë dhe kishte protestuar para Kuvendit, para Kryesisë, para Sekretarit të Kuvendit, Ismetit, pasi është këtu, po ia përmendi emrin, se s'ka të drejtë replike.

Në fund, kryeministër, të përgëzoj për kontratën për punën e termocentralit. Ka qenë me siguri një vendim shumë i rëndë, por jashtëzakonisht i rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Mbase kjo Qeveri të paktën qytetarët e Kosovës i pajis me dy gjëra: ua heq shqetësimet për rrymë dhe për ujë të pijshëm. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe unë po përpiqem të respektoj radhën edhe të grupeve parlamentare, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot është data 14 dhjetor, është përvjetori i 19-të i rënies së Komandant Mujë Krasniqi dhe 41 dëshmorëve të tjerë që kanë rënë në kufirin e padrejtë mes shqiptarëve në Goruzhub, në dhjetor të vitit 1998.

Por, si shumë prej jush ndoshta e dini, familjet e dëshmorëve akoma, po ashtu edhe sot lulet për familjarët e tyre, bashkëluftëtarët e tyre, jo vetëm familjet, lulet i hedhin ende mbi dhe te varrezat, për shkak se varrezat atje nuk janë të rregulluara. Siç ndoshta edhe ju e dini, më 14 dhjetor 1998 ishin 141 luftëtarë që ishin nisur për të sjellë armë në Kosovë dhe 41 prej tyre kanë rënë aty. Kurse, në ndërkohë në fshatin Polac, në një lëndinë në rrethana lufte janë varrosur këta dëshmorë dhe pastaj edhe dëshmorë të tjetër, janë rreth 128 varreza, të gjitha të parregulluara. Pra, varrezat atje kanë vetëm nga një shenjë druri, ku në ato shenja druri shumica e emrave nuk u lexohen më.

Unë e di që ka pasur probleme rreth menaxhimit të kësaj teme dhe në ndërkohë është investuar edhe një donacion rreth 200 mijë dollarë nga një shtetas amerikan, veteran i luftërave. Kështu që kërkoj nga kryeministri, në këtë rast, një angazhim personal për këtë temë, duke e ditur që edhe e ndjen sikur shumë të tjerë që të marrë angazhimet për rregullimin e varrezave, në veçanti, por

edhe për menaxhimin dhe rregullimin e gjithë kësaj çështje, në përgjithësi. Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve më njoftoi që në të kaluarën janë ndarë diku 200 mijë euro për rregullimin e këtyre varrezave dhe akoma varrezat atje nuk janë rregulluar. Pra, kërkoj angazhimin tuaj, zoti Haradinaj, llogarit edhe në angazhimin e secilit prej nesh, duke llogaritur edhe në mua personalisht, nëse ju duhem dhe shpresoj që në 20-vjetorin e ardhshëm, pra në vitin e ardhshëm, kur do të jetë vit jubilar, familjarët e dëshmorëve, shokët e tyre, edhe ne bashkë të kemi ku të hedhim lule, sepse gjendja në të cilën janë këto varreza është e padinjitetshme për lavdinë, për luftën e tyre dhe për Ushtrinë Çlirimtare në Kosovë, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I jap fjalën deputetit Hajdar Beqa, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka mirëpritur arritjen e marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe investitorit amerikan për realizimin e projektit energjetik “Kosova e Re”.

Gjendemi para një fakti të pamohueshëm se projekti gjigand, ku ka për qëllim hapjen e mijëra vendeve të reja të punës, ka filluar me qeverisjen e PDK-së dhe, fatmirësisht po realizohet në qeverisjen bashkë me Partinë Demokratike të Kosovës. Ne e konsiderojmë se ky është njëri nga projektet më të rëndësishme për Republikën e Kosovës në prag të dhjetëvjeçarit të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Projekti që synon pavarësinë energjetike të Kosovës është vazhdimësi e një pune të palodhshme që ka bërë ish-ministri i Partisë Demokratike dhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Blerand Stavileci, në qeverinë e kaluar. Ky është edhe një fakt që projektet e mëdha që kanë filluar nga qeverisja e PDK-së, do të jenë të prekshme për vite me radhë për qytetarët e Kosovës dhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të nderuar qytetarë, të gjithë e dimë se projekti “Kosova e Re” është investimi më i madh privat në historinë e Kosovës, për të cilin është punuar që dhjetë vjet, si dhe do të jetë një investim prej 1,3 miliard eurosh. Gjatë kësaj periudhe së ndërtimit të termocentralit priten të hapen rreth 10 mijë vende të reja të punës, të cilat do të ulin ndjeshëm papunësinë dhe të cilat do të ndikojnë dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Ne si grup parlamentar e inkurajojmë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të gjejë rrugë për projekte të tjera kapitale, siç është projekti energjetik “Kosova e Re”, të njëjtën kohë e përgëzojmë edhe ministrin e ri, i cili ka nënshkruar marrëveshjen dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe të gjithë qytetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë për këtë pikë të rendit të ditës kemi vetëm edhe 3 minuta, unë i jap fjalën edhe deputetes Hykmete Bajrami, pastaj kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Urdhëro, zonja deputete!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, për shkak të mungesës së kohës unë po e vazhdoj fjalimin e ish-ministrit Zharku për të sqaruar rreth akuzave të ministrit aktual të Infrastrukturës.

Qeveria Mustafa gjatë gjithë kohës ka qenë e përgjegjshme sa i përket projektit të rrugës me “Bechtel&Enka”, duke menduar që të bëjë zgjidhje për realizimin e kësaj kontrate me përpikëri, por pa dëmtuar projekte të tjera kapitale më se të nevojshme për vendin tonë. Buxheti i ndarë për ndërtimin e autostradës është publik dhe i bazuar në Ligjin e buxhetit për secilin vit përkatës. Në këtë mënyrë, qeveria ka dëshmuar transparencë me punëkryerësin, duke i mundësuar që të përshtat vëllimin dhe planin e punimeve me buxhetin e ndarë, duke kontribuar në minimizimin e kostos eventuale për shkak të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve. Duke marrë parasysh kufizimet buxhetore dhe në frymën e bashkëpunimit të mirë për vite, “Bechtel&Enka” është pajtuar që të shtyjë afatin e përfundimit të punimeve deri më 31 dhjetor 2018, me një kosto shtesë prej 14.7 milionë euro, të cilët Komisioni drejtues ndërministror ia ka rekomanduar Qeverisë për aprovim. Kjo kosto është mbështetur edhe nga mbikëqyrësi “Hill International”, si konsulent teknik dhe ligjor i projektit.

Të nderuar deputetë,

Ministri Lekaj duhet të sqarojë se si është e mundur që “Bechtel&Enka” me Qeverinë Mustafa është pajtuar me shumën 14,7 milionë euro shtesë, kurse nga qeveria aktuale kërkon 63 milionë euro. Deklaratat publike të ministrit Lekaj se duhej të paguhet kjo shumë pa një analizë të thellë janë të pamatura dhe të dëmshme për vendin tonë. Denigrimi politik i një ministri apo qeverie nuk guxon të bëhet duke dëmtuar buxhetin e vendit. Komisioni drejtues ndërministror duhet të mblidhet sa më parë që të mos lejojë ministrin Lekaj që me deklarime të tilla publike të aprovojë shpenzime të pabaza lidhur me projektin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë konsideroj se e kemi mbyllur punën me pikën e parë të rendit të ditës. Urdhëro? Ministri Pal Lekaj ka kërkuar fjalën, si përfaqësues i Qeverisë, do të thotë pikë ne e kemi mbyllur dhe përfaqësuesit e Qeverisë kanë të drejtë në çdo rast të marrin fjalën. Faleminderit!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,
Zonja dhe zotërinj,

Sa i përket kësaj çështje të 63 milionëve saktë, nuk e kam prodhuar unë, nuk e kam imagjinuar unë, por është kërkesë e “Bechtel&Enka” që të paguhet 63 milionë për vonesat dhe shlyerjen e obligimeve buxhetore që kanë qenë të zotuar në kontratë.

E kam sqaruar, i nderuar deputet, ish-ministër, nuk keni qenë këtu, në mënyrë detale, analitike, se ku, në cilat pozicione është kërkuar dëshmipërblimi, pse është kërkuar, sa është bërë pagesa në vitet fiskale dhe për 11 muaj të shtyrjes së kontratës janë kërkuar 63 milionë euro, saktë. Nuk kam thënë asnjëherë që unë jam pajtuar dhe nuk do të pajtohem, por pas 100 takimeve që i keni bërë, asnjë vendim nuk e keni marrë dhe Qeveria e Kosovës jo vetëm për këtë rast, por edhe për raste të tjera që mund t’i citojmë, e ke për pasaporta që sa duhet të paguajë për neglizhencën dhe mosvendimin tuaj. E ke “Axosin” po ashtu për mosmarrje të vendimeve dhe unë nuk i kam fajet, bre, nuk i kam fajet, sepse unë nuk i kam prodhuar këto dokumente, i kam gjetur dhe në mënyrë të saktë jua kam elaboruar këtu dhe ju kam thënë edhe materiali do t’ju vijë.

Prandaj, unë nuk e marr përgjegjësinë e asaj neglizhencës suaj që s’keni pasur guxim të merrni vendime, çfarëdo që janë në të mirën e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Zharku, replikë.

LUTFI ZHARKU: Zoti nënkryetar,
Kryeministër,
Ministra,

Në realitet, ministri Lekaj foli pak gjerë, hapët, që themi ne, për shumë probleme të qeverisë së kaluar, unë do të ndalem veç në punën time. Atë që deklarova, ekziston marrëveshja, Komisioni ndërministror ka marrë vendim për shumën prej 14.78 milionë euro. Unë veç po kërkoj prej ministrit, le të na sqarojë si është e mundur që me ne të merret vesh 14.78, kurse këtyre t’ua kërkojë 63 milionë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ia jap edhe një herë fjalën ministrit, por dëshiroj të sqaroj që nuk është e domosdoshme të përmendet emri nëse i adresohesh një fjale të caktuar ose një funksioni të caktuar. Urdhëro, ministër!

MINISTRI PAL LEKAJ: E kam një shprehje që e them shpesh, “Më vjen keq”. Seriozisht e di që thuhet ‘më vjen keq’, por ata që po e them, prapë po e citoj, nuk e kam prodhuar unë kërkesën, është nga “Bechtel&Enka” që e kam prezantuar në Parlamentin e Kosovës, prandaj unë nuk e di çka, pse kaq po ju djeg. Do të dalin edhe gjëra të tjera, sepse ende duhet t’i sqaroni të gjitha ato që i keni ndërmarrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka kërkuar fjalën, dy minuta Avdullah.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues, për mundësinë të sqarohemi drejt edhe qartë. Mua më vjen keq që në krye të dikasterit është ministri, i cili nuk i lexon kontratat. Çdo obligim që ka Qeveria e Kosovës ndaj “Bechtel&Enka”, ose cilido kontraktor, buron vetëm nga kontratat, shihni kontratat, ju kisha lutur. Aty specifikohet për çdo vonesë, për çdo penallti, për çdo punë që duhet të kryhet, përmbushni kushtet kontraktuale, të tjera të keni kujdes me deklaratimet, sepse bashkë i keni partnerët që kanë shkaktuar këtë problemin e “Axosit” para 5-6 vjetëve dhe do t’i paguani, edhe pasaportave, që shpresoj ta keni paguar deri tash, edhe plot të tjera që do t’u vijjnë. Jeni bashkë me ata partnerë në Qeveri, prandaj keni kujdes! Më vjen keq, kur shpreheni kështu, më vjen keq për qytetarët e Kosovës qysh tash gardianë të taksave tyre janë këta persona të papërgjegjshëm. Lexojini, ju lutem, kontratat dhe mos dilni kaq joserioz në foltore.

KRYESUESI: Ministri Lekaj, edhe një herë, dhe ju lutem, të mbyllni, edhe ashtu ato dokumente të shkruara janë.

MINISTRI PAL LEKAJ: Shef i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe ish-ministër i Financave, mund të them para qytetarëve të Republikës së Kosovës për obligimet që nuk i keni shlyer ndaj kontraktuesit që janë të saktësuara në kontratë ka ardhur deri te dëmshpërblim apo kjo kërkesë nga “Bechtel&Enka”, duke u bazuar në pasuset dhe në nenet e kontratës dhe asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Prandaj, e kam lexuar shumë mirë, e di, sepse nuk është rasti i parë që unë e kam hasur në Ministrinë e Infrastrukturës, por janë edhe raste të tjera. Dhe, unë po e them, për mosshlyerjen e obligimeve, duke u bazuar në nenet e kontratës me “Bechtel&Enka” janë këto kërkesa të kompanisë në fjalë.

Jeni takuar mbi 100 herë dhe nuk keni bërë zgjidhje, prandaj ka ardhur deri te kjo kërkesë e tyre që unë jam zotuar para jush dhe prapë po e them që unë do ta negocioj këtë duke u bazuar në kontratën dhe obligimet që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, kundër-replikë, dhe kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

AVDULLAH HOTI: Unë kërkoj ndjesë edhe nga deputetët e tjerë që po zgjatëm në këtë pikë, por është një gjë që deputeti Lekaj nuk kupton. Nuk negociohet për një kontratë që është mbërritur, prandaj ne s’kemi mbërri asnjë marrëveshje me ta. I kemi insistuar në zbatimin pikë për pikë të kontratës, pra nuk është çështje e diskrecionit tënd çfarë marrëveshje mbërrin me “Bechtel&Enka”, ti je i obliguar ta zbatosh kontratën, vetëm kaq, s’mund të mbërrish marrëveshje me ta, s’mund t’i akuzosh ministrat paraprak; që s’kanë mbërritur marrëveshje. Ne

jemi kujdesur që të zbatojmë kontratën edhe të kisha lutur edhe ti të jesh më i kujdesshëm që ta zbatosh plotësisht kontratën.

KRYESUESI: S'ka përmendur asnjë emër tjetër, besoj që replikë, është e qartë. Ka një minutë ministri Lekaj dhe fillojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

MINISTRI PAL LEKAJ: Prapë më duhet ta sqaroj me keqardhje, po e them nuk negociohet kontrata, negociohet shuma e kërkuar nga "Bechtel&Enka", duke u bazuar në obligimet që i ka me kontratë Qeveria e Kosovës, këtë dhe kaq. Unë nuk thashë që nuk negociohet, të lutem. Po në kontratë shkruhet shumë mirë, shkruhet e kenë lexuar disa herë dhe mos u mundo tani për gabimet tuaja, për mosvendimet, për neglizhencën tuaj tani ta hidhni fajin diku tjetër.

Unë ju kuptoj, jeni në pozita shumë të këqija, seriozisht, sepse do të duhej të kishit marrë vendime duke u bazuar në kontratë dhe obligimet që i ka pasur Qeveria e Kosovës, unë s'po them asgjë më shumë as më pak.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ju njoftoj që koha për pyetje parlamentare është 60 minuta, për këtë seancë janë parashtruar 40 pyetje parlamentare. Fillojmë me pyetjet e bartura nga seancat e mëparshme sipas radhës:

Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

I nderuar zoti ministër, desha të pyes se çfarë do të bëni në lidhje me hekurudhën e Ferizajt, e cila kalon nëpërmjet, respektivisht nëpër qendër të qytetit. Hekurudhat zakonisht është element, respektivisht komponent i zhvillimit ekonomik, por mjerisht ajo tek ne në Ferizaj nuk po shfrytëzohet si e tillë. Ajo ka ndikuar që qyteti të ndahet në dy pjesë, hekurudha është shpesh fajtorë, për arsye se humbin jetë të njerëzve në rastet kur ndihma e shpejtë duhet të kalojë nga një pjesë e qytetit në pjesën tjetër, kjo vështirësohet. Edhe kur zjarrfikësit kanë ndonjë rast urgjent, gjithashtu është problematike për të kaluar nga njëra pjesë në pjesën tjetër të qytetit, ndërsa komunikacioni pikërisht për shkak të hekurudhës është shumë i ngarkuar.

Të gjithë kryetarët e komunës gjatë zgjedhjeve deri tani kanë premtuar që do ta zgjedhin çështjen e hekurudhës, megjithatë këto kanë qenë premtime elektorale që nuk zgjidhen, sepse hekurudha në Ferizaj nuk i takon nivelit komunal, por i takon nivelit nacional. Unë do të doja të dija a ka

Qeveria e Kosovës ndonjë projekt për ta rregulluar çështjen e hekurudhës në Ferizaj, respektivisht për të mënjeluar problemet, të cilat lidhen me hekurudhën?

KRYESUESI: Urdhëro, zoti ministër, e keni fjalën që të përgjigjeni, tre minuta.

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet Topalli,

Para se të kaloj në përgjigjen konkrete, dëshiroj të them diçka që lidhet pak edhe me fushatën elektorale që e përmende. Është e vërtetë që në fushatë elektorale, edhe pse nuk ka qenë kompetencë e komunave apo e komunës, në këtë rast, janë premtuar projekte megalomane, që nuk kanë qenë korrekte ndaj qytetarëve.

Ne jemi të vetëdijshëm për problematikën që e kanë qytetarët e Ferizajt. Ne deshëm e s'deshëm, duhet ta bëjmë një zgjidhje që shkon në favor të sigurisë së qytetarëve. Aty ka pasur edhe humbje jetësh, aty ka pasur edhe mospajtim të qytetarëve dhe ne do të bëjmë më të mirën të mundshme që në mbështetjen që e kemi nga BERZH-i që është në procedurë, do të shikojmë në mënyrë detale projektin dhe do të bëjmë atë që duhet, së pari për sigurinë e qytetarëve, që të jetë funksionale, në dobi të komunës dhe asgjë më shumë. Prandaj, është pyetje me vend dhe ne do t'i paraprijmë asaj që duhet t'i paraprijmë, me projekte detale të implementueshme që shkojnë në favor të sigurisë së qytetarëve të Ferizajt.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyes deputetin nëse ka ndonjë pyetje shtesë? Po, urdhëro!

FATON TOPALLI: Zoti Lekaj, unë po nisem nga mendimi që do të bëni atë që është e mundshme për të bërë më të mirën, por do të kisha dashur megjithatë të di cili është plani i BERZH-it, cili është projekti konkret, apo a ka ndonjë projekt për këtë çështje?

KRYESUESI: Zoti Lekaj e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: Sa i përket projektit të infrastrukturës hekurudhore, në këtë rast, me mbështetje të fuqisë buxhetore nga BERZH-i, është e vërtetë që është stërzgatur projekti, jemi në procedurë të përpilimit të projektit dhe këtu do të jem shumë i saktë, meqë në fokus do të jetë qytetari i Ferizajt, siguria e qytetarit të Ferizajt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te pyetja tjetër. Prapë deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Haradinaj. Urdhëro, zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Ka kohë që e kam shtruar këtë pyetje. Kam parasysh që edhe kryeministri ka qenë dikur vetë mërgimtar dhe e di sa të ndjeshëm janë mërgimtarët. Kanë kaluar 18 vjet pas luftës dhe ne akoma

nuk e kemi Kartonin e Gjellbër. Akoma vazhdohet të plaçkiten mërgimtarët e Kosovës për shkak se disa kompani të sigurimeve dëshirojnë t'i shumëfishojnë fitimet e tyre, deri më tani kanë qarkulluar mbi 200 milionë euro.

Sjellja e kompanive të sigurimit është në kundërshtim me ligjin, sepse Ligji nuk lejon që të krijohen monopole, nuk lejon që të kurdisen çmimet, prandaj edhe pyetja ime për ju është se çfarë do të bëni dhe a keni mundësi të bëni ndonjë gjë për implementimin e Kartonit të Gjellbër? Ka edhe disa arsye të pak a shumë banale që Kartoni i Gjellbër nuk mund të bëhet për shkak se Kosova nuk është pjesë e OKB-së. Kjo nuk qëndron. Ka plot vende të tjera që e kanë rregulluar në mënyrë bilaterale këtë çështje.

Ministri Hamza, në njërin prej diskutimeve tha se njëra prej arsyeve pse s'e kemi Kartonin e Gjellbër është për shkak se 25% e automjeteve nuk janë të regjistruara, respektivisht nuk kanë sigurime. Pra, e vë theksin kryesor në çështjen e këtij 25%-shi, për çka edhe ne nuk kemi marrëveshje për Kartonin e Gjellbër.

Pra, do të doja të di a ka Qeveria ndonjë plan dhe a mund të bëjë Qeveria ndonjë gjë në këtë drejtim, që mërgimtarët nga Kosova të mos paguajnë mjete për Kartonin e Gjellbër, të cilat në njëfarë mënyre keqpërdoren nga kompanitë e sigurimeve.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Topalli, S'e kemi arritur ndonjë rezultat në heqjen e kartonit. Jemi në kërkim të listës së veprimeve që mund t'i marrim si Qeveri, për të rezultuar me heqjen e Kartonit të Gjellbër.

Janë disa veprime të disa natyrave që Kosova, megjithatë, të mbetet treg i rregullt i sigurimeve, pra për të mos ndodhur ndonjë çrregullim. Por, ju them se veç kam filluar t'i identifikoj punët nëpërmjet cilave veprime mundësohet që të gjithë që vijnë në Kosovë, në këtë rast është fjala për bashkatdhetarët, e që kanë sigurime në vendet prej nga vijnë, që vlejnjë për vendet tjera, të vlejnjë edhe për Kosovë. Por, nuk e kemi rezultatin ende. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Po! Urdhëro, zoti Topalli!

FATON TOPALLI: Do të doja të di në qoftë se kjo është e mundshme, a ka ndonjë afat kohor kur ne si Kuvend mund të marrim ndonjë përgjigje se çfarë është bërë në këtë drejtim dhe a ekziston ndonjë ekip i caktuar që merret me këtë çështje dhe në qoftë se ekziston, cila është, në mënyrë që të kemi mundësi t'i drejtohem qoftë edhe për pyetje sqaruese.

KRYESUESI: Kryeministër, e keni fjalën. Keni dy minuta që t'i ktheni përgjigje.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Tani kemi qenë me plot tema të menjëhershme dhe rezultat i kësaj ka qenë mungesa e fokusimit të mjaftueshëm në këtë temë, pra për ta nxjerrë tamam në rend dite për ta trajtuar. Megjithatë, është e iniciuar. Sot nuk jam në pozicion të ju jap ndonjë përgjigje të saktë kohore, por me sa unë kam parë, janë dy-tri dikastere që duhet të punojnë në të njëjtën kohë, pra dy-tre resorë të punojnë në të njëjtën kohë për të ardhur deri te një formulë që do të rezultonte me heqjen e Kartonit të Gjellbër, pra me heqjen e pagesës në kufi.

Por, s'mund të ju them sot saktë. Në fakt, mund të ju them që disa veprime ia kemi kërkuar Ministrisë së Diasporës, i kemi kërkuar Ministrisë së Financave të punojnë në këtë drejtim, sepse lidhet me aspektet e rregullimit të tregut të sigurimeve, mirëpo me gjasë këtu do të ketë pak punë edhe për Ministrinë e Jashtme dhe për ne të tjerët, që të ndërlidhemi që anëtarësimi i Kosovës në mekanizmin relevant të sigurimeve, mund të jetë edhe ajo formula. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te pyetja e radhës. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Urdhëroni, zonja deputete!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pyetja ka kohë që është bërë, por ka rastisur që ndonjëherë s'ka qenë ministri këtu, ose ndonjëherë s'kam qenë unë.

Dua të them se nga të gjitha qeveritë është folur për rrugën Deçan - Plavë, por e njëjta vazhdon të jetë e papërfunduar. Mendoj që është ende e patrajtuar. Kur është bërë pyetja, ende s'e kemi pasur Projektbuxhetin dhe po shihet që ministria juaj, ministër, ka ndarë veç 2 milionë e gjysmë për rrugën Deçan - Plavë, që është një shifër vërtet shumë e ulët.

Disa deputetë në mandatin e kaluar, kur qenë ndarë 50 mijë euro për rrugën Deçan - Plavë patën thënë "këto nuk mjaftojnë as për vijat e mesme për t'i caktuar", ndërsa tash me këtë buxhet që është ndarë nga ministria juaj, po më duket se as sinjalistika për këtë rrugë nuk mjafton, e jo për t'u përfunduar.

Sipas planifikimeve të Ministrisë së Infrastrukturës, kur mendoni se mund të përfundojë kjo rrugë?

KRYESUESI: Ministri Pal Lekaj e ka fjalën për përgjigje.

MINISTRI PAL LEKAJ: E nderuar deputete Kadrijaj,

Është e vërtetë që kjo shumë që e kemi ndarë 2,4 milionë nuk e përmbush kontratën përfundimtare. Është procedurë në përfundim dhe kjo shumë prej 2,4 milionësh është 20-fish apo 40-fish i pesëdhjetëmijëve që janë ndarë qe sa vjet. Është stërzgatur kjo kontratë, por ne zotohemi se pas përfundimit të procedurave dhe fillimit të projektit në vitin 2018, që shpresoj se brenda dy vjetëve saktë do të përfundojë më përpara, por ne do ta përcjellim me vija buxhetore dhe ai projekt më nuk do të ketë hapësirë për stërzgjatje, sikur kemi pasur praktika të mëparshme. Faleminderit!

KRYESUESI: A keni pyetje shtesë? Po!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit!

Saktë, ministër, sipas planifikimeve të Ministrisë së Infrastrukturës, cili është viti kur mendoni të përfundojë rruga Deçan - Plavë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën që të përgjigjeni në pyetjen shtesë.

MINISTRI PAL LEKAJ: Për shkak të terrenit që është jo fort i përshtatshëm, ne do të fillojmë në vitin 2018 dhe në vitin 2019, nuk po mund ta them saktësisht muajin, do të përfundojë.

KRYESUESI: Kalojmë te pyetja e radhës. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Urdhëroni, zonja deputete!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ka kohë që i kam parashtruar këto pyetje, por kryeministri nuk vinte në seancë. Tash është mirë që është këtu. Nuk po dua ta falënderoj, se e keni obligim të jeni. Nuk po i kuptoj deputetët që po i falënderojnë ministrat. E keni obligim të jeni në seancë para deputetëve të Kuvendit.

Në strategjinë legjislative thuhet se Projektligji për Qeverinë do të procedohet në Kuvend në dhjetor. Tash jemi në muajin dhjetor dhe ende nuk është sjellë ky projektligj në Kuvend. Zoti kryeministër, a mund të na njoftoni se kur saktësisht kur e keni në plan ta procedoni këtë projektligj në Kuvendin e Republikës?

KRYESUESI: Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete Haxhiu,

Ekziston një koncept-dokument, pra dokument bazë i Projektligjit për Qeverinë në Qeveri. Ende as nuk e kam lexuar, as parë, por shpresoj se në një moment kohor të caktuar të mund t'i kthehem punës në këtë ligj. E di se sponsorizuesit e ligjit në këtë rast kanë avancuar në punë, por

unë ende s'e kam në rend dite dhe në tavolinë. Me këtë nuk nënkuptohet se nuk e kuptojmë peshën dhe rëndësinë e këtij ligji.

Dua të jem i sinqertë me ju dhe Ligjin për Qeverinë e mendoj si ligj që do të hynte në fuqi në kohën e formimit të një Qeverie të re. Me këtë pra, ne e kemi ndërtuar një qeveri që është e tillë çfarë është, me numër të caktuar të ministrive, me dikastere, nuk e kemi qëllimin që me ligjin ta racionalizojmë këtë Qeveri, që do të ishte me siguri edhe interesi juaj e i të gjithë tjerëve, për shkak se zakonisht deri sot ka pasur vështirësi në dakordim për një ligj edhe nga deputetët, që do ta racionalizonte Qeverinë, numrin e ministrive dhe do ta bënte një organizim të mirëfilltë.

Nëse ligji vjen te ju dhe nuk e prek një qeveri të caktuar aktuale, atëherë jam i bindur që deputetët do ta votonin për qeverinë e ardhshme. Në këtë rast, në Qeveri jemi koalicioni qeverisës që jemi, por edhe sikur të ishte një koalicion tjetër, mund të ketë mospërkrahje në votë një ligj për qeverinë që ndërhyt sot, që do ta shkurtonte numrin e ministrive, ose të dikastereve.

Duke qenë i vetëdijshëm që është vështirë ta marrë përkrahjen për një ligj për qeverinë tani, në këtë kohë, që do të vepronte direkt në racionalizimin e kësaj qeverie, ndoshta do të mund të gjenim ndonjë konsensus ndërmjet grupeve parlamentare që ta votojmë një ligj për qeverinë e ardhshme, kurdo që formohet. Nuk po e prejudikoj, as mandatin, as kohën sa zgjat, as kur, por do të ishte shumë me rëndësi nëse mund të biem në dakord që kushdo që formon qeveri herën tjetër të jetë i kornizuar, pra të mos mund të dalë nga një kornizë e caktuar nga ajo që parasheh Ligji për Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Po! Urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, u mundova të kem vëmendje të plotë në përgjigjen që e dha kryeministri, por besomëni, nuk mora përgjigjen në pyetjen që e parashtrova, ndonëse ishte shumë e thjeshtë.

Pra, Projektligji për Qeverinë nuk do të procedohet brenda muajit dhjetor dhe as në afërsi, domethënë as në gjashtëmujorin e parë të vitit të ardhshëm, madje tutje do të vazhdojmë të mos kemi Ligj për Qeverinë. Por, pyetja është nëse keni menduar që ta kufizoni numrin e zëvendësministrave, në qoftë se jo të dikastereve, të Qeverisë, për shkak se, zoti kryeministër, sot kemi ndoshta mbi 70 zëvendësministra, për shkak se kështu po mendoni t'i kënaqni apetitet e njerëzve që ju kanë ndihmuar për ta krijuar këtë Qeveri.

Cili është qëndrimi juaj? A do të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën përsëri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: U mundova ta jap edhe një perspektivë kohore. Ligjin për Qeverinë mendoj ta sjell në Parlament në një moment të një dakordimi politik, që të paktën ata që formojnë qeveri pas kësaj here, pas meje, ta kenë një kornizë ligjore që i obligon, po them herën e ardhshme. Po, kurdo qoftë.

Pse po e them këtë, deputete Haxhiu? Sot, partitë e koalicionit që e kemi formuar Qeverinë kuptohet që i kanë pritjet e veta për përfaqësim, siç e thatë ju, në të vërtetë edhe komitetet, edhe të gjithë. Nesër nëse kjo është e kornizuar, nëse ne votojmë një ligj në këtë Parlament, por që hyn në fuqi për një qeveri të ardhshme, ndoshta do të pajtohemi të gjithë në këtë kohë që do të ishte formulë e duhur.

Sa i përket Qeverisë, ne mund ta përshpejtojmë procesin, por më duhet të ju them që nuk e gëzoj përkrahjen për miratim të një ligji për Qeverinë që do të ndërhynte tani në Qeveri. Kufizimi i numrit të zëvendësve, nuk them se është një lajm i mirë numri i madh i zëvendësministrave, është produkt i konstalacionit politik dhe i mënyrës se si është formuar kjo Qeveri. Pra, nuk lavdërohem me këtë numër.

Në fakt, ndoshta ende është nën numrin e Qeverisë së mëhershme, mirëpo edhe ky nuk është arsyetim, pra s'është mirë të ndiqen shembuj të tillë. Diku 74 ose 76 i ka pasur Qeveria para meje, por s'i kanë bërë me zhurmë, ose publik, por ekzistojnë të dhënat për këtë. Pse po e them këtë? Ajo që po dua ta bëj dhe që e kam premtuar këtu nuk kam mbërri mjaftueshëm këto ditë, por besoj me janar do të obligohem dhe ta marr obligim që këta zëvendës të paktën ta nxjerrin rrogën e vet, duke u shërbyer qytetarëve dhe besoj që këtë do ta bëj.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te pyetja tjetër. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Deputetja s'është në sallë.

(Reagime nga salla)

Pa pyetje, s'mund të përgjigjeni. Do të parashtrohet në seancë, zoti kryeministër, sepse ky është rregulli.

Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj. Urdhëro, Liburn!

LIBURN ALIU: E nderuar ministre,
Pyetja ime ka të bëjë me çështjen e lejes së ndërtimit për autostradën e Hanit të Elezit, Prishtinë - Hani i Elezit. Pra, në vitin 2014 pati nisur ndërtimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit dhe lidhur me këtë a mund të na tregoni se a ka leje ndërtimi kjo autostradë?

Pra, kemi të bëjmë me ndërtim të kategorisë së tretë, e cila bie në kompetencë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është kjo ministri ajo që duhet të lëshojë leje për këtë ndërtim dhe njëkohësisht ka qenë Ministria e Infrastrukturës ajo që është dashur të aplikojë për leje, pra të marrë leje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pra, dua ta di a ka leje ndërtimi autostrada?

KRYESUESI: Urdhëroni! Zonja ministre, e keni fjalën.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet, faleminderit për pyetjen!

Ministria e Infrastrukturës, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë, sipas Ligjit për rrugët dhe ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 11/2003, ka lëshuar lejen e ndërtimit për Projektin e autostradës “Arben Xhaferi” R-6, segmenti Prishtinë - Hani i Elezit. Konsideroj se Ministria e Infrastrukturës, për shkak të interesit nacional, siç është në këtë rast ndërtimi i autostradës, ka vendosur që t’i referohet Ligjit për rrugët dhe ka proceduar në mënyrë të përshpejtuar.

Sigurisht se lejen mjedisore edhe për ndërtimin e rrugëve, në veçanti të autostradave, duhet lëshuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por në këtë rast nuk ka pasur aplikim për leje në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Si rezultat, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk mund të lëshojë kurrfarë leje nëse nuk ka aplikim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zoti deputet? Po! Një minutë e keni.

LIBURN ALIU: Po, është dashur që Ministria e Infrastrukturës të aplikojë dhe është dashur që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të lëshojë leje, por në rastet kur nuk aplikohet dhe lëshohet leje, është Inspektorati ai i cili shkon dhe e inspekton punën, për shkak se duhet ta kemi të qartë që autostrada e Hanit të Elezit, sado e rëndësishme që është, i ka shkaktuar dëme të shumta Prishtinës, për shkak se ka qenë totalisht në kundërshtim me planet hapësinore të Prishtinës.

Ekziston një unazë, është Lagja Kalabria në atë pjesë, e ka mundur të lëshohen leje ndërtimi në ndërkohë për pronarë të ndryshëm, të cilëve totalisht u janë ndryshuar planet dhe investimet e mundshme të Komunës së Prishtinës, që kanë qenë për atë zonë, kanë mundur të rrënohet, sikur qysh ka qenë edhe projekti i unazës, për të cilin është shpenzuar dhe të cilin e ka financuar edhe vetë ministria. Ai projekt tash ka rënë poshtë plotësisht për shkak se është ndërtuar kjo autostradë pa leje.

KRYESUESI: Zonja ministre, pyetja është për ju. Ju lutem që të ktheni përgjigje.

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

Jam e informuar faktikisht për gjithë planin urbanistik të Komunës së Prishtinës, edhe për planin e autostradës. Sërish po e theksoj që ekziston një ligj, në të cilin është bazuar Ministria e Infrastrukturës dhe është marrë me këtë çështje. Nuk ka pasur aplikim në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjithsesi jam duke e shqyrtuar rastin dhe duke shikuar nëse ka pasur ndonjë shkelje të ligjit në këtë rast. Besoj që së bashku me ministrin e Infrastrukturës do të vijmë në përfundim të kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, edhe një pyetje për ministren Albena Reshitaj. Urdhëroni, zoti deputet!

LIBURN ALIU: Meqenëse në buxhetin që e trajtuam dhe në projektbuxhetet dhe buxhetet e viteve të kaluara kemi parë shumë projekte që bien në kategorinë e tretë, për të cilat duhet të merret leje, kisha dashur të di që nga fuqizimi i Ligjit për ndërtim e deri më sot sa leje ndërtimi të kategorisë së tretë i ka lëshuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor? Po flas për të kaluarën, e di zonja ministre që kjo nuk ka të bëjë me ju direkt, por dua ta di sa leje të ndërtimit të kategorisë së tretë deri më sot, prej se është ligji në fuqi, janë lëshuar?

Pra, kemi të bëjmë me Ligjin 04/L-110 të ndërtimit. Kjo kategori e ndërtimeve, pra kategoria e tretë, është në kompetencë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

KRYESUESI: Ministrja Reshitaj e ka fjalën. Urdhëroni!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: Faleminderit!

Faleminderit për pyetjen, deputet!

Ligji nr. 04/L-110 për ndërtimin, neni 19 i jep kompetencë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që për objektet ndërtimore të kategorisë së tretë të japë leje ndërtimore. Në shtojcën e këtij ligji janë të listuara 18 lloje të objekteve të kategorisë së tretë.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke ditur se këto objekte janë të një rëndësie të veçantë dhe me interes për vendin, vepron gjithnjë apo duhet të veprojë në mënyrë efektive dhe t'i trajtojë kërkesat për leje të ndërtimit. Për kërkesat e kompletuara, leja e ndërtimit mbërrin tek aplikuesi gjithmonë brenda afateve, të cilat i përcakton ky ligj. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga viti 2012 e deri më tani, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bazë të informacioneve që kam marrë nga Departamenti për Planifikim Hapësinor brenda ministrisë, ka lëshuar 31 leje ndërtimore. 22 leje ndërtimore janë objekte me interes për vendin, 9 leje

ndërtimore në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri”, gjithmonë sipas pikës 1.9 të Shtojcës 1 të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë? Po, urdhëroni!

LIBURN ALIU: Po më duket numër jashtëzakonisht i vogël, 31 leje ndërtimi prej vitit 2012 deri tash për tërë këtë periudhë, kur e dimë sa e sa projekte i kemi pasur nëpër buxhete, që janë projekte të ministrive të ndryshme, që bien në kategorinë e tretë.

Besoje që ka shumë ndërtime të tilla, që janë bërë pa leje, por kisha dashur të di a janë këto leje të publikuara në ueb-faqe? A janë të publikuara këto 31 leje në ueb-faqen e ministrisë?

KRYESUESI: Urdhëroni, zonja ministre!

MINISTRJA ALBENA RESHITAJ: I nderuar deputet,
Në bazë të informacioneve që kam, gjithmonë bazohem në Departamentin e Planifikimit Hapësinor brenda ministrisë, thuhet që janë të publikuara në Gazetën Zyrtare dhe njëherësh dua të ju informoj se ne e kemi proceduar Draftligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe jemi duke punuar në mënyrë të përkushtuar që ta funksionalizojmë ligjin dhe të vazhdojmë me Ligjin për ndërtimet pa leje, faktikisht t’i trajtojmë edhe më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministri Shyqiri Bytyqi. Deputeti Kurteshi s’është në sallë.

Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. Urdhëro, Arbër!

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje!

Me ministrin Kujtim Gashi ne e kemi një histori pozitë-opozitë. Tash në Prizren pozitë ne, ata opozitë, por megjithatë unë e kam parashtruar pyetjen para disa javësh, pra para se të dalin rezultatet përfundimtare. Megjithatë, ministri Gashi është ministër i Kulturës, domethënë e di shumë mirë çështjen e trashëgimisë kulturore të mbrojtur me ligj në Prizren.

Pra, ministër, unë kam pyetur sa objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike janë dëmtuar nga paslufta?

Së dyti, sa objekte prej tyre janë dëmtuar për të dytën herë dhe çfarë masash janë ndërmarrë, në fakt, nga ju dhe sigurisht ju kur e keni marrë ministrinë, e keni parë se çfarë masash janë ndërmarrë edhe nga ministri.

Po e lë si përgjigje, e më pastaj do të vazhdoj sërish të flas për atë të cilat do t'i them si çështje.

KRYESUESI: Ministri Gashi e ka fjalën. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra,

I nderuar deputet Rexhaj,

Gjendja e aseteve të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit nuk ishte në nivelin e kënaqshëm që nga vitet e pasluftës, për të mos thënë edhe para luftës, e veçanërisht në vitet e '90-ta, kur qytetarët e komunës së Prizrenit e kanë në kujtesë se edhe në atë kohë kishte ndërhyrje të paautorizuara në disa prej monumenteve të trashëgimisë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit.

Por nëse i kthehem çështjes së shtruar nga ana juaj, i nderuar deputet, mund të thuhet se mentaliteti i ngjashëm i dëmtimit të aseteve dhe trashëgimisë kulturore apo objekteve të rëndësisë së veçantë ka vazhduar edhe në periudhën e pasluftës në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ku kjo “praktikë” jo e mirë është përhapur edhe në Prizren.

Përkundër faktit se përgjatë vitesh aprovimi i ligjeve dhe krijimi i shumë mekanizmave të rinj nuk kanë sjellë ndonjë efikasitet në ruajtjen e zonave urbane dhe atyre të mbrojtura, e kjo ka ardhur si pasojë e veprimeve të paautorizuara të personave apo shkelësve të ligjit, e në disa raste edhe nga moszbatimi i ligjit nga ana e institucioneve kompetente.

Nga ana e profesionistëve të fushës së trashëgimisë kulturore gjatë takimeve që kam zhvilluar pasi e kam marrë mandatin si ministër, rezulton se menaxhimi i integruar i zonës historike të Prizrenit mbetet zgjidhja më e mirë për këtë qytet, në vend se t'i lëmë pas dore, ta braktisim apo ta shlyejmë trashëgiminë tonë urbane, duhet të angazhohemi që të bëjmë urbanizmin e integruar, i cili do të mundësonte ruajtjen e ndërtesave, lagjeve dhe peizazheve natyrore që i vlerësojmë për rehabilitim, kërkon, rikthen ose rinovon ato që nuk janë në gjendje të mirë dhe shton atë që nuk e kemi, po e dëshirojmë.

Në bazë të informatave të marra nga përfshirja efektive në komunitet, sido që të jetë, edhe përkundër të gjitha sfidave dhe problemeve të shumta që ka fusha e trashëgimisë kulturore, mund të konstatoj se gjatë këtij viti janë bërë hapa tepër serioz në përmirësimin e gjendjes së aseteve të trashëgimisë kulturore jo vetëm në komunën e Prizrenit, gjegjësisht në qendrën historike, por edhe në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

MKRS ka ndarë buxhet të mjaftueshëm për hartimin e planit të menaxhimit të Qendrës historike të Prizrenit, dokument i cili është duke u punuar nga një grup profesionistësh në përbërje prej shoqërisë civile, institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal.

Me të marrë mandatin si ministër i MKRS-së, pas skadimit të gjendjes për sektorë të veçanta, kam vërejtur se edhe përkundër faktit që Ligji i trashëgimisë kulturore e parasheh themelimin e Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, deri më tani ky mekanizëm ka munguar. Andaj, kam kërkuar nga ana e zyrtarëve kompetentë që pa humbur kohë të procedojnë me hapjen e konkursit për të rekrutuar inspektorët, të cilët janë tepër të rëndësishëm për trashëgiminë kulturore.

Tani, në bazë të raporteve që kam, procesi rekrutimit të stafit të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore është në procedurë.

Konsideroj se ky mekanizëm shtetëror, i cili fatkeqësisht deri më tani nuk ka qenë i themeluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zoti deputet. Urdhëroni, një minutë!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë e pyeta ministrin Gashi për numrin, në fakt, nuk m'u përgjigj. E kam pyetur për numrin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Prizren, saktësisht pra që nga paslufta sa kanë qenë të dëmtuara, kjo ka qenë pyetja e parë.

Pyetja e dytë ishte: sa prej atyre objekteve janë së dyti, së treti a së katërti herë të dëmtuara, pra të shkatërruara?

Tash po e bëj sërish të njëjtën pyetje se nuk m'u përgjigj, ishte një përgjigje e përgjithshme dhe ministri tha për këtë përgjegjëse janë institucionet gjegjëse.

Ministër, cilat janë ato institucione gjegjëse, sepse brenda asamblesë, thashë, kemi pasur një histori të përbashkët. Unë atëherë kam qenë kuvendar, ju keni qenë kryesues, edhe atëherë ju pata pyetur kush është institucioni përgjegjës për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI KUJTIM GASHI: Arbër, edhe një herë, nuk e kam të qartë kush është institucioni përgjegjës për mbrojtjen a për shkatërrimin, se e the për shkatërrimin.

Në fakt, nëse flasim për mekanizmat, ju e dini që ka mekanizma edhe prej nivelit lokal, ka edhe prej nivelit qendror, nëse flasim cili është mekanizmi për ruajtje, e përsërita edhe në përgjigjen që e kisha.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit deri më tani nuk ka pasur inspektorat të themeluar dhe ky inspektorat do të fillojë të operojë nga janari i vitit 2018, i cili po e përsëris, është shumë i rëndësishëm për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Nëse i referohemi pyetjes se sa asete janë të shkatërruara, unë e thashë se që nga paraluftra ka objekte të shkatërruara, ky avaz ka vazhduar edhe nga pasluftra deri në ditët e sotme, por e theksova që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndërmarrë të gjitha veprimet, në mënyrë që të ruhen këto pjesë që kanë mbetur.

Si ministri nuk kemi numër të saktë se sa objekte janë shkatërruar, nëse dëshironi t'u referoheni numrave të organizatave, për ne ata numra nuk janë të saktë, por sido që të jetë, ministria do ta bëjë një hulumtim dhe do të dalë shpejt me numrin e saktë të këtyre objekteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arbër, nuk keni të drejtë, s'kam të drejtë as unë, por po jap një sqarim shtesë, nëse nuk keqkuptohet. Nuk është problem trashëgimia kulturore as në Prizren, as në Qendrën historike, problem janë interesat përreth, trashëgimia kulturore atje është fizike dhe për atë kthehet në problem, sepse ka zërë hapësirën.

Objektet më të shkatërruara kanë qenë në rrugën "Marin Barleti", kanë qenë 12 objekte, në të cilat është ndërhyrë dhe janë në një gjendje shumë më të mirë. Inspektorat Kosova nuk ka pasur, sepse s'e parasheh Ligji për trashëgiminë, edhe tani e tutje nuk do të ketë inspektorat, zoti ministër, do të rekrutohen pesë inspektorë. Te drafti i Ligjit të ri për trashëgiminë kulturore ne kemi paraparë që të themelohet edhe ai institucion. Ndërkaq, përgjegjës, Arbër, është Task-forca, të cilën e ka themeluar dhe e udhëheq Ministria e Ambientit. Faleminderit!

Kalojmë te pyetja e radhës. Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Skender Reçica.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me çështjen për statusin për të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, i cili është miratuar më 25 maj 2016, kurse është dekretuar më 13.6.2016 nga presidenti.

Mirëpo kjo kategori nuk ka filluar t'i gëzojë kompensimet edhe benifitet që ua njeh ky ligj, tek neni 25 të këtij ligji është paraparë që më 1 janar 2017 këta persona të fillojnë t'i gëzojnë të drejtat e tyre.

Pyetja ime drejtuar ministrit ka të bëjë: Në kuadër të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale a është planifikuar buxhet për këta persona në Projektbuxhetin për vitin 2018, nëse po, sa është shuma e planifikuar dhe sa është numri i përfituesve?

Cilat janë planet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që këta persona t'i gëzojnë sa më shpejt të drejtat dhe përgjegjësitë që u takojnë me dispozitat ligjore të këtij ligji?

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Urdhëroni, zoti ministër, e keni fjalën, tre minuta.

MINISTRI SKENDER REÇICA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

E nderuar deputete Kalludra,

Faleminderit për pyetjen,

Ligji numër 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është miratuar në vitin 2016.

Me këtë është paraparë që nga janari 2017 këta persona të fillojnë të gëzojnë të drejtat e tyre.

Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësitë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershëm mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Sa i përket aplikimit të përfituesve sipas këtij ligji, procesi i parashtrimit të kërkesave ka filluar nga data 24 prill 2017 e deri më tani kanë aplikuar 1669 persona për të drejtën në kompensim mujor.

Komisionit mjekësor për vlerësimin e përfituesve të këtij ligji deri më tani i janë nënshtruar 669 persona dhe është duke u vazhduar puna në vlerësimin e aplikuesve të tjerë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka përgatitur dhe dërguar propozim- vendimin për shqyrtim dhe miratim në Qeveri për caktimin e kompensimit të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe kujdestarët personalë, i cili është miratuar me vendimin nr. 07/10 të datës 27.10.2017 dhe është caktuar kompensimi mujor në vlerë prej 150 eurosh.

Shqetësues është fakti se në Ligjin e buxhetit të vitit 2017 nuk është paraparë buxhet për kompensimin e këtyre personave, siç është paraparë me ligj.

Ndërsa sa i përket vitit 2018, ju informoj se në Projektbuxhetin 2018 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm për kompensimin e këtyre përfituesve të kësaj kategorie.

Si ministri, në Projektbuxhetin 2018 kemi planifikuar që për pensione të aftësisë së kufizuar dhe pensionet për paraplegjikë dhe tetraplegjikë në total të kemi 21 milionë e 130 mijë euro, shumë kjo që do të mjaftojë për kompensimin e pagesave të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: A keni pyetje shtesë? Urdhëroni!

MIRJETA KALLUDRA: Për sqarim të qytetarëve, pyetja është parashtruar para se të bëhet Projektbuxheti për vitin 2018 dhe duke qenë si anëtare e Komisionit për të Drejtat, është kërkesë e vazhdueshme e tyre. Ju falënderoj për përgjigjen, ministër.

KRYESUESI: Faleminderit!

Kalojmë te pyetja e radhës. Deputetja Evgjenie Thaçi-Dragusha, pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli, me sa shoh asnjëri nuk është në sallë.

Deputetja Mirjeta Kalludra, pyetje për ministrin Skender Reçica, pyetja e radhës, urdhëro Mirjeta!

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Pyetja ka të bëjë me Ligjin për veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili është ndryshuar me Ligjin 05/L-141, i cili e ka paraparë që të bëhet kategorizimi i veteranit, luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK.

Pyetja parlamentare drejtuar ministrit është: A është formuar Komisioni për kategorizimin e veteranit luftëtar të UÇK-së si dhe a keni planifikuar buxhet të mjaftueshëm për veteranët e UÇK-së në Projektbuxhetin 2018? Nëse po, sa është shuma e mjeteve të planifikuara, si dhe cilat janë planet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që kjo çështje me pensionet e veteranëve të UÇK-së të përmbillet në mënyrë që t'i marrin rregullisht pensionet e tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

E nderuar deputete Kalludra,

Faleminderit, përsëri për pyetjen tuaj!

Kategorizimi i veteranit luftëtar të UÇK-së bazohet në Ligjin numër 05/L-141 për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky ligj është miratuar në Kuvend më 30.12.2016, kurse është shpallur me dekretin e presidentit të Republikës së Kosovës numër 2/L-016 2017 më 22.4.2017.

Në mbështetje të këtij ligji, Ministra e Punës dhe Mirëqenies Sociale tashmë ka hartuar draft-rregulloren dhe funksionimin, përbërjen, organizimin e punës dhe procedurat e procesit për kategorizimin e veteranëve luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila është përcjellë për miratim në Qeveri.

Për shkak të ndryshimeve në Zyrën për çështjen e kategorive të dala nga lufta në kuadër të Zyrës së kryeministrit, do të ndryshohet dhe plotësohet vendimi i datës 21.7.2017 për themelimin e Komisionit për kategorizimin e veteranit luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në përbërje të këtij komisioni, sipas ligjit të cekur më lart, do të jetë një përfaqësues i Zyrës së çështjeve të kategorive të dala nga lufta, në kuadër të Zyrës së kryeministrit, një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe një përfaqësues i organizatave të veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Miratimi i kësaj rregulloreje dhe kompletimi i komisionit do të ndodhë brenda një kohe shumë të shkurtër dhe me këtë do të hapet mundësia e fillimit të punës për kategorizimin e veteranit luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sipas ligjit në fuqi.

Sa i përket planit për kompensimin e rregullt të pensionistëve të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Projektbuxhetin 2018 ka paraparë mjete të mjaftueshme, 58 milionë e 750 mijë euro janë paraparë për pensionet e veteranëve për vitin e ardhshëm. 38 milionë euro janë paraparë për pensionet për invalidët e luftës, në total për këto kategori do t'i kemi 96 milionë e 750 mijë euro, shumë kjo e cila në bazë të kalkulimeve do të mbulojë koston e pagesave të veteranëve për vitin 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja deputete? Jo. në rregull.

Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, kryeministri nuk është në sallë, a dëshironi të bëni pyetjen?

IMET RRAHAMNI: Jo, faleminderit! Derisa të jetë kryeministri, nuk do ta bëj pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli, me sa shoh edhe ministri Ismajli, nuk është. A dëshironi të bëni pyetjen?

IMET RRAHMANI: Po këtu do ta kisha dhënë vetëm një konstatim, meqenëse ministri nuk është këtu.

KRYESUESI: Pyetje, Imet...

IMET RRAHMANI: Po, do ta sqaroj, edhe brenda pyetjes se çka është.

KRYESUESI: Dëshironi ta bëni pyetjen, e keni fjalën.

IMET RRAHMANI: Fjala është për mosnënshkrimin e kontratës për spitalin e Ferizajt. Kjo procedurë ka marrë shumë kohë deri te ardhja në këtë pikë dhe komplet viti 2016 dhe fillimi i vitit 2017 ka qenë edhe periudha kur është hartuar projekti, edhe periudha kur bashkërisht me Komunën e Ferizajt dhe me aktorë të tjerë ne kemi shtyrë përpara procesin e fillimit të ndërtimit të spitalit të Ferizajt.

Tash pas kalimit dy herë nëpër organe të shqyrtimit publik, është kthyer vendimi definitiv në Ministrinë e Shëndetësisë dhe prej fillimit të tetorit nuk po nënshkruhet kontrata. Pyetja është: Pse po zvarritet shtyrja e kontratës me operatorin ekonomik për fillimin e ndërtimit të spitalit të Ferizajt?

E për rëndësinë e spitalit të Ferizajt, ndërtimit të një spitali të ri për Ferizajin besoj që nuk ka nevojë të humbim kohë më shumë. Pyetja, pra është, besoj që do ta marrë dikush nga qeveria, pse po shtyhet që dy muaj ditë, pasi janë mbyllur të gjitha procedurat, nënshkrimi i kontratës për fillimin e ndërtimit të spitalit të Ferizajt?

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë ministri nuk është këtu, kalojmë te pyetja e radhës. Deputetja Vjosa Osmani-Sadriu, pyetje për ministrin Uran Ismajli, sa shoh asnjëri nuk janë në sallë.

Deputeti Frashër Krasniqi, pyetje për ministrin Shqyri Bytyçi, Frashëri nuk është në sallë.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Uran Ismajli, zonja deputete, a dëshironi të bëni pyetjen, me që ministri nuk është në sallë? E keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Megjithëse është hera e dytë që procedohen pyetjet në Kuvend dhe sot është hera e fundit që vijnë pyetjet këtu, po e shfrytëzoj rastin t'i lexoj pyetjet parlamentare me shpresë që ministri Uran Ismajli do të kthejë një përgjigje me shkrim dhe do të zotohem para qytetarëve që do t'i publikoj në faqet time në Facebook, po gjithsesi do të provoj t'i arkivoj edhe në Kuvend nëse do të marr një përgjigje me shkrim nga zoti Uran.

Duke pasur parasysh që në rastet emergjente, siç janë aksidentet në trafik, zjarrvëniet apo aksidente të natyrave të tjera me rrezikshmëri të lartë, të parët që arrijnë në vendin e ngjarjes, para policisë dhe zjarrfikësve, gjithmonë janë punëtorët mjekësorë të ndihmës së parë.

Pyetja ime për ministrin do të ishte. Marrë parasysh rrezikshmërinë e lartë në punë, kur këta punëtorë do të paguhen për shkallën e rrezikshmërisë? Do të thotë, edhe sot e kësaj dite këta punëtorë, të cilët janë gjithmonë të ekspozuar ndaj rrezikut, nuk e kanë të paguar shkallën e rrezikshmërisë në punë. Prandaj, kjo është pyetja konkrete, shpresoj që në të ardhmen do ta kem një përgjigje me shkrim prej ministrit.

KRYESUESI: Faleminderit! Prapë ju, Ganimete, e keni edhe një pyetje për ministrin Uran Ismajli, e keni fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Po, pyetja ime e dytë që prapë i drejtohet ministrit të njëjtë, ministrit të Shëndetësisë, zotit Uran Ismajli, është për infermieret, të cilat kanë përfunduar Fakultetin e Infermierisë në Kosovë dhe paguhen me koeficientin e njëjtë sikur infermieret me shkollën e mesme. Pyetja konkrete është: a do të ketë ngritje të koeficientit për këto infermiere, të cilat kanë kualifikim universitar? Nëse jo, cili është motivi që studentet tona të studiojnë infermierinë në Kosovë në të ardhmen, përderisa këto trajtohen barabartë?

Shfrytëzoi rastin, me që ministri nuk është këtu, edhe një herë të marr një minutë kohë, nëse më lejohet, ta ngre një çështje shumë të shkurtër. Sot erdha nga Polaci, kur është përvjetori i Mujë Krasniqit dhe 35 dëshmorëve të rënë në kufij, sinqerisht e them, erdha me turp nga atje si pjesë e institucioneve të Republikës së Kosovës duke e parë gjendjen e katandisur të varrezave që janë atje.

Me kërkesën e shumë familjarëve që i takova sot në Polac, apeloj urgjentisht tek institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, në këtë rast te Agjencia për menaxhimin e kompetencave të memorialëve të Kosovës dhe gjithashtu te shoqatat e dala nga lufta, përkatësisht te Shoqata e familjeve të dëshmorëve dhe të gjithë ata të cilët janë përgjegjës që urgjentisht të ndërmarrin diçka, sepse ato varreza tashmë po i humbin edhe gjurmët e mundshme. Prandaj, edhe një herë thërras në ndërgjegjen e secilit prej nesh që jemi këtu që të bëjmë diçka që ato varreza të trajtohen dinjitetshëm dhe thjesht atyre qytetarëve, të cilët sot i takova, t'ua lëmë vetëm dhimbjen dhe mungesën e familjarëve të vet dhe jo edhe problemin dhe brengën për gjendjen e mjerueshme të atyre varreza sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Për çështjen që e ngritët ju, kryeministri dëshiron të japë një përgjigje dhe kryeministri ka të drejtë në emër të Qeverisë. Urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Pyetjet për ministrin Ismajli, jam edhe unë i pakënaqur si ti që nuk është në seancë dhe po ju them që çdo ministër që nuk vjen në seancë është kundër përcaktimit tim, edhe të Qeverisë. Si do të veprojmë ndaj tyre, do ta vlerësojmë së bashku, po nuk është në rregull të mos vijnë ministrat në pjesën që u dedikohet atyre. Ua kam thënë këtë edhe në Qeveri, ua kam thënë kryetarëve të partive të koalicionit, le të jetë kjo vërejtja e fundit për kolegët e mi ministra, të gjithë duhet të vijnë në seancë.

Njëkohësisht nuk ishte e mirë as sjellja ime, nuk isha këtu kur u parashtruan pyetjet nga deputeti Imeti, kërkoj falje.

Sa u përket varrezave në Polac, vërtet ashtu është, kam qenë dhe në raste të caktuara i kam vizituar. Respekti e nderimi për të rënë për liri është diçka që e gjithë Kosova e bën. Tani me që jemi në dimër, mund ta shfrytëzojmë kohën në planifikim, pra në projektim dhe do të interesohem për këtë temë.

Me sa di unë, nuk jam krejt i saktë, ka pasur një, ta quaj ashtu, një ndarje se a duhen të mbeten aty, apo të shkojnë në Morinë. Tani do të bisedoj edhe me kryetarin e komunës atje, edhe me shoqatën e luftës, me zotin Bekim Jasharin, kryetarin e ri të Komunës, edhe me shoqatat e dala nga lufta që të merret një vendim, një afat i caktuar kohor dhe ta shfrytëzojmë pranverën që të veprojmë me ndërtimin e varrezave.

Është më se, ta quaj ashtu, njerëzore për popullin e Kosovës, në mos asgjë tjetër që të mos i lëmë pa një varr të dinjitetshëm të rënë për liri. Këtu mendoj që ne do të bëjmë kujdes edhe për martirët, për civilët e vrarë në luftë, do të ishte shumë e ndershme që në varrin e martirit të shkruhet: Nga populli i Kosovës. Pra, të paktën t'ua japim një varr të dinjitetshëm atyre që kanë rënë për liri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj! Urdhëro, zoti deputet.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër, unë e kam sjellë një peticion në zyrën tënde dhe atë peticion të njëjtë e kam dërguar edhe në AKP, në Hatmaxhë, një fshat në Prizren, janë privatizuar tokat bujqësore, ku banorët i kanë punuar me dhjetëra vjet dhe si përfaqësues i tyre ata kanë nënshkruar një peticion gjithëpërfshirës me qytetarë të prekur nga kjo ose ky privatizim dhe nëse e keni parë dhe që po besoj që e keni parë, sepse kam parë lajme nëpër medime të ndryshme, ku ju megjithatë procesin e privatizimit e keni shtyrë edhe për një vit, edhe këtë kërkoj ta di, pra edhe nga ana juaj.

Ata kanë pasur disa kërkesa, po unë po e përmend një më kryesoren, që t'u njihet e drejta e parablerjes dhe ato toka të largohen nga ky privatizim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet Rexha,

Ne kemi marrë një vendim që të pezullohet privatizimi i tokave, jo bazuar në kërkesën në fjalë ose një kërkesë të ngjashme, po e kemi një situatë jo të mirë, nuk po mund t'u ofrojmë investitorëve lokacion për investim. Ndonjë investitor, qoftë i vendit, qoftë ndonjë bashkatdhetar yni ose i jashtëm kur vjen, imagjino kur duhet ta blejë vendin ku do të ndërtojë një kapacitet e të hapë vende të punës, atij i kushton shumë. Interesimi është që në gjithë Kosovën të bashkëpunohet me komunat dhe të identifikohen zona që do të ishin për pak biznese, zona industriale, zona për investime. Tani kjo çështja e privatizimit të pronave, e kuptoj këtë temë, e kam pasur një në Gllogjan, prej nga vij unë. T'ju them të drejtën, e kam blerë një pronë në Gllogjan për një arsye, katundarët nuk kanë dashur ta lënë dikë të hyjë, bashkëfshatarët e mi, se është tokë e tyre, baba im ka punuar në të kur ka qenë fëmijë, e kooperativa e ka marrë dhe e kam blerë që t'ua kthej bashkëfshatarëve të mi.

Privatizimin e kam bërë në bashkëpunim me të katundit, për fat na kanë mirëkuptuar të gjithë, janë disa vendbanime përreth, për shembull, një pjesë tani është një fshat tjetër, Shaptej, e tjerë, ata nuk lënë askënd të hyjë aty se e konsiderojnë vërtet tokë të veten. Problemi është që nëse është privatizuar, me dokumente e me të gjitha procedurat, atëherë është pak më vështirë ndërhyrja dhe duhet të kërkojmë ndihmën ose të gjuqësorit, ose s'di çfarë forme. Po e kuptoj temën, nëse në këto raste më së miri është kur banorët për një pronë që është shumë afër shtëpive të tyre, ose të cilën e kanë punuar, ose që ka qenë ndoshta e tyre më herët, ata të bashkorganizohen dhe ta blejnë vetë. Pra, edhe një herë, fatkeqësisht nuk ka formë tjetër në bazë ligjore për kthim të pronave të ne, nuk është ndërmarrë ose nuk është ndërtuar një bazë e këtillë.

Mirëpo, unë do t'i pyes edhe një herë në AKP pikërisht për statusin të kësaj prone në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: A keni pyetje shtesë? Po, një minutë!

ARBËR REXHAJ: Kryeministër, AKP-ja mua më ka kthyer përgjigje zyrtare dhe ju e dini se çfarë ka mundur të shkruajë, mund ta paramendoni që, megjithatë AKP-ja në përgjigjen e saj mua më ka treguar për detyrat, të cilat i ka dhe përgjegjësitë në të cilat edhe nuk mund të përgjigjet dhe as të ndërhyhet.

Mirëpo, çështja, ju e dini, nëpër fshatra gjithandej të Kosovës dhe konkretisht në këtë fshat ekziston një mentalitet, ku ata e kanë përdorur tokën e tyre me vite të tëra për aktivitete

bujqësore dhe se ekziston një vullnet i përgjithshëm i të gjithë qytetarëve të fshatit që ato toka t'i blejnë vetë. Prandaj, domethënë në këtë rrafsh edhe ishte pyetja ime dhe ata kërkojnë ndihmën e Qeverisë, sepse ju e dini, që AKP-ja çfarë statusi ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën edhe një herë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar deputet!

Pra, duke mos dashur të konkludoj tash se, megjithatë është një procedurë interesimi për këtë situatë. Do të interesohem të shoh, a ka instrumente të caktuara që Qeveria mund të veprojë, megjithatë është i ndjeshëm procesi i privatizimit, besoj edhe ju e kuptoni këtë, nëse ka procedente të kthimit të pronës, nëse ka ndodhur privatizimi, ju e dini çka nënkupton kjo në përgjithësi.

Ju kujtohet ndoshta, ka pasur shumë kundërshtime për mënyrën e privatizimit, duke mos qenë perfekt, mirëpo edhe ka kundërshtime dhe pretendime në pronë jo vetëm nga ne që jetojmë në Kosovë, por nga plot të tjerë. Ka qenë besoj veprim i mençur i Kosovës në atë kohë që të kalohet nëpërmjet procesit të privatizimit statusi i pronës ose t'u mundësohet individëve, personave privat edhe juridik, pra kompanive që të kenë të drejtë në këtë mundësi, në ofertë.

Tani nuk po e zgjas më shumë, por do të interesohem për të.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Urdhëro, zoti Zharku!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Ministri Lekaj, ju keni deklaruar që unë kam nënshkruar projekte natën, publikisht dua ta sqarojmë këtë çështje, çka kam nënshkruar, kur e kam nënshkruar, kush ka qenë me mua, kur e kam nënshkruar. Natyrisht, po kërkoj prej jush të ma sillni projektin apo kopjen e nënshkrimit tim që unë e kam nënshkruar. Së paku, kështu kanë raportuar media, nëse është gabim, kisha dashur prej jush ndoshta jo kërkim falje, por një sqarim pak më të hollësishëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro, zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI PAL LEKAJ: Sa i përket asaj deklaratës time, i nderuar ish-ministër, e kam thënë saktësisht që procedura për Gjilanin është përsheptuar, sikur të ishim në kohë të jashtëzakonshme. Unë i di procedurat që ministri nuk nënshkruan procedura të prokurimit, përpos kur është mbyllja e kontratës apo që përfiton kontratën, prandaj nuk ta kam përmendur

emrin. Sa i përket nënshkrimit të ndonjë kontrate, sepse nuk është nënshkruar kontrata, është në procedurë, por e kam thënë që komisioni vlerësues e ka bërë me nguti dhe në praktikat e prokurimit publik dhe të vlerësimit të tenderëve nuk ka qenë që pas orarit të punës të njoftohen kompanitë apo operatorët, e favorshëm apo jo të favorshëm.

Në orën 18:00 ka filluar, më 8 shtator 2017, nga komisioni përkatës të informohen kompanitë respektive për përzgjedhjen e tyre apo mospërzgjedhjen e tyre dhe kjo nuk e di vetëm në kohë të jashtëzakonshme duhet marrë vendime, sepse edhe pse është ndërruar Qeveria dhe i kemi marrë përgjegjësitë më 11 shtator 2017, nuk është dashur po të njëjtën ditë, pa u kryer procedurat, këtë e kam thënë dhe unë nëse ta kam përmendur emrin, kërkoj falje, por nuk kam thënë që ke nënshkruar kontratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj është e qartë, dëshironi pyetje shtesë? Urdhëro!

LUTFI ZHARKU: Ministër, faleminderit për këtë kërkim falje, megjithatë kisha dashur të di çka kam pasur unë lidhje me çfarëdo procedure, nëse një muaj para se të vini ju e kam lëshuar ministrinë.

Pse unë të apostrofohem, përpos nëse mendoni që unë prej shtëpisë e kontrolloj ministrinë.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën. Pas përgjigjes që do të jap ministri, ju njoftoj që kemi kohë edhe për një pyetje parlamentare, pastaj do të kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës. Faleminderit!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar ish-ministër,

E keni një nënshkrim për fillimin e shpalljes së tenderit. Më 28. 04. 2017 dhe këtu janë të nënshkruar jo të gjithë drejtuesit e Komitetit ndërministror, por janë të nënshkruar vetëm tre ministra që vijnë nga LDK-ja. Këtë për procedurën e Gjilanit, këtë e kam thënë, dhe prapë insistoj që është dëshmi.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e fundit për sot, deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Urdhëro, zonja deputete!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Vetëm një vërejtje, kur e përmendët Frashërin, Donikën, Ismajl Kurteshin, duhet ta keni parasysh që as Donika, as Frashëri nuk janë këtu, për shkak se janë në burg padrejtësisht dhe politikisht. Po ashtu, as Ismajli për shkak se shkoi në seancë gjyqësore për gazin lotsjellës, domethënë po pengohet që ta ushtrojë detyrën e tij prej deputeti, por edhe Albini do të duhej sot të ishte këtu, në karrigen që kam afër, mirëpo s'është, sepse edhe ai është në burg. Kështu është mirë kur t'i thirrni emrat e tyre, t'i përmendni arsyet se pse s'janë këtu.

Pyetja ime për kryeministrin është se cili është qëndrimi i zotit Haradinaj për Marrëveshjen për drejtësinë?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën, por ju lutem, më jepni një minutë kohë të sqaroj zonjën deputete. Unë nuk mund të paragjykoj pse deputetët s'janë këtu, ka dhe të tjerë që s'janë këtu dhe unë nuk e di pse nuk janë këtu. Unë e kam për detyrë në bazë të Rregullores të shikoj dhe të konstatoj janë në sallë ose jo.

Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me leje, tani e nderuar deputete Haxhiu, e para edhe në një seancë paraprake kam propozuar që të nxirret një nen, nëpërmjet të cilit këto vepra për të cilat akuzohen deputetët mund të abrogohen, pra edhe të merret një vendim ose amnisti, ose e një shkalle të plotfuqishme që deputetët për veprimet e tyre, për kundërshtimet politike, për veprat që kanë ndodhur në Kuvend të Kosovës të ndërpritet kjo praktikë. Jam i bindur që në koalicion qeverisës, edhe nga Qeveria, edhe nga deputetët do të kishte një mirëkuptim për këtë, besoj edhe në opozitë.

Por, megjithatë mendoj se është nderin e Parlamentit t'i japim një epilog kësaj historie të mbajtjes në paraburgim, edhe të Qeverisë, edhe të Kosovës, edhe të gjithë neve, të deputetëve të Kuvendit. Po ashtu kishte qenë në rregull që të iniciohet Ligji për imunitetin e deputetëve. Nuk jam unë më i miri ekspert ligjore, por kam dëgjuar prej ekspertëve se nuk i përmbush parametrat e imunitetit ky ligj, nëse ju jeni dakord lëreni ashtu. Unë kam qenë deputet, nuk kam qenë i mirë në procedura dhe tani po e pyes çdoherë kryetarin, kryesuesin, Kujtimin, kur është koha për të folur, se nuk po di t'u bie në fije të gjitha këtyre.

Po kthehem te tema që e shtruat, Marrëveshja për drejtësinë është produkt i dialogut në Bruksel. Çfarë produkti? Është një produkt i tillë që të paktën e shënon një nisje të gjyqësorit në veri, kuptohet nuk e quaj perfekt, s'është perfekt, por është një nisje e gjyqësorit në veri dhe është një ndryshim përmbajtjesor për shtrirjen e ligjit edhe në veri, pra të ligjit dhe të Kushtetutës së vendit, për shkak se korniza brenda së cilës operohet janë ligjet e Kosovës dhe Kushtetuta e vendit. Kur them nuk është perfekt, Kosova ka ende rrugë e punë për të bërë, të arrijë, ta quaj ashtu, shtrirjen e ligjshmërisë dhe rendit në veri.

Megjithatë, përkundër atyre nuk po i quaj defekte që pengojnë në nisje, Kosova ka interes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Në rregull, atëherë a keni pyetje shtesë, zonja deputete?

ALBULENA HAXHIU: Sa i përket amnistisë, imunitetit të deputetit, do të kemi mundësi të tjera, s'po marr kohë, sepse shumë pak e kam kohën në dispozicion. Do të kemi mundësi të tjera të flasim, por zoti kryeministër, unë kam marrë të gjitha deklaratat e Aleancës dhe tuajat personalisht gjatë kohës sa keni qenë në opozitë, që e keni kundërshtuar goxha shumë Marrëveshjen për drejtësinë. E keni konsideruar si të padrejtë, si të dëmshme dhe, në anën tjetër, sot janë deklarime të tjera, ku po duket se po ndryshojnë qëndrimet sapo të vini në pushtet dhe për karrige, natyrisht.

Dhe, pyetja shtesë është se a jeni në dijeni se në këtë procesin e dialogut pala që ka përfaqësuar Kosovën ka vendosur t'ua njohë të gjitha aktgjykimet organeve ilegale që kanë vepruar në Kosovë? Dhe, a jeni në dijeni që këta gjyqtarë dhe prokurorë kanë nënshkruar një dokument, i cili e mohon Republikën e Kosovës, para Hashim Thaçit, ndonëse ka pasur mashtrime se kanë nënshkruar një dokument që mban emrin Republika e Kosovës, nuk është ashtu.

KRYESUESI: Kryeministri e ka fjalën, urdhëro, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Vlerësimi im në tërësi për dialogun është se pas Marrëveshjes së prillit 2013 ka një ngecje dhe i dini ato kualifikimet e mia që është humbur shumë kohë për Kosovën. Mbetet i tillë, është i tillë, është i bazuar në mungesë substance, nuk ka arsye dhe logjikë që të vazhdojë një dialog që s'i jep fund njohjes së ndërsjellë me Serbinë. Më kujtohet, e nderuar deputete, koha e pjesëmarrjes së qytetarëve serbë në zgjedhjet e para. Faqja e parë e ka pasur stemën e Kosovës, faqja e dytë njëfarë ngjitësi, OSBE-ja ka qenë në mes, tanimë veç nuk ka këso situatë, përdoret dokumentacioni i Kosovës.

Tash po vij te ky element. Ju thashë se është një nisje joperfekte, pra ju thashë dhe besoj se nuk ka dikush që e quan perfekte, por është një nisje. Nëse në këtë nisje si Kosovë jemi të qëndrueshëm, mund të rezultojë në një ligjshmëri të plotë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Edhe një herë e them, integrimi i veriut si proces nuk është aq i thjeshtë, bukur kompleks është. Qëllimi, besoj i të gjithë neve është këtu që të mundësojmë një nisje të këtij procesi, të mos ngecë në shkallën ku është. E kemi parë situatën me urën, kemi situatën me gjykatën, kemi plot situata të tjera. Unë po dua të besoj që është një nisje dhe po dua të besoj që ia mundëson Kosovës shtrirjen e ligjshmërisë në veri, edhe një herë nuk është perfekte nisja.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Ne e kemi shpenzuar kohën që e kemi në bazë të Rregullores për këtë pikë të rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Ju i keni marrë procesverbalet, por që të procedojmë, duhet të kemi kuorum. Momentalisht i kemi 49 deputetë në sallë, unë lus deputetët që të kthehen në sallë. Nëse deputetët s'kthehen në sallë dhe s'bëjnë kuorumin, në bazë të Rregullores do të jem i detyruar të ndërpres seancën.

Atëherë, unë do të jap një pauzë prej 15 minutash, domethënë deri në orën 12:15, i lus kolegët që të jenë në seancë. Nëse në atë orë s'do të kemi kuorum, do të jem i detyruar të ndërpres seancën. Faleminderit!

* * *

Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Kolegë deputetë,

Koha e pauzës ka kaluar dhe duhet ta vazhdojmë punën sipas rendit të ditës. I ftoj shefat e grupeve parlamentare për një konsultim të shkurtër. Le të afrohen këtu!

Atëherë, konstatoj që në sallë janë 62 deputetë, do të thotë kemi kuorum që ta vazhdojmë punën sipas rendit të ditës.

Jemi te pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 23, 24, 29 e 30 nëntor dhe më 5, 6, 7 e 10 dhjetor 2017?

Me sa shoh, nuk ka vërejtje. Atëherë, konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 23, 24, 29 e 30 nëntor dhe më 5, 6, 7 e 10 dhjetor 2017.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Komisioni Funkcional i Shëndetësisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Unë së pari e ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Skënder Reçica, që para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Vizioni i Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është ofrimi dhe siguri i mbrojtjes sociale për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës për personat që kanë vështirësi të hyjnë në tregun e punës, si dhe ofrimin e shërbimeve sociale për këto kategori.

Këtë vizion ne synojmë ta rregullojmë dhe avancojmë nëpërmjet hartimit të politikave legislative, përkatësisht nëpërmjet legjislacionit që e trajton fushën e ndërmarrësisë sociale, pikërisht Projektligji për ndërmarrjet sociale, që gjendet sot para jush.

Ndërmarrjet sociale sot trajtohen si modeli dhe mekanizmi më i avancuar, që për synim kanë ngritjen e shkallës së punësimit të grupeve të cenuara dhe ofrimin e shërbimeve sociale për këtë kategori. Ndërmarrjet sociale konsiderohen si alternativa më e qëlluar e politikave të punësimit për kërkimin e zgjidhjeve të reja për problemet e shoqërisë, në veçanti luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit social.

Në këtë aspekt, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bazë të fushëveprimit dhe mandatit të saj në kuadër të Programit legjislativ të vitit 2017 e ka hartuar Projektligjin për ndërmarrjet sociale. Ky projektligj është hartuar konform modeleve dhe praktikave më të mira evropiane. Objektivi kryesor i këtij projektligji është që të kontribuojë në zhvillimin e ekonomisë sociale, në përgjithësi, nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve sociale, të cilat i adresojnë çështjet sociale, duke përfshirë punësimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe të mirave në interes të shoqërisë.

Projektligji përmban rregulla që i përkufizojnë parimet e ndërmarrjeve sociale, aktivitetet e tyre dhe kushtet e punës, marrjen dhe humbjen e statusit të ndërmarrjeve sociale, organizimin dhe funksionimin e tyre dhe rregullat e kontrollit dhe mbikëqyrjes së ndërmarrjeve sociale.

Sipas këtij projektligji, ndërmarrjet sociale do të organizohen në dy forma: ndërmarrjet sociale të kategorisë A dhe të kategorisë B.

Në kategorinë A do të kategorizohen ndërmarrjet sociale që ofrojnë shërbime të ndryshme sociale, shëndetësore dhe edukative për grupet e cenuara, ku janë përcaktuar aktivitetet dhe llojet e shërbimeve që do të ofrohen. Në kategorinë B do të kategorizohen ndërmarrjet sociale, të cilat punësojnë së paku 30% të grupeve të cenuara.

Ndërmarrjet sociale do të jenë persona juridikë që kanë mundësi të gjenerimit të fitimit, por jo të shpërndarjes ndërmjet anëtarëve apo themeluesve, ndërsa fitimet e gjeneruara nga aktivitetet e tyre do t'i riinvestojnë në vazhdimin dhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme dhe rritjen e punësimit. Ndaj këtyre ndërmarrjeve do të zbatohen rregullat e transparencës dhe të kontrollit, në mënyrë që këto ndërmarrje të mos devijojnë nga qëllimi social.

Gjithashtu, për ndërmarrjet sociale që do të punësojnë persona nga kategoritë e cenuara mund të parashikohet edhe mbështetje nga programi i masave aktive të tregut të punës, siç janë: subvencionimi i pagave; praktikant në punë, por gjithashtu do të ketë edhe disa lehtësira tjera fiskale, të cilat janë të përcaktuara me këtë ligj dhe legjislacionin e politikave fiskale në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj e ofron një mundësi shumë të mirë për zhvillimin e konceptit të ndërmarrësisë sociale në Kosovë, ndërsa me aprovimin e tij do të rregullohen me dispozita ligjore fushëveprimi, përgjegjësitë, monitorimi dhe kontrolli, si dhe zhvillimi i aktiviteteve të ndërmarrjeve sociale.

Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që të ofroni kontributin tuaj që ky projektligj të miratohet nga ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, pas paraqitjes që bëri ministri hap debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonjën Besa Baftiu, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit. Urdhëroni, zonja deputete!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji për ndërmarrjet sociale

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional, para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, e shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandime.

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të projektligjit, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, marrim me radhë qëndrimet e kryetarëve, ose të përfaqësuesve parlamentarë. Sipas radhës, edhe një herë Besa, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Urdhëroni!

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Sa i përket Projektligjit të ndërmarrjeve sociale, që sot e kemi para vetes, është i njëjti projektligj që e kemi shqyrtuar në Legjislaturën e kaluar, që ka kaluar në lexim të parë dhe që i ka marrë votat e shumicës së deputetëve të Kuvendit nga të gjitha partitë që janë të përfaqësuara në Kuvend.

Ky projektligj e rregullon një fushë, siç janë ndërmarrjet sociale, koncept ky që, jo vetëm te ne, por edhe te vendet e rajonit është i ri, duke pasur parasysh që e ka shkallën e papunësisë shumë të lartë, me 55,9%, sidomos në mesin e të rinjve të moshës 25 dhe 24-vjeçare, është dashur që kaheerë ta bëjë një hap drejt adresimit të çështjeve sociale dhe rregullimit me ligj të aktiviteteve të ndërmarrjeve sociale.

Qëllimi primar i këtij projektligji për ndërmarrje sociale është përmirësimi i gjendjes social të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara në Kosovë.

Projektligji për ndërmarrjet sociale në esencë dhe si qëllim është i mirë, por kuptohet, me një qeverisje të përgjegjshme do të rregullonte këtë fushë shumë të rëndësishme.

Ky projektligj përcakton statusin e ndërmarrjeve sociale, duke filluar nga përkufizimi i ndërmarrjeve sociale, parimet, aktivitetet, kushtet e punës, organizimin, funksionimin, rregullat e kontrollit të mbikëqyrjes të ndërmarrjeve sociale dhe sanksionet.

Megjithatë ky projektligj ka mangësi, sepse nuk e ka të precizuar në asnjë nen që ndërmarrjet sociale të ofrojnë shërbime në bazë të kriterëve profesionale për fushën në të cilën veprojnë, që do të thotë me grupet e marginalizuara duhet punuar ekspertë të lëmenjve përkatës.

Pastaj, neni 5, pika 4 që përcakton fushat në të cilat ndërmarrjet sociale mund të zhvillojnë veprimtarinë që është, për mendimin tim, një e padrejtë, sepse i ka të përcaktuara vetëm disa veprimtari, siç janë: kultivimi dhe rritja e erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore, konservimi i frutave dhe perimeve nga ekonomitë familjare.

Duhet bërë zgjerimi i fushëveprimit të ndërmarrjeve sociale në përputhje me aktivitetet shoqërore në Kosovë.

Po ashtu te neni 5, pika 3 që ka të bëjë me aktivitetet e ndërmarrjeve sociale të kategorisë a, nuk definohej qartë fushat e aktiviteteve. Për shembull, te neni 3.1 ku thuhet se “Asistenca sociale dhe mbështetje për sistemin është term i gjerë”, çka përfshin asistenca sociale duhet të përcaktohet.

Te neni 25, që ka të bëjë me subvencionimin e ndërmarrjeve sociale që punësojnë persona nga grupe të cenuara nga neni 6 ka të drejtë përkrahje nga programet e subvencionit të pagave për punonjësit që bien në këtë kategori. Nuk ceken subvencionet nga kush, nga ministria, apo nga komuna.

Ky projektligj si e tillë ka mangësi, por besojmë se në mes të dy leximeve komisioni do të bashkëpunojë me organizatat të cilat e mbështetin këtë lëmi dhe do të shikojnë përvojat e vendeve të rajonit, në atë mënyrë që të bëjmë një ligj, i cili është i zbatueshëm në praktikë dhe nga ky të përfitojnë grupet e marginalizuara, të bëhet integrimi i tyre në shoqëri nëpërmjet punësimit të ndërmarrjeve sociale.

Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Haxhi Avdyli. Urdhëro, Haxhi!

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues Shala,
Të nderuar deputetë,

Ligji për ndërmarrjet sociale konsideroj se është një hapje e perspektivës për aktivizimin më të madh social të grupeve të cenuara dhe me këtë ligj grupet e cenuara nuk janë më pasive në krijimin e mirëqenies për veten dhe për shoqërinë, por krijohen kushte që të aktivizohen dhe me ndihmën edhe të shtetit të krijohen vende pune për këta dhe të ardhura shtesë edhe për këta persona, por edhe për ndërmarrjet të cilat gjenerojnë apo ku punojnë këto grupe të cenuara.

Mendoj që iniciativa e Qeverisë së kaluar dhe e ministrit të Qeverisë së kaluar Abrashi, por edhe procedimi i tanishëm i ministrit të kësaj Qeverie është për t'u përshëndetur dhe për t'u përgëzuar dhe mendoj që ky ligj ka impakt pozitiv të të gjitha grupet, veçanërisht të grupet e cenuara, të cilat janë barrë edhe për shtetin, por edhe për familjen, por edhe krijojnë një pasivitet më të madh për këto grupe.

Në këtë drejtim, mendoj që edhe në këtë ligj ka mangësi të ndryshme, të cilat duhet të rishikohen, duhet të qartësohen qartë të gjitha nenet, edhe të subvencionimeve, por edhe mekanizmat shtesë për kontrollimin e këtij ligji, duhet të krijohen mekanizma shtesë ligjorë për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme nga firma apo personat të cilët në emër të ndërmarrjes sociale mund të shfrytëzojnë këtë ligj për rritjen e fitimeve dhe mosrespektimin e neneve apo kuotës së caktuar, të cilën duhet respektuar.

Mendoj që në këtë ligj, nëse respektohet dhe krijohen mekanizmat shtesë ligjorë që të mos keqpërdoret dhe duke e rritur edhe gamën e aktiviteteve biznesore që përfshin ky ligj, mendoj që krijon një perspektivë të re për grupet e ndryshme të cenuara, grupet më aftësi të kufizuara, grupeve të personave përfitues të skemave sociale dhe, në këtë drejtim, është një përfitim i gjithanshëm për gjithë shoqërinë, edhe për shtetin, por edhe për këto grupe.

Ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike i japim përkrahje aprovimit të këtij ligji dhe, në ndërkohë, ndërmjet leximeve do të kontribuojmë edhe më tutje në përmirësimin eventual të ndonjë mangësie që mund të gjendet brenda këtij ligji.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Bekim Haxhiu. Urdhëro, Bekim!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka trajtuar Ligjin për ndërmarrjet sociale.

Është një ligj i avancuar, i cili është praktikë edhe në vende të tjera, si në Gjermani, Slloveni dhe vende të tjera të Bashkimit Evropian.

Mendoj që do të ketë nevojë që gjatë amendamentimit të plotësohet ky ligj. Janë disa vërejtje, të cilat me kohë do t'i paraqesim si amendamente gjatë trajtimit të këtij projektligji.

Por në tërësi Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Lista serbe, deputeti Slavko Simiq. Urdhëro, zot deputet!

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovane kolege narodni poslanici,

Parlamentarna grupa Srpske liste pažljivo je razmatrala Nacrt zakona o socijalnim preduzećima.

Dakle predlog Zakona obuhvata pravila koja eksplicitno definišu principe izgrađenih i uređenih socijalnih preduzeća njihove aktivnosti i uslove zapošljavanja kao delokrug Zakona koji se primenjuje na sva fizička i pravna lica koje učestvuju u aktivnostima socijalnih preduzeća urađenih ovim Zakonom.

S obzirom da će ovaj Zakon u budućnosti sprovoditi pravila za kontrolu i nadzor preduzeća koji će regulisati dobijanje ili gubljenja statusa uređenog socijalnog preduzeća.

Parlamentarna grupa Srpske liste u načelu podržava ovaj Nacrt zakona, i mi ćemo svoj doprinos dati kroz funkcionalnu Komisiju za rad i socijalnu staranje.

I pozivam sve poslanike da danas u načelu podržavaju ovaj Zakon. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Sipas radhës, fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Deputetja Time Kadrijaj, urdhëroni!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj, e thanë edhe parafolësit e mi që janë njëkohësisht edhe anëtarë të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që është trajtuar në lexim të parë, është amendamentuar nga Komisioni Parlamentar deri në fazën finale në leximin e dytë, po për shkak të ndërrimit të Qeverisë, ky projektligj prapë po kthehet në debat në Kuvendin e Kosovës.

Është një projektligj, i cili duhet të përkrahet, sepse çdo iniciativë që e zbut papunësinë e rëndë në Kosovë duhet përkrahur.

Problemet sociale si papunësia, përfshirja sociale dhe ofrimi i shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë mbetet një sfidë e madhe për vendet në zhvillim.

Për t'u bërë një projektligj i tillë, ashtu si e kemi debatuar edhe në Komisionin Parlamentar, por edhe në grupin parlamentar, ne duhet të marrim shembull vendet e rajonit.

Ne e dimë që nuk është ligji më i mirë dhe e dimë që ka vërejtje dhe sugjerime. Po ne si anëtarë të komisionit kemi mundësi që gjatë amendamentimit ta bëjmë një ligj të mirë, një ligj të implementueshëm.

Ne si grup parlamentar i japim përkrahje dhe të gjitha ato vërejtjet dhe sugjerime që i kemi gjatë amendamentimit në grupet punuese do të japim kontributin që ky projektligj të jetë i mirë dhe i zbatueshëm.

Andaj, ne do votojmë dhe i ftojmë të gjithë deputetët e tjerë në përkrahje të këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar "Nisma", deputeti Enver Hoti, urdhëroni!

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar "Nisma për Kosovën" e ka trajtuar Projektligjin për ndërmarrjet sociale.

Po ashtu dua të falënderoj ministrin që ka qenë shumë azhur në procedimin e këtij projektligji, që është shumë i rëndësishëm për vendin, për familjen, për njerëzit të cilët janë kategori e kufizuar për t'u përfshirë në jetën e përditshme dhe mendoj që duhet të punojmë akoma në mes të këtyre dy leximeve.

"Nisma" do të japë kontributin e vet nëpërmjet Komisionit për Punë e Mirëqenie Sociale dhe sigurisht janë vërejtur disa nene, të cilat mendojmë se duhet t'i përmirësojmë, mirëpo këtë do ta aprovojmë nëpërmjet komisionit dhe leximit të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar "6+", Albert Kinolli. Urdhëro, Albert!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Grupi Parlamentar "6+" me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin për ndërmarrjet sociale dhe ne mendojmë që ky projektligj është mjaft i dobishëm, për shkak se rregullon fushën e ndërmarrjeve sociale si dhe përmirësimin e gjendjes sociale, rregullon statusin e ndërmarrjes sociale në fushëveprimin e tyre si dhe ndikon pozitivisht në rregullimin e pozitës sociale të grupeve të marginalizuara apo të cenueshme.

Ka nevojë që ky projektligj të amendamentohet, andaj ne si Grup Parlamentar “6+” do ta japim kontributin tonë gjatë punës në komision.

Ne e japim votën pro në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani do t’u jap fjalën deputetëve sipas radhës, së pari fjalën e ka kolegu, deputeti i nderuar, Adem Mikullovc. Urdhëro!

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit!

Unë kërkoj falje nëse fjala ime, propozimi im s’e ka bash vendin këtu, po nuk gjeta vend tjetër, pos ta them këtu.

Mendoj që kur folëm për pensionet edhe për këto ndihma sociale e këso gjëra, ku po shpërndahen të hollat këndej e andej, Kuvendi duhet ta miratojë edhe një ligj, Ligjin për pensionin shtetëror. Vendet e ndryshme e quajnë “pension artistik”, Shqipëria e quan “nderi i kombit”, mendoj që edhe ne do ta bëjmë këtë për njerëz eminentë të artit, të kulturës, shkencës dhe veprimtarive të tilla, ku njerëz eminentë që kanë lënë gjurmë në art, shkencë e kulturë duhet ta kenë një përkrahje pak më serioze. Kaq. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia jap fjalën deputetes Mirjeta Kalludra.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot në rend të dite kemi shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndërmarrjet sociale.

Mendoj se ky projektligj është mjaft i rëndësishëm, pasi që rregullon një fushë specifike, pra problemet sociale, si papunësinë, përfshirjen sociale dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë apo grupeve të cënueshme.

Ligji që kemi para vetes është shumë i rëndësishëm dhe nëpërmjet kësaj politike shpresojmë se do të ketë ndikim në zhvillimin e ekonomisë në krijimin e ndërmarrjeve sociale, të cilat adresojnë çështje sociale, duke përfshirë punësimin, ofrimin e shërbimeve dhe mundësi të mirë për krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe ofrimin e shërbimeve sociale për persona me nevojë apo grupeve të cënueshme.

Ka pasur edhe diskutime, komente të shumta edhe gjatë fazës së konsultimit të tij, të cilat duhet të trajtohen me një vëmendje të shtuar gjatë amendamentimit, siç janë: të qartësohen kriteret sa i përket themelimit të ndërmarrjeve sociale se kush mund të ketë një status të tillë.

Të qartësohet po ashtu statusi apo format ligjore të themelimit dhe organizimit të tyre, të rregullohen më qartë dispozitat të fitimit të statusit për ndërmarrjet sociale, ndryshimi dhe humbja e statusit. Pra, duhet të përcaktohet qartë se kush është organi kompetent që duhet të vlerësojë dokumentacionin dhe organi apo institucioni i njëjtë që bën vlerësimin e dokumentacionit duhet të shqyrtojë edhe kërkesën në rast të ndryshimit apo humbjes së statusit.

Në këtë rast, tek neni 11, paragrafi 3, “Dhënia e statusit të ndërmarrjes sociale bëhet me vendim të komisionit përkatës të ministrisë”.

Kurse tek neni 12, paragrafi 2, “Çdo refuzim i statusit të ndërmarrjes sociale bëhet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë brenda 90 ditëve nga paraqitja e kërkesës”.

Po ashtu, tek neni 13, paragrafi 2, “Humbja e statusit hyn në fuqi nëpërmjet vendimit të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë që zbatohet brenda 10 ditëve, duke shkaktuar fshirjen apo çregjistrimin e ndërmarrjes sociale nga regjistri i ndërmarrjeve sociale”.

Po ashtu, në këtë rast, duhet të qartësohet apo harmonizohet edhe neni 22, “Bashkimi dhe ndarja e ndërmarrjeve sociale”.

Paragrafi 2, “Bashkimi dhe ndarja e ndërmarrjeve sociale bëhet me vendim të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë”.

Pra, siç e shihni, në këtë rast duhet të harmonizohet dhe duhet pasur kujdes se përgjegjësi e kujt mbetet.

Po ashtu, çështje tjetër me rëndësi që ka nevojë të qartësohet është edhe çështja e kontrollit apo monitorimit të ndërmarrjeve sociale.

Një çështje po ashtu me rëndësi që duhet qartësohet është edhe ndalimi dhe kufizimet në këtë rast, me ligj duhet të përcaktohen me përbindje, lartësia e kompensimeve, pagat dhe mëditjet të drejtuesve dhe stafit menaxherial të ndërmarrjeve sociale, e jo të rregullohet me akte nënligjore, pasi që shpeshherë po kemi keqpërdorime në këto raste.

Unë vlerësoj se me këtë ligj duhet të rregullohet edhe çështja e ankesave apo e drejta për ankesë. Pra, çdo palë e pakënaqur me vendimin e autoritetit kompetent duhet të parashihet një autoritet brenda institucionit, si shkallë e dytë, për shqyrtimin e ankesave lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me njohjen apo mosnjohjen e statusit si dhe në shqiptimin e gjobave ndaj tyre. E drejta e ankesës duhet të garantohet edhe për këtë kategori.

Duke u bazuar në rëndësinë dhe nevojën për një ligj të tillë që trajton pra problemet sociale, si papunësinë, përfshirjen sociale dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme në favor të shoqërisë apo grupeve të cënueshme, konsideroj se në mes të dy leximeve, edhe Komisioni Funkcional do të organizojë dëgjime publike.

Mendoj që ky projektligj meriton që të shqyrtohet me kujdes, të përpunohet mirë, në mënyrë që të mos kemi probleme të mëvonshme apo gjatë zbatimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Mexhide Mjaku-Topalli. Urdhëroni!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Ekonomia sociale dhe në veçanti ndërmarrjet sociale kanë marrë një rëndësi të madhe në Evropë gjatë dy dekadave të fundit.

Ekonomia sociale ka lindur dhe po zhvillohet brenda ekonomisë së tregut, me qëllim që t'u vijë në ndihmë nevojave sociale të individit dhe shoqërisë.

Ndërmarrje sociale janë instrumente të promovimit të ekonomisë sociale.

Ajo themelohet për të përmbushur objektiva sociale që lidhen me integrimin në punë të personave të disavantazuar, ose me ofrimin e të mirave dhe shërbimeve në dobi të shoqërisë.

Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale është konsideruar si element i rëndësishëm edhe në kuadër të nismave të Bashkimit Evropian, që lidhen me vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE.

Kështu BE-ja ka miratuar strategjinë për Evropën Juglindore të vitit 2020, si pjesë e strategjisë "Evropa 2020", siç është paraqitur edhe në memorandumun shpjegues të projektligjit, për të cilin po diskutojmë sot.

Angazhimi i ndërmarrjeve sociale në Kosovë konsiderohet si përgjigje ndaj shqetësimeve për papunësinë, përjashtimin social, procesin e decentralizimit, aftësinë për të dhënë në mënyrë efektive shërbime sociale.

Aktualisht Kosova vuan nga papunësia e lartë, për pasojë nxitja e sipërmarrjes private konsiderohet si domosdoshmëri për rritjen e punësimit dhe mirëqenies sociale në vend.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë një realitet zhvillimi në Kosovë, ato ushtrojnë aktivitet në fusha të ndryshme, megjithatë ato përballen me disa pengesa të ndryshme të zhvillimit të biznesit. Pengesat janë të ndara me aftësi të barrierave kulturore, infrastrukturore, operacionale, rregullatore dhe të brendshme.

Mungesa e aftësive menaxheriale burokracia, mungesa e besimit, mungesa e kapitalit për bizneset e reja, si dhe të ekonomisë informale, janë pengesat kryesore për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në Kosovë çështjet që lidhen me përfshirjen sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale në dobi të shoqërisë lidhen kryesisht me veprimtarinë e organizatave joqeveritare.

Shembull do të kemi organizatën joqeveritare “Rrjeti i grave të Kosovës”, e cila është përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike për punësimin e grave apo organizatat që mbështesin sektorin social.

Një tjetër shembull vjen nga organizata “Hendikos”, e cila i ofron shërbime dhe punësim për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe, në veçanti, ofron shërbime sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ndërmarrje sociale duhen dalluar pikërisht nga integrimi në punë i kategorive që kanë vështirësi në tregun e punës. Ato duhet krijojnë kushte për pjesëmarrjen e përfituesve të shërbimeve dhe të mirave të ofruara prej saj dhe vullnetarëve në drejtimin e punës së ndërmarrjes, çka përbën një tjetër dallim me midis këtij entiteti dhe formave klasike të organizimit që ekzistojnë sot në Kosovë dhe në vendet e tjera evropiane.

Ky ligj, përveç se përfshin punësimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe të mirave në interes të shoqërisë, gjithashtu nxit ide inovative të sipërmarrjeve në Kosovë, si një kontribut për zhvillimin e ekonomisë së tregut në Kosovë dhe qasjen e saj konform trendëve më të fundit evropianë dhe rajonalë.

Me miratimin e këtij ligji Kosova do të rriste mjetet dhe mundësitë për individët dhe autoritetet për të adresuar dhe ulur efektet negative të problemeve sociale në Kosovë.

Ky projektligj do të ndihmojë që në Kosovë të realizohen njëkohësisht të dy aspektet sociale, si punësimi, ashtu edhe ofrimi i shërbimeve dhe të mirave për komunitetin.

Integrimi njerëzor dhe rritja e cilësisë së jetës dhe shërbimeve në dobi të shoqërisë do të mundësohet nga krijimi i ndërmarrjeve sociale.

Nxitja e punësimit dhe përfshirja në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi do të mundësohet me miratimin në parim të këtij projektligji, në mënyrë që kjo kategori e shoqërisë të integrohet sa më mirë në shoqëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli. Urdhëro, Faton!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Lidhur me këtë ligj kemi diskutuar edhe në legjislaturën e kaluar dhe sinqerisht kam besuar që para se ta sjellë Qeveria ligjin, do t'i bënte së paku ato ndryshime të cilat janë propozuar nga një varg deputetësh në legjislaturën e kaluar, sepse ky do të ishte një hap para. Mjerisht, kjo nuk ka ndodhur, prandaj edhe ne mund t'i lexojmë fjalimet që i kemi pasur në legjislaturën e kaluar, sepse nuk ka ndonjë ndryshim apo ndonjë përmirësim të ligjit nga qeverisja e kaluar në këtë projektligj, ka pasur mundësi të bëhen ndryshime, por nuk janë bërë.

Ajo që dua të them është që ky ligj edhe pse për nga emri duke i bukur dhe duket shumë premtues, në fakt, rregullon shumë pak gjëra.

Në brendësinë e tij, ndoshta pse është kopjuar nga ndonjë praktikë evropiane, përmban vetëm konturat e idesë për ndërmarrjet sociale, por nuk ofron mundësi reale kështu siç është projektligji tani për implementimin e idesë.

Unë e di që në vendet e ndryshme evropiane ka traditë sa u përket ndërmarrjeve sociale, ka pasur traditë njëqindvjeçare, pesëdhjetëvjeçare, gjashtëdhjetëvjeçare të organizatave të ndryshme, të cilat nuk kanë përfituar nga buxheti i shtetit, pra nga paraja publike, por kanë shumë eksperiencë, prandaj dhe i është besuar një pjesë e buxhetit për këto raste.

Tani kur po flasim këtu, po i dëgjoj edhe disa diskutime të deputetëve sikur ne po diskutojmë për një ligj, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë tek ata që janë pa punë, tek pjesa e marginalizuar e shoqërisë, e kështu me radhë.

Në fakt, ne po flasim për biznese sociale. Jemi duke diskutuar se si do të rregullohen këto biznese sociale, të cilat nuk do të jenë fitimprurëse.

Duhet theksua gjithashtu që mjetet të cilat do t'i përdorin këto ndërmarrje sociale, do të jenë kryesisht mjete nga buxheti i Kosovës.

Prandaj, po mendoj që është shumë e rëndësishme të kemi shumë kujdes, sidomos gjatë amendamentimit, se çfarë po bëjmë me këtë ligj.

Problemin kryesor që e shoh unë te projektligji, i cili na është prezantuar tani përsëri, është që shërbimet publike, të cilat deri tani i ka kryer komuna, respektivisht qendrat sociale apo ministria, në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër po privatizohen, respektivisht po delegohen te ndërmarrjet sociale. Pra, edhe ky është një farë lloj privatizimi, sepse detyrat që i kanë kryer personat, respektivisht punonjësit të cilët kanë qenë të kualifikuar për këto çështje, nuk do t'i kryejnë më, sepse ato detyra do të delegohen te ndërmarrjet sociale. Unë po përmend këto të kategorisë A, siç janë: asistenca sociale dhe mbështetja për strehim, ndihma familjarëve, kujdesi familjar, e kështu me radhë. Një varg shërbimesh, të cilat i kanë kryer qendrat sociale, nuk do t'i kryejnë më.

Pra, po flasim për një lloj privatizimi. i cili pastaj nuk jam shumë i sigurt që do të sjellë efektet e veta, ashtu siç është sjellë kështu në projektligj.

Bile në qoftë se dua të jem kështu pak më kritik, nëse ky ligj mbetet i tillë çfarë është prezantuar sot këtu para nesh, atëherë ky paraqet një bazë solide për kriminalitet ekonomik, mashtrim dhe keqpërdorim të parasë publike.

Nuk e di a është qëllimi i Qeverisë, nuk besoj që është ky qëllimi, por kështu siç është ligji, po u miratua kështu, lë jashtëzakonisht shumë mundësi që paraja publike të keqpërdoret.

Prandaj, mendoj që duhet punuar me sinqeritet dhe angazhim të madh që ky ligj pastaj t'i sjellë vërtet efektet që dëshiron t'i sjellë Qeveria.

Është një komponent, nuk po dua t'i përsëris ato që i tha zonja Baftiu, por po përmend nenin 11, te fitimi i statusit të ndërmarrjes sociale.

Ministria shqyrton se a janë plotësuar kushtet sipas ligjit, kjo është në rregull. Shqyrton gjithashtu planin e biznesit, edhe kjo është në rregull. Por, as në ligj nuk thuhet askund se cilat janë kriteret profesionale, cilat ndërmarrje sociale duhet t'i plotësojnë për të punuar me klientë, të cilat kanë probleme sociale. Pra, ato detyra që i kanë kryer punëtorët socialë, psikologë, pedagogët socialë, kjo çështje nuk është e rregulluar me ligj, nuk ka asnjë pikë ku thotë se për punë të caktuara duhet të ketë kriteret profesionale, të cilat janë të rëndësishme për fushën sociale.

Tek neni 29, desha t'i përmend edhe sanksionet e parapara.

Në nenin 29, pika 2, thuhet që “nga 1 000 deri në 2 000 euro do të ketë sanksione”. Po çfarë do të ndodhë me një ndërmarrje sociale, e cila i ka marrë nga buxheti i Kosovës 200 mijë euro, një milion euro dhe pastaj do të dënohen me 1 000 deri në 2 000 euro. Pra, duhet krijuar mekanizma, të cilat sigurojnë që paraja publike të mos keqpërdoret.

Tjetra, dhe kjo është e fundit, ne kemi në Kosovë një varg organizatash, shoqatash profesionale, të cilat kanë përvojë, kanë kryer shërbime të ndryshme. Prandaj dhe mendoj që me ligj do të duhej të sanksionohej kjo çështje që këto organizata profesionale, të cilat deri më tani kanë afruar shërbime që kanë përvojë, që kanë gjithashtu edhe personel të caktuar profesional, të kenë përparësi në marrjen e mjeteve nga buxheti i Kosovës.

Pra, edhe unë jam për atë që ne ta miratojmë këtë ligj në parim, por duhet të them që ligji nuk është punuar mirë, që ka shumë nevojë të punohet, që ka shumë nevojë të krijohen mekanizma shesë, të cilat pastaj sigurojnë që punët të cilat do t'i marrin këto ndërmarrje sociale nga Qeveria apo pjesërisht nga buxheti i Kosovës të na sigurojnë edhe kualitetin, të cilën ne e presim për t'u shërbyer pikërisht atyre për të cilët edhe po bëhet ky ligj, që të përfitojnë nga puna e ndërmarrjeve sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Për këtë pikë të rendit të ditës janë paraqitur edhe tre deputetë, që të tre janë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Së pari, i jap fjalën deputetes Lirije Kajtazi. Urdhëro, Lirije!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ne besoj të gjithë deputetët, edhe vetë Komisioni Funkcional prezantoi se është një ligj i mirëpritur, i cili specifikon në mënyrë të caktuara çështjet që duhet të mbulohen dhe japin një premisë të mirë të punësimit dhe zbutjes së problemeve, e sidomos të kategorive në nevojë.

Ajo që na bënë të jemi të rezervuar në funksionalitetin e këtij ligji, është çështja apo opinioni i ndikimit buxhetor apo financiar.

Pavarësisht se është specifikuar kategoria ekonomike prej ku do të merren, tek pjesa e “Subvencioneve dhe transferove”, mendoj se shuma e caktuar prej 300 mijë eurove nuk do t'i japë peshë apo funksionalitet këtij ligji. Megjithatë, ndoshta sikurse edhe shumë ligje të tjera, ne mund të startojmë në një formë të tillë, po nëse vazhdojmë t'i varim shpresat, t'i mbështesim shpresat të donacionet, sikur po degjenerojmë edhe brenda ligjeve dhe brenda sjelljes tonë.

Prandaj, mendoj se duhet të jetë një shumë më solide, e cila jep jetë këtij ligji dhe shumë çështjeve të tjera që mbështesin kategori të veçanta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë ndërkohë e ka kërkuar fjalën deputeti Glauk Konjufca, që të krijoj një balancë, unë po ia jap fjalën së pari atij, e pastaj vazhdojmë me deputetët sipas radhës. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Është mirë që këtu tash është standardizuar kjo forma që bashkë me projektligjet që vijnë në Kuvend, të jetë edhe kjo shtojca e organizatave, të cilat janë konsultuar lidhur me përpilimin e projektligjeve.

Edhe këtu i kemi të gjitha komentet në fund po ashtu nga organizatat të ndryshme të cilët kanë dhënë mendime të vlefshme sa i përket draftimit të ligjit.

Por ajo çka më bën përshtypje është që këtu në Kosovë, sidomos kategoria e personave të cënueshëm, të cilët këtu te ne janë kategori e ndjeshme dhe quhen me emrin “persona me aftësi të kufizuara”.

Deri tash ne nuk kemi arritur ta standardizojmë një koncept të tillë se si përdoret, e kam fjalën edhe për ministrin që duhet ta ketë parasysh, është një koncept i cili nuk është standardizuar as në korpusin tonë legjislativ, as në mënyrën se si përdoret nëpër konferenca, ku shkruhen raporte të ndryshme për këtë kategori. Ka diferenca dhe mënyra të ndryshme se si u qaset atyre, me çfarë terminologjie, e kam fjalën.

Pra, këtu te komentet e keni vazhdimisht përdorimin e shprehjes “persona me nevoja të veçanta”.

Kurse ligji gjatë gjithë kohës u referohet si “persona me aftësi të kufizuara”.

Unë do të kisha propozuar që ndoshta të standardizohet në Republikën e Kosovës edhe në legjisllacion termi “persona me nevoja të veçanta”. Do të ishte shumë më mirë për arsye se shumë organizata të cilat merren me kategorinë e këtyre personave e shpjegojnë që termi “persona me aftësi të kufizuara” është në një farë mënyre jo veç i papërshtatshëm, por deri diku edhe paragjykes.

Kështu që do t’i bëja thirrje edhe ministrit dhe të gjitha institucioneve që shkruajnë dhe draftojnë ligje, por edhe bëjnë raporte, që në Republikën e Kosovës të standardizohet ky term dhe të përdoret njëjtë nga të gjithë, e më së miri do të ishte “persona me nevoja të veçanta”.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naser Rugova. Urdhëro, Naser!

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

Projektligji për ndërmarrjet sociale vjen për herë të dytë në shqyrtim, në lexim të parë, në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Është një draft, i cili kërkon punë dhe angazhim edhe të ekspertëve të lëmenjve interdisiplinare, jo vetëm të atyre që në fakt merren me aspekte sociale.

Është koncept i ri i rregullimit me ligj të kësaj fushe, që nënkupton përkujdesje sociale të grupeve të marginalizuara apo të cenuara.

Nëpërmjet këtij koncepti të ri ne duhet të gjejmë forma praktike ligjore dhe pastaj edhe akteve nënligjore t'i harmonizojmë, t'i konkretizojmë dhe t'i ndajmë detyrat, por edhe kompetencat ndërmjet ministrive të linjës, sepse është ligj që domosdo përfshin edhe dikastere të tjera, e jo në veçanti Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Duhet të bëhet zgjerimi i disa kompetencave të ndërmarrjeve sociale, por të konkretizohen këto kompetenca, të precizohen saktë me institucionet kompetente në të gjitha nivelet.

Unë e vlerësoj përqindjen prej 30% në kategorinë e ndërmarrjeve sociale të grupit A për përfshirjen e grupeve të cenuara, por sa i takon aftësimin të këtyre grupeve, po e citoj: Neni 5, paragrafi 2, pika 10 thotë: “Shërbimet e arsimimit dhe aftësimin profesional për personat me atësi të kufizuara”.

Konsideroj që kjo përgjegjësi, zoti ministër, i takon Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe këtu duhet, o të ketë një memorandum, o marrëveshje bashkëpunimi me MASHT-in, apo t'i lihet komplet në kompetencë MASHT-it dhe këto të rregullohen pastaj me akte nënligjore. Por, konsideroj që duhet të saktësohet konkretisht në këtë projektligj.

Ne duhet të hartojmë ligje që janë kompatible me rrethanat socio-ekonomike, socio-kulturore në Kosovë dhe me mundësi financiare dhe me projeksione buxhetore që ta zbatojnë këtë ligj në praktikë. Janë edhe disa aspekte konfuzë dhe duhet t'i precizojmë saktë në harmoni me legjislacionin tjetër bazik që ndërlidhet me këtë projektligj, te regjistrimi i këtyre ndërmarrjeve sociale, te statusi i tyre, te rregullimi tjetër i brendshëm, te korrelacioni i tyre me Administratën Tatimore të Kosovës dhe një konkretizim në monitorimin e këtyre ndërmarrjeve sociale. Krejt në fund, është ligj i nevojshëm, ka qenë e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me ligj në Kosovë dhe, tek e fundit, ndërgjegjja e në shteti dhe një shoqërie është dhe matet me përkujdesjen e atyre institucioneve dhe asaj shoqërie me grupet e cenuara apo të marginalizuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, përgatitet deputeti Arben Gashi, është i fundit i paraqitur për këtë pikë të rendit të ditës.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!
Të nderuara deputete dhe ju deputetë,

Kam analizuar ngjashmërinë e ligjit dhe dallimet e Ligjit për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë dhe atë në Republikën e Kosovës. Gjatë krahasimit të tyre konsiderojmë dy çështje shumë me rëndësi të përfshira në Ligjin për ndërmarrjet sociale në Shqipëri, duhet të jetë pjesë e përmbajtjes së Ligjit për ndërmarrje në Kosovë që të avancojmë barazinë gjinore në tregun e punës.

Te neni 2, Ligji për ndërmarrje sociale në Republikën e Shqipërisë, te pjesa Qëllimi, përkatësisht paragrafi 3, thuhet: “Ky ligj ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vullnetare, nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve në forma të larmishme dhe me cilësi të mirë, duke siguruar mundësi të përshtatshme dhe të arritshme për individë me nevoja të veçanta, si dhe duke e shënuar një hap thelbësor drejt barazisë gjinore. Për këto shërbime lehtësojmë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës”.

Ndërsa, në tekstin për ndërmarrjet sociale në Kosovë, madje edhe një herë të vetme nuk përmendet barazia gjinore si qëllim i Ligjit për ndërmarrjet sociale, pasi që kjo e konkretizon më shumë qëllimin e ligjit dhe pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. meqë edhe të dhënat e Agjencisë së Kosovës dukshëm tregojnë se papunësia e grave është shumë më e madhe se sa e burrave.

Së dyti, vërejtje tjetër për këtë ligj është që nuk përmendet të paktën diku në tekst se ndërmarrjet sociale, para së gjithash, janë organizata jofitimprurëse, sikur në nenin 12 të përcaktimit të statusit të ndërmarrjeve sociale në Shqipëri dhe kuptohet pas përfitimit të statusit të ndërmarrjeve sociale mund të bëhet i detyrueshëm përdorimi i emërtimit ‘ndërmarrje sociale’, e themi këtë sepse jemi paksa pesimist edhe rreth mundësive për keqpërdorimin e këtij emërtimi. Ndërmarrje sociale edhe nga bizneset tërësisht komerciale dhe që godasin konkurrencën e lirë në treg.

Edhe unë mendoj si të gjithë kolegët e mi që ky ligj duhet të miratohet, mirëpo në fokus të ketë edhe punësimin e gruas në veçanti. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Arben Gashi. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mendoj se ky është një prej ligjeve më të rëndësishme që trajtohen në Kuvend, po më çudit fakti i mungesës së interesit për të diskutuar për këtë ligj, sidomos partitë apo subjektet politike të karakterit të majtë, sepse perkufizimi i këtij ligji, ose përshkrimi i këtij ligji si një ligj i cili do të merret me personat me aftësi të kufizuara është mungesë e njohurisë esenciale për këtë ligj.

Ky ligj është instrumenti mbi bazën e të cilit një kategori e rëndësishme e shoqërisë sonë, që janë kategoria e personave me të ardhura më të ulëta, mund ta shfrytëzojnë në mënyrë të jashtëzakonshme për ta bërë balancimin social. Çka nënkupton kjo? Supozojmë kategoria e të

rinjve, të cilët jetojnë në komunën e Prishtinës, familje të reja, të cilat kanë të ardhura, supozojmë një mijë euro në muaj dhe dikush prej shokëve tyre ka një pronë, një tokë dhe këtë tokë nëse mblidhen dhjetë shokë a shoqe dhe e bëjnë një ndërmarrje sociale, e regjistrojnë ndërmarrjen sociale, mund të kërkojnë lejen e ndërtimit, ta bëjnë kontratën e ndërtimit dhe shitblerjes, duke shfrytëzuar ndërmarrjet sociale, sepse qëllimi i kësaj ndërmarrje nuk është fitimi, është zgjidhja e çështjes sociale të banimit dhe në këtë rast, krijohet mundësia që këta persona kontraktuesin për projektin, kontraktuesin për realizimin e projektit ta marrin, sepse thotë ndërmarrja sociale ka tatimin në vlerë të shtuar 0. Të paktën, në start 15% më lirë çështjen e banimit, plus tatimin në fitim është zero dhe çështjet e tjera zinxhirore dhe zgjidh shumë probleme.

Po ashtu, dhe ndërmarrjet, të cilat kanë aktivitet ekonomik, ndërmarrjet e reja të cilat mund të regjistrohen nëse këto ndërmarrje nuk kanë qëllim profitin. Në momentin që nuk e kanë për qëllim profitin, janë ndërmarrje të cilat gjenerojnë më shumë të ardhura, janë më të konkurrueshme në treg, por nuk mund të shpërndajnë profit dhe profiti i tyre shpërndahet për interes publik. Një keqpërdorimi i kësaj klauzole, duke u bazuar në lirinë kushtetuese për lirinë e asocimit, është bërë me institucionet mikrofinanciare në Kosovë. Institucionet mikrofinanciare në Kosovë janë institucione, të cilat janë regjistruar si organizata jofitimprurëse, të cilat e kanë për qëllim interesin publik dhe këto institucione duke keqpërdorur këtë hapësirë kanë dhënë dhe japin ende sot kredi me norma interesi mbi 20%, sepse nuk është e rregulluar me ligj dhe e keqpërdorin hapësirën e cila ekziston si ndërmarrje sociale, duke mos paguar as taksa dhe tatime, sepse nuk e kanë për qëllim profitin.

Pra, në këto rrethana, mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe po më çudit fakti pse nuk po trajtohet me seriozitetin e duhur, pse nuk po i bëhet publiciteti i duhur dhe si subjekte politike të karakterit të majtë e trajtojnë këtë çështje kaq lehtësisht dhe kaq të parëndësishme. Unë mendoj se avantazhi kryesor i partive të majta, por edhe i kategorive sociale me të ardhura më të ulëta do të jetë ky projektligj, i cili do të japë mundësi që të regjistrohen si ndërmarrje që nuk kanë për qëllim profitin dhe nëpërmjet mungesës së qëllimit të profitit nuk paguajnë taksa dhe tatime dhe zgjidhin probleme sociale, të cilat janë shumë të theksuara në shoqërinë tonë.

Pra, unë e përkrah këtë ligj, edhe pse jemi parti e qendrës së djathtë, mendoj se shoqëria jonë ka çështje të karakterin social që duhet t'i trajtojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Faton Topalli, por unë s'kam drejtë t'i jap fjalën, sepse ka folur një herë dhe nuk është apostrofuar në asnjë rast.

Unë pyes përfaqësuesin e Qeverisë nëse do ta marrë fjalën. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj të gjithëve për vërejtjet, sugjerimet, komentet. Jam plotësisht i vetëdijshëm që sugjerimet tuaja, komentet tuaja, të cilat unë i dëgjova me shumë vëmendje, janë të qëlluara dhe besoj që ky ligj, meqë do t'i nënshtrohet edhe leximit të dytë, do ta ketë një mundësi të pasurohet me komentet dhe sugjerimet tuaja. Natyrisht, nuk dua të përgjigjem në secilin koment dhe sugjerim, por dëshiroj t'i veçoj disa nga ato.

Në shumë fusha është menduar që ky ligj, pas miratimit, të pasurohet edhe me akte nënligjore që do ta rregullojnë fusha të caktuara, kemi rastin atje te statusi, te kontrolli, te bashkëpunimi ndërsektorial, u përmend aty fusha e trajnimit, edukimit është menduar që me akte nënligjore dhe me dokumente të tjera që do të bëhen në kuadër të bashkëpunimit ndërministror të rregullohen fusha të caktuara. Unë edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj dhe shpreh gatishmërinë time që përgjatë leximit të dytë, nëse kërkohet, të jap kontributin si ministri dhe si ekip punues i këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faton, e keni fjalën, dy minuta!

FATON TOPALLI: Faleminderit! Po mendoj që Arbeni u nis nga një qasje e gabueshme, sepse politikë e djathtë është kjo kur shërbimet, të cilat i kryen komuna, i kanë kryer qendrat sociale, ua ktheni tregut të lirë. Pra, ju që neve na akuzoni shpesh që nuk po e njohim shtetin e Kosovës, ju me këto politika, të cilat po i bëni edhe tani, edhe në këtë ligj, për çdo ditë, pak nga pak, e çdo ditë më shumë po e shpërbëni shtetin, po ia merrni të gjitha atributet shtetit, të gjitha kompetencat që ka shteti për t'i privatizuar dhe për t'ia kthyer ato tregut të lirë.

KRYESUESI: Po i jap kundër-replikë deputetit Gashi, po unë me sa kuptova të gjitha grupet parlamentare e përkrahën këtë projektligj. Një minutë, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit! Këto janë dy dallime substanciale, e para ne jemi në opozitë dhe nuk jemi propozues të ligjit dhe, e dyta, teoria që ju po e propozoni këtu është teoria e komunizmit absolut, ku shteti është pronar i të gjithave. Këto janë çështje që ne s'i përkrahim dhe nuk besojmë në to. Ky ligj për ndërmarrjet sociale mendoj që është në interes të shoqërisë dhe zgjidh problemet të karakterit social, sepse është elementi kryesor i cili e nxjerr në disavantazh ekonominë e tregut të lirë, sepse këtu nuk ka qëllim profiti dhe duke mos pasur qëllim profiti përderisa kjo organizatë prodhon dhe nuk ka profit, përfiton shoqëria, është interesi social.

Domethënë në ekonominë e tregut të lirë po fusim konkurrencë të organizatave, të cilat nuk kanë qëllim profitin, ndërsa ju po doni që shteti të kontrollojë gjithçka. E kemi parë si pjesa e shtetit e menaxhuar nga ju çka kontrollon dhe çka jep si rezultat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ka deputet që nuk ka kartelë? Ismet për, domethënë. Atëherë, kanë votuar 65, plus Ismeti, 66 vota. 64 vota janë për, 1 abstenim. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndërmarrjet sociale.

Faleminderit! Pas kësaj ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016

Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me nenin 72 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Neni 29 i Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit në lidhje me raportimin e Avokatit të Popullit parasheh: Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor. Mbi këtë bazë unë e ftoj Avokatin e Popullin, zotin Ilmi Jashari, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016. Zoti Jashari, e keni fjalën!

AVOKATI I POPULLIT, HILMI JASHARI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Raporti vjetor për vitin 2016 i Institucionit të Avokatit të Popullit përbën përshkrimin dhe vlerësimin e gjendjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2016. Në kuadër të mandatit dhe kompetencave të këtij institucioni janë nxjerrë mbi 173 rekomandime drejtuar institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës që përbën një ngritje prej 203% në krahasim me vitin paraprak dhe, me fjalë të tjera, i bie që për çdo të dytën ditë e kemi pasur nga një rekomandim adresuar institucioneve publike të Kosovës.

Në anën tjetër, gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur një ngritje prej 100% në rastet e hetimeve 'ex officio' po sipas vetiniciativës adresuar çështjeve që kanë të bëjnë me shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në Kosovë. Gjithashtu, kemi pasur ngritje të numrit të rasteve të pranuar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, mirëpo kryesisht ato që kanë të bëjnë me shkeljet sistematike, në të cilat përfshihen një numër i madh i qytetarëve të vendit, të drejtat e të cilëve janë shkelur. Vlen të përmendet gjithashtu se gjatë vitit 2016 është bërë një hulumtim nga një mekanizëm i Bashkimit Evropian, i cili ka bërë vlerësimin e institucioneve të pavarura në regjionin e Ballkanit dhe Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës është vlerësuar si institucioni më i besueshëm në Ballkan mbi bazën e tri parametrave, indikatorëve. Një prej tyre ka qenë besueshmëria e qytetarëve në këtë institucion, kriteri i dytë ka qenë shkathësia ose aftësia për të mbikëqyrur Qeverinë dhe kriteri i tretë ka qenë ushtrimi i pavarur i mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Unë në këto pak minuta në vijim do t'u referohem çështjeve më problematike, të cilat ne i kemi hulumtuar dhe të cilat janë të përshkruara në raportin vjetor dhe të cilat janë kategorizuar në tri grupe, varësisht prej shtyllave të pushtetit, të cilat janë vlerësuar.

Në sistemin ligjor vazhdojmë të kemi problemin e numrit të madh të ligjeve, të cilat procedohen nga Qeveria në këtë Kuvend dhe është befasuese fakti se mbi 50% e draftligjeve që sillen në Kuvend janë ligje të cilat vijnë me plotësimin dhe ndryshimin nga viti paraprak. Kjo e ngarkon sigurisht Kuvendin e Kosovës dhe gjithashtu domethënë kualitetin e ligjeve, të cilat përgatiten nga ana e Qeverisë. Një vërejtje tjetër që gjithashtu është paraqitur për Qeverinë ka të bëjë me afatin e miratimit të draftligjeve, sepse periudha e miratimit të këtyre ligjeve kap një afat prej 12 muajsh, brenda afatit vjetor zakonisht këto përcillen, derisa praktikat më të mira të shteteve të tjera kanë një afat 18 deri në 36 muaj, të cilat shfrytëzohen për hartimin sa më kualitativ të ligjeve, në mënyrë që të mos ketë një proces të tillë çfarë afekton Kuvendin e Kosovës dhe ku sillen zakonisht ligje me plotësime dhe ndryshime, e në anën tjetër, kjo merr kohë të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për të ushtruar kontrollin parlamentar mbi mekanizmat qeveritarë.

Një problem të dytë, të cilin e kemi identifikuar në raportin tonë vjetor, vazhdon të paraqesë situatën e kolizionit të ligjeve. Një pjesë e madhe e këtyre ligjeve janë në kolizion të drejtpërdrejtë dhe në disharmoni me njëri-tjetrin, kështu që zbatimi i tyre praktik nga ana e gjyqësorit apo administratës publike e bën të pamundur, kjo pastaj nxit pasigurinë juridike të vetë institucioneve që do të duhej ta zbatojnë, mirëpo në anën tjetër, shkakton zbatim selektiv në të drejtat dhe liritë e qytetarëve të vendit.

Një problem tjetër që gjithashtu e afekton sistemin ligjor ka të bëjë me mosharmonizimin e legjislacionit, të cilin ne e kemi rekomanduar edhe në vitin paraprak, e i cili i referohet Kuvendit të Kosovës për të krijuar një zyrë ose të fuqizojë zyrën ligjore, e cila do të ishte në gjendje të

harmonizonte deri më tani të gjitha ligjet që janë miratuar në Kuvend, në mënyrë që zbatimi të jetë edhe më adekuat, edhe më i drejtë për qytetarët e vendit.

Në anën tjetër, gjithashtu mungon një proces i kodifikimit, që është një proces i zakonshëm në të gjitha vendet e tjera, ku legjislacioni i një fushe përkatëse përmbledhet dhe ajo u servohet praktikuesve të ligjit, mirëpo në anën tjetër, gjithashtu ndihmon që qytetarët e vendit të jenë në dijeni lidhur me të drejtat, obligimet, sepse pjesa më e madhe e legjislacionit, sidomos atij sekondar, nuk publikohet në ueb faqet e mekanizmave përkatës.

Sa i përket sistemit gjyqësor, vazhdojmë të kemi probleme të mëdha në zvarritjet e procedurave gjyqësore dhe në tani kohët e fundit, në disa prej raporteve që i kemi nxjerrë, në 11 raporte afati mesatar për vendosjen nga ana e gjyqësorit kap 8.5 vjet në rastet të cilat qytetarët i kanë ngritur para këtij sistemi. Gjithashtu janë bërë edhe vlerësime sa i përket mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe mbetet gjithashtu shqetësues fakti që gjatë vitit 2016 janë mbi 60 mijë aktgjykime, të cilat kanë mbetur të pazbatuara pse të paekzekutuara. Përveç faktit shqetësues të moszbatimit të aktgjykimeve gjyqësore të formës së plotfuqishme, ato sjellin edhe një dëm ekonomik për vendin, e veçanërisht këto rastet të cilat i përmendën në raport janë vlerësuar që kapin shumën diku mbi 2 milionë euro për dëmet që u bëjnë në formën e drejtpërdrejtë qytetarëve të vendit.

Ndërsa sa i përket administratës publike ose ekzekutivit, vazhdojnë me mungesë të kontrollit gjyqësor ndaj administratës publike. Në hulumtime dhe raportimet që i kemi bërë si Institucion i Avokatit të Popullit, janë raporte të veçanta, është evidente që Departamenti për Konflikte Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, që është organi i vetëm i cili mbikëqyr dhe kontrollon administratën publike, asnjëherë pothuajse nuk ka qenë në gjendje të nxjerrë vendime mbi vendimet përmbajtjesore që ka nxjerrë administrata publike. Me fjalë të tjera, sistemi gjyqësor nuk është në gjendje për të kontrolluar dhe për ushtruar kontroll adekuat gjyqësor mbi vendimmarrjen që bëhet nga administrata publike.

Problemi i dytë madhor është fakti i moskoordinimit ndërinstitutional të organeve publike. Shpeshherë krijohen politika, nxjerrin vendime ose udhëzime, të cilat janë ose në kundërshtim me njëra-tjetrën ose duplikojnë angazhimet e organeve publike, të cilat pastaj krijojnë pasiguri për të drejtën e qytetarëve dhe, krejt e fundi sa i përket administratës publike, ende vazhdojmë të ketë mangësi, moskompensimin e viktimave të shkeljeve të drejtave të njeriut, me të cilin supozohet se do të mbyllet një cikël, në rastet kur ato shkelen nga organet publike. Nuk ka asnjë procedurë gjyqësore, asnjë mekanizëm ligjor, i cili u garanton qytetarëve të vendit mundësinë për t'u kompensuar në rast se të drejtat e tij janë shkelur nga organet publike.

Këto janë vërejtjet tona kryesore në sistemin edhe ligjdhënës, edhe gjyqësor, mirëpo edhe atë të administratës publike, për të cilat janë dhënë rekomandime konkrete. Në anën tjetër, vlen të përmenden disa prej rasteve, të cilat janë trajtuar dhe që kanë pasur ndikim të madh në vend.

Rastin e parë, të cilin kisha dashur ta ndaj me ju për pak minuta ka të bëjë me rastin Grudiq kundër Serbisë, në të cilën Avokati i Popullit ka nxjerrë një opinion, i cili i është dërguar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës si pasojë e dështimit të autoriteteve publike për të trajtuar këtë rast në Komitetin e Ministrave që është organ përmbarues i Gjykatës Evropiane të Strasburgut.

Vlen të përmendet gjithashtu fakti se ky rast kap shumë e vlerës monetare diku afro 2 miliardë euro dhe përgjatë tre vjetëve Serbia vazhdimisht ka përcjellë opinionin në Komitetin e Ministrave për të mos zbatuar këtë vendim të gjykatës, derisa institucionet publike të Kosovës nuk kanë adresuar asnjëherë, asnjë rast në këtë komitet si reagim për të detyruar Serbinë që të përmbushë këtë aktgjykim nxjerrë nga Gjykata Evropiane e Strasburgut.

Tanimë ky opinion është dërguar në Komitetin e Ministrave dhe është në proces, mirëpo pritet që ky rast ndërkohë të shqyrtohet së bashku me një rast tjetër. Është e interesit të veçantë, sepse ka pasur një dështim për një vlerë kaq të madhe, për një rast aq të rëndësishëm për një pjesë të madhe të qytetarëve të vendit, e që konsiderohet që numri të jetë afro 60 mijë veta. Mirëpo 60 mijë veta nuk është asgjë në krahasim me vlerën e kontestit që është 2 miliardë, e realisht nuk është bërë asnjë veprim në kuadrin e nxitjes së Serbisë, nëpërmjet Komitetit të Ministrave për të ekzekutuar këtë aktgjykim.

Rasti tjetër që e përmendëm ka të bëjë me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore që zakonisht merren në procedura kundërvajtëse dhe shifra e këtyre rasteve të paekzekutuara në sistemin tonë juridik është afro 60 mijë. Nëse marrim vlerën minimale të një kundërvajtje ose vepër e kundërvajtjes që është diku 35 euro, 35 euro në 60 mijë i bie diku afër 2 milionë euro që janë dëme të drejtpërdrejta për ekonominë e vendit, për shkak të paaftësisë së sistemit për të ekzekutuar këto aktgjykime gjyqësore.

Dhe, krejt në fund, po e përmend gjithashtu një kategori tjetër, për të cilën kemi reaguar dhe që zakonisht ky numër sillet diku rreth 50 mijë. Ka të bëjë me pensionistët e Kosovës, të cilët detyrohen nëpërmjet një udhëzimi administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që të paraqiten çdo gjashtë muaj para ministrisë për të dëshmuar që janë gjallë. Vlerësimi i Avokatit të Popullit ka qenë që ky kriter është shkelje e drejtpërdrejtë e dinjitetit të qytetarëve të vendit dhe si të tillë e kemi rekomanduar që të largohet, në mënyrë që këto pensione të sigurohen duke e mbrojtur edhe dinjitetin e qytetarëve.

Këto janë disa prej vërejtjeve kryesore që janë gjetur në raportin vjetor. Raporti si i tillë, së bashku me të gjitha raportet dhe rekomandimet, u janë përcjellë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe unë shpresoj shumë që t'u shërbejë si bazë e mirë për të ushtruar një kontroll më të fuqishëm ndaj mekanizmave qeveritarë. Përndryshe, mbetem në dispozicionin tuaj sa herë që

të keni nevojë për shpjegime shtesë sa i përket rolit dhe mandatit që ka Institucioni i Avokatit të Popullit. Ju faleminderit për vëmendje.
Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Jashari!

Tani është radha e deklarimeve dhe diskutimeve. Së pari ftoj që të marrë fjalën kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Duda Balje, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit përkatës. Urdhëro!

DUDA BALJE: Hvala!

Komisija za ljudska prava je dobila daleku širu verziju ovog raporta. Imali smo daleko više vremena da raspravljamo, dobili smo i raspravljali smo na sednici 15. novembra 2017. godine. Ispred naše komisije, Narodni advokat je dao široki opseg celokupnog raporta, i ulazili smo naravno u detalje. Ono što mogu da kažem u ime Komisije za ljudska prava, i u moje lične ime kao poslanica ove Skupštine, i kao predstavnik manjinske zajednice na ovu Skupštinu, i u ime komisije koja naravno glasalo jednoglasno za celokupni raport, i u moje ime kao poslanica, mogu da kažem da smo jako zadovoljni sa radom Narodnog advokata, i naravno sa čitavim raportom.

Raport je podeljen adekvatno na sve kategorije, na sve segmente, analize, zaključci i preporuke koji su došli od strane Narodnog advokatu u tom raportu daju jednu sliku o našoj pravnoj stanje na Kosovu, o našim zakonima, o načinima koji se zakoni koriste, o načinu koji se zakoni preklapaju, i gde se tačno mogu naći greške u samom implementiranju, što predstavlja najveći problem samog Kosova.

Ovaj raport predstavlja jednu novinu u odnosu na sve druge raporte koje manje više dobijamo ovde u Skupštini, koji predstavljaju ‘copy past’ svih raporta koji se ovaj dešavaju iz prethodnih godina, ovaj raport predstavlja jednu potpuno novinu, jer se bavi nekim novim stvarima koji su prvi put pokrenuti ovde kod nas. Bavi se široku zaštitom ljudski prava, naravno i ljudskim pravima stanovnika koji se nalazi u Šiputulu.

Imali smo pre par dana i raspravu i preporuka od strane Narodnog advokate i za trošenje električne energije na severu Kosovu, koje su u vrednosti od 8 miliona evro koje plaćemo mi stanovnici Kosova.

Naravno tu ima i raport o zaštiti dece sa preporukama šta bi trebala da se uradi da bi se takvu stanje poboljšalo, o zaštiti žena, o zaštiti invalida, zatim imamo vrlo decidivne preporuke o onima što se Narodni advokat bavio, Zakona o seksualnim i reproduktivnom zdravlju, koji je jako značajan i na koji smo mi u okviru same komisije, a i svi poslanici ovde dobili neke

smernica na koji se način treba funkcionisati i preporuke na osnovu koje trebamo da se baziramo da bi promenili stanje.

Ja ću govoriti naravno u ime Parlamentarnu grupa "6+", a Parlamentarna grupa "6+" će podržati ovaj zakon. Naravno Advokatu želimo sve najbolje, i naravno da nastavi da radi svoj poslu onako kako ga je radio do sada. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit. Urdhëro!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Raporti vjetor financiar i Avokatit të Popullit për vitin 2016 pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike.

Buxheti i ndarë për vitin 2016 për Institutin e Avokatit të Popullit ka qenë 980 mijë e 71 euro, kurse buxheti përfundimtar për të njëjtin vit pas ndryshimeve në rishikimin e buxhetit ka qenë në shumën prej 996 mijë e 389 eurosh. Buxheti është shpenzuar në vlerë prej 99,52% dhe sipas kategorive është si vijon: për paga dhe mëditje 100%, për mallra dhe shërbime 99,38%, për shpenzime komunale 88.13% dhe për investime kapitale 100%. Në bazë të të dhënave të prezantuara në raport shihet se ka realizim të mirë të buxhetit dhe nuk ka ndonjë tejkalim që vlen të theksohet në krahasim me planifikimin. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institutit të Avokatit të Popullit 2016 dhe ka vlerësuar se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Meqenëse jam këtu, po e jap mbështetjen edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pra për të njëjtat arsye të cekura më lart, Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare që përfaqësohen, tashmë morëm dy qëndrime të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të Grupit Parlamentar "6+", ia jap fjalën përfaqësuesit të Lëvizjes "Vetëvendosje", zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

I nderuar Avokat i Popullit dhe të nderuar ish-kolegë të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Unë që në fillim edhe në emrin tim personal, edhe në emër të grupit parlamentar, por tash po e them në emrin tim personal, desha ta falënderoj zotin kryeministër dhe ta theksoj këtë çështje, qasjen, kërkesën dhe përkushtimin e tij në lidhje me pjesëmarrjen e ministrave të Kabinetit në seancat e Kuvendit. Ajo çka e premtoi dhe e tha zoti kryeministër është për çdo lëvdatë, mirëpo e kam pak problem tash. Janë veç tre këtu, edhe kjo është relativisht shqetësuese për një arsye, edhe arsyeja është krejt e thjeshtë, ne kemi të vetmin dokument që trajton të drejtat e njeriut që cenohen e shkelen nga institucionet shtetërore në Republikën e Kosovës, dhe nëse i ndajmë në shifra sipas raportit të Avokatit të Popullit, diku rreth 50% të të gjitha shkeljeve i bën ekzekutivi, nja 35% Gjyqësori, por Gjyqësori nuk është pjesë e Qeverisë, prandaj ato rekomandime dërgohen atje.

Sidoqoftë, unë po i kthehem tash fjalës në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Legjislacioni dhe zbatueshmëria e tij: Avokati i Popullit në raport konstaton qysh në fillim zbatim të pamjaftueshëm të ligjeve në vend dhe ky mbetet një problem jashtëzakonisht i madh. Kontrolli parlamentar, konstaton Avokati i Popullit, është i pamjaftueshëm për shkak të mungesës së kapaciteteve, ngarkesës së madhe dhe hapësirës së pamjaftueshme për të ushtruar mandatin e zbatueshmërisë. Afatet e shkurtra për shqyrtim, numri i madh i ligjeve, mungesa e kapaciteteve të pamjaftueshme profesionale bëjnë po ashtu që ligjet e miratuara, por edhe ato të ndryshuara, të jenë të kualitetit të dobët. Kjo vlen për Kuvendin, kjo vërtet është një fatkeqësi e madhe.

Më e keqja është se suksesi i legjislativave dhe suksesi i qeverive në të shumtën e rasteve matet me numrin e ligjeve të miratuara dhe jo me kualitetin e tyre. Ende nuk është bërë asgjë në procesin e kodifikimit të ligjeve që rregullojnë fusha të njëjta apo të përafërta.

Gjyqësori: Megjithëse Avokati i Popullit ka kompetenca shumë të kufizuara në lëmin e gjyqësorit, përveç në rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore, kemi një varg informatash jashtëzakonisht interesante. Bazuar në përvojën e rasteve të paraqitura qytetarët vazhdojnë të kenë një mosbesim në sistemin gjyqësor për shkak të zvarritjeve të shumta në vendosjen e rasteve me vite të tëra, ashtu siç i përmendi edhe Avokati i Popullit, apo të moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme të gjyqësorit, vendimeve joefektive, parashkrimit të lëndëve gjyqësore, apo të gabimeve të shumta që, edhe më keq, për shkak apo edhe të mosobjektivitetit të gjyqtarëve në procedura dhe në vendimmarrje.

Kjo dukuri nuk është krejt e panjohur në përvojën e Kosovës. Në fund të vitit 2016 kanë ngelur të pazgjidhura nga gjyqësori mbi 417 mijë lëndë. Pritjet në zgjidhjen e lëndëve janë edhe më të gjata nëse llogariten sipas parimit që e cakton Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo domethënë prej momentit kur qytetari e dorëzon një padi në gjykatë dhe jo prej momentit kur

gjykata apo prokuroria fillon punën. Një plagë tepër e madhe është po ashtu parashkrimi i lëndëve. Parashkrimi i lëndëve domethënë heqje dore e shtetit nga vënia e drejtësisë dhe kalimi i drejtësisë në duart e individëve. Kjo është në gjuhën popullore, gjykatat nuk ofrojnë shifra për parashkrimin, sepse kjo do të bënte që performansa e punës në gjykata të dukej shumë më keq sesa shfaqet në të vërtetë. Megjithatë, Avokati i Popullit ka arritur të sigurojë shifra nga viti 2015, në të cilat thuhet se janë parashtruar 32 860 raste të ekzekutimit në procedurën gjyqësore, ndërsa mbi 26 000 raste në procedurën e ekzekutimit policor. Pra, gjithsej afro 60 mijë raste që nuk zbatohen, duke pasur vendime të plotfuqishme të gjykatave, domethënë nuk zbatohet urdhri i gjykatës.

Ky nuk do të ishte ndonjë problem i madh sikur të mos kihet parasysh se e njëjta polici, që është e obliguar t'i zbatojë vendimet e gjykatave, të jetë gatshme që në më pak se 24 orë t'i zbatojë vendimet e kundërligjshme të gjykatave kundrejt kundërshtarëve politikë, aktivistëve dhe deputetëve të Lëvizjes "Vetëvendosje", duke i burgosur ata në dyert e Parlamentit. Ky është problemi kryesor dhe ky duhet të theksohet.

Niveli i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore arrin vetëm 1/3-ën e të gjitha vendimeve të ekzekutuara. Po ashtu, edhe ofrimi i mjeteve efektive juridike, si dhe përfaqësimi ligjor i qytetarëve, nuk është në gjendje më të mirë. Jo vetëm gjykatat nuk e kryejnë punën e tyre sipas ligjit, por këtu kemi shpeshherë edhe raste e ankesa në punën, kualitetin dhe efikasitetin e punës së avokatëve mbrojtës.

Gjyqësori, në përgjithësi, vazhdon të mos sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare dhe sidomos sipas kërkesës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu siç e përcakton edhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Gjykatat rrallë, shumë rrallë, ose fare nuk i referohen praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu siç është obligim kushtetues, apo edhe kur bëhet kjo është në mënyrën më të pavlerë dhe të përgjithësuar.

Mungesa e qasjes në drejtësi në pjesën veriore të vendit, së paku për vitin 2016, mbetet ende një plagë e hapur, që përcillet me shkelje drastike të të drejtave të njeriut me gjithë mbështetjen që gjykatat, ose Gjyqësori i Kosovës e merr nga EULEX-i. E tëra kjo ngjan, sepse në Kosovë ende nuk ekziston një mekanizëm ligjor i brendshëm sipas kërkesës së nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që qytetarëve ua ofron të drejtën ligjore për mjete efektive ligjore në rastet e shkeljes së të drejtës për zgjidhjen e rasteve të tyre gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm ligjor. Deri atëherë kur një kryetar gjykate dënohet me dy vjet e gjysmë burg me kusht për keqpërdorimin e pozitës dhe përvetësim të paligjshëm të shumave marramendëse prej disa dhjetëra miliona eurosh, ndërsa varfanjaku për shitjen e një qerreje me dru, që nuk arrin vlerën 100 euro, dënohet me gjashtë muaj burg efektiv, kjo është një pasqyrë e drejtësisë së sotme në Kosovë.

Dalim te Ekzekutivi. Probleme të mëdha vazhdojnë të mbeten në shumicën e rasteve me lëndët që kanë të bëjnë me pronat, me AKP-në, domethënë Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me uzurpimin dhe riuzurpimin e pronave, me të drejtën për kompensim të drejtë të pronave të shpronësuara, me zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe administrative për lirim të pronave të uzurpuara dhe ndjekjen e uzurpatorëve. Kjo është, po ashtu, një sfidë e madhe, jashtëzakonisht e madhe dhe është pjesë po ashtu e punës së Policisë që duhet të zbatojë vendime qoftë administrative apo të gjykatave, vendime të plotfuqishme.

Shqetësim i madh sipas këtij raporti mbetet edhe cenimi i të drejtës së qytetarëve për ambient të sigurt dhe të shëndetshëm. Kualiteti i ujit, i ajrit, parcializimi i tokës bujqësore dhe shkatërrimi i pyjeve vazhdojnë pothuaj me të njëjtin intensitet sikur edhe më herët. Mosrespektimi i normave të ndërtimit nga niveli qendror dhe lokal, moskoordinimi i inspektorateve, mosinformimi i publikut dhe mospjesëmarrja në vendimmarrje për plane rregulluese, mungesa e sistemeve monitoruese, krejt këto janë veprime që nuk kryhen sipas obligimeve ligjore.

Taksa ekologjike e vendosur sipas ligjit përdoret për qëllime krejtësisht tjera. Degradimi i ambientit mbetet ndër çështjet më serioze në Kosovë, sepse nuk ka asnjë shenjë të ndërgjegjësimit institucional, e të mos flasim për solidaritet gjeneratash. Ne fëmijëve tanë po ua lëmë një ambient krejtësisht të helmuar. Ndotja e ujit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kur të të vijë radha. Një minutë e keni, vazhdoni!

SAMI KURTESHI: Kryesues!

Megjithatë, unë e kam bërë një analizë të krejt raportit dhe ne e kemi bërë atë dhe duam ta vëmë në spikamë. Unë mund edhe të shkoj në vend, nuk është problem, mirëpo unë e kam një problem shumë të madh. Shiheni praninë këtu në sallë, edhe të Qeverisë, edhe të deputetëve, për çështjen kryesore që e kemi ne si popull. Edhe kjo është shkelje e të drejtave të njeriut nga institucionet. Ju mund të ma ndërpritni kur të doni fjalën dhe unë shkoj në vend, por unë i kam edhe rekomandimet konkrete lidhur me këtë çështje.

KRYESUESI: Zoti deputet, edhe unë e kam brengë të rëndësishme që deputetët s'janë këtu në sallë. Për atë sot kërkova disa herë që të jenë dhe thashë që nëse s'ka kuorum, unë do ta ndërpres seancën, se ne duhet të mësohemi ta respektojmë Rregulloren. Ndërkaq, për fjalë ju si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje" i patët dhjetë minuta, kurse si deputet mund ta merrni sërish fjalën kur të ju vijë radha. Faleminderit!

SAMI KURTESHI: Mirë...

KRYESUESI: Fjalën e ka përfaqësuesja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, zonja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Tani kur po e shqyrtojmë raportin e një institucioni të pavarur kushtetues që ka të bëjë fund e krye me shëndetin e vetë Republikës së Kosovës, me vetë funksionimin institucional, natyrisht që secili kujdesshëm i ka parë gjithë këto çështje të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit i ka prezantuar në të gjitha sferat e jetës, prandaj do të ishte në interes të secilit që këto rekomandime të merren me seriozitet.

Siç e dimë, vitin e kaluar, ky Kuvend ka debatuar për mënyrën e trajtimit të raportit të Avokatit të Popullit dhe i kemi nxjerrë rekomandime të cilat flasin për këtë formë të trajtimit të raportit. Nga kjo çështje ne i kemi nxjerrë disa pika që u japin detyra të gjitha ministrive, që të gjitha rekomandimet t'i marrin seriozisht dhe t'i kenë afatet e caktuara për t'i zbatuar ato. Mbi të gjitha, kjo flet për kontrollin, rritjen e efikasitetit të kontrollit parlamentar mbi Qeverinë dhe të gjitha institucionet që mbikëqyr ai, për kualitetin e ligjeve që i pamë, që në fjalën e parë i tha edhe vetë Avokati, nga vetë shifrat. 50%-shi i ligjeve që vijnë në plotësim-ndryshim mendohet se është çështje e kualitetit që ato e kanë, por ndoshta Avokati mund ta ketë për bazë edhe një çështje, ngase e dimë se kemi shumë afate, edhe ndërkombëtare, të cilat kërkojnë ligje në procedura të përshpejtuara dhe në këtë formë ato ndikojnë edhe në cilësinë e tyre. Duke marrë për bazë këtë dhe duke marrë për bazë edhe ligjin që e kemi miratuar për heqjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare, kemi parë se shumë ligje vijnë në formë të përshpejtuara.

Sidoqoftë, edhe nëse merret për bazë kjo, kjo nuk e amnistion asnjë institucion që t'i shkelë ligjet dhe më së lehti e kam unë të flas në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, sepse jam nga subjekti që vazhdimisht kam kërkuar zbatim të ligjit dhe në këtë aspekt krejt ato që na vijnë si rekomandime na bëjnë që vetëm ta shtojmë efikasitetin. Megjithatë, shihet se është esenciale që zbatimi i rekomandimeve, e kemi parë në disa raste, arsyetohet edhe me mungesë buxhetore, prandaj në përfundimet e debatit ka qenë që edhe pjesa financiare të jetë shtysë, apo që i jep jetë zbatimit të rekomandimeve, pa e përjashtuar asnjëherë edhe pjesën politike që, siç u përmend, edhe te rasti i pensioneve, rasti i njohur si rasti Grudiq, i cili duhet t'ia tërheqë vëmendjen pjesës politike që të jetë shumë më dinamik dhe të kërkojë më tepër në këtë fushë.

U tha edhe një çështje nga vetë Avokati se afati mesatar i kryerjes së lëndëve në gjyq është nga 5-8. Kjo besoj se është shqetësuese për secilin prej nesh, por unë po e marr guximin të them se ndoshta problemet më të mëdha që këtë mesatare e sjellin në këtë janë lëndët që kanë të bëjnë edhe me çështjet gjinore që prekin aspekte të ndryshme, qoftë pronësor, qoftë si reflektim i dhunës në familje dhe gjëra të tjera, gjë që për të gjithë ne është mjaft shqetësuese dhe mendoj se duhet të merret shumë më seriozisht.

Prandaj, unë shoh edhe disa gjëra që do të kishin ndikuar edhe në rritjen e kualitetit të respektimit të të drejtave të njeriut. E dimë se Kushtetuta jonë i ka disa konventa, por Avokati i Popullit ka paraparë që Kushtetutës apo Legjislacionit tonë do t'i shtohet efikasiteti, nëse pjesë e tyre janë disa konventa ndërkombëtare. Prandaj, ato i ka specifikuar ai, unë nuk po ta përsëris se cilat. Janë tri: ajo socio-ekonomike e disa të tjera të personat me aftësi të kufizuara, por unë do ta pyesja Avokatin nëse e sheh të nevojshme që edhe Konventa e Stambollit, e cila flet për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, do të jetë e nevojshme që të jetë pjesë e Kushtetutës, ngase shumë kritere që na kërkohen neve bazohen në këtë konventë.

Krejt këto së bashku janë gjëra që ne si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e kemi parë të nevojshme që, përpos se e pasurojnë punën e Avokatit, mbi të gjitha i bëjnë institucionet të kujdesshme që të gjitha këto rekomandime ato t'i zbatojnë dhe t'i shohin si detyrim të vetin. Vetë përqindja e ngritjes së rekomandimeve flet për efikasitetin e këtij institucioni, mbi të gjitha pjesa tjetër e lëndëve 'ex officio' po ashtu flet për një efikasitet të tillë, por mbi të gjitha ajo që duhet përmendur është edhe rritja e zbatimit të rekomandimeve, por që lë shumë edhe për të dëshiruar.

Prandaj, unë besoj se së bashku të gjitha ato që i kemi nxjerrë, edhe si reflektim i debatit më herët, edhe nga pjesa e raportit të Avokatit, të na bëjë të gjithëve më të kujdesshëm dhe detyrues ndaj asaj që ne e reflektojmë si pjesë e punës sonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që ta marrë fjalën, Mexhide Mjaku-Topalli. Urdhëro, Mexhide!

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ne të gjithë e dimë se në veprimtarinë e tij Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizimit dhe pavarësisë në të mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit.

Nëpërmjet përmbledhjes së raportit drejtuar autoriteteve përgjegjëse gjatë vitit 2016 dhe raportit të mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës, i cili mekanizëm është krijuar në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, si i tillë për herë të parë e prezanton përmbledhjen e një raporti të veçantë të këtij mekanizmi. Avokati i Popullit e jep një paraqitje përmbledhëse dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve të nxjerra gjatë vitit 2016, si dhe ofron opinione dhe rekomandime të përgatitura gjatë këtij viti për gjendjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Gjatë vitit 2016, Institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur një sërë arritjesh sa i përket një bashkëpunimi të mirë me institucionet vendore, me homologë dhe organizata ndërkombëtare, bashkëpunim me medie, po ashtu rritjen e besimit të qytetarit tek Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre, krijimi i një profili institucional proaktiv në identifikimin dhe ndjekjen e çështjeve. Por, ende mbetet sfida zgjidhja e problematikave të shtetasve që adresohen tek Institucioni i Avokatit të Popullit, ku shpesh mospërgjigjja dhe mosbashkëpunimi nga institucionet shtetërore e rëndon më tepër.

Shqetësues mbetet fakti i ekzistencës së një numri të lartë rekomandimesh, për të cilat nuk është kthyer fare përgjigje, pavarësisht insistimit të vazhdueshëm.

Avokati i Popullit e përmendi se e ka pranuar një numër të madh të ankesave, ndër to edhe ankesa të qytetarëve që janë drejtuar kundrejt Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, domethënë gjatë vitit 2016, e të cilat kanë të bëjnë me heqjen nga skemat pensionale të pensionistëve, të cilët, përveç pensionit kontributpagues, kanë qenë edhe në skemat tjera pensionale të rregulluara me ligje të veçanta.

Trajtimi i pensionistëve me Ligjin për skemat pensionale përbën shkelje në të drejtën e tyre, sepse pensioni kontributpagues është e drejtë e tyre e fituar me kontributet e tyre të paguara gjatë përvojës mbi 15-vjeçare në punën e tyre, kurse pensionet e fituara me ligje të veçanta, si pensioni për persona të verbër, pensionet që rregullojnë të drejtat dhe benificionet e posaçme për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidët, veteranët, invalidët e vdekur, të pjesëtarëve të marrë peng ose të zhdukur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të anëtarëve të familjeve të tyre, janë pensione që kompensohen për një arsye të veçantë. Prandaj, ky përjashtim nga skema pensionale i diskriminon përfituesit e pensioneve. Për këto raste, Avokati i Popullit në vitin e kaluar i është drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke kërkuar informata mbi bazën ligjore për pensionet, por nuk ka pranuar përgjigje.

Të nderuar kolegë,

Në letrën e dorëzuar më 22 gusht të këtij viti, Avokati i Popullit ndër të tjera shkruan se këtë raport ne deputetët duhet ta përdorim si një mekanizëm për të zhvilluar politika më efektive për ushtrimin e kontrollit parlamentar, me qëllim të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Po ashtu, ne e dimë se Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime me iniciativën 'ex officio' nëse dëshmitë, faktet, konstatimet, ose njohuritë e fituara nga mjetet e informimit publik apo burime të tjera ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Në qoftë se kërkesat nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut. Raporti i tillë është metoda e fundit e Institucionit të Avokatit, siç ishte rasti numër 265 i vitit 2017 drejtuar institucioneve përkatëse për faturat e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat e veriut.

Ndërkaq, në raportin e vitit 2016, Avokati i Popullit rithekson se korniza ligjore e të drejtave të fëmijëve ende nuk u plotësua me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, ndonëse Projektligji për mbrojtjen e fëmijëve është shqyrtuar në dy lexime në Komisionin Parlamentar, por ai prapë është në Programin qeveritar për vitin 2017, i llogaritur si punë e papërfunduar e Legjislaturës V.

Ky institucion në vazhdimësi ka ngrehur çështje për sigurimin e strehimit social, e në të njëjtën kohë ka shprehur shqetësim dhe ka rekomanduar plotësim-ndryshimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale dhe ende mbetet sfidë kriteri i vendosur për përfitim të ndihmës sociale për fëmijët nën moshën pesëvjeçare. Ky përkufizim përbën diskriminim në moshë, sepse me “fëmijë” nënkuptohet çdo fëmijë nën moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, si dhe ka vlerësime se një kufizim i tillë e thellon edhe më tepër gjendjen e rëndë, sepse këto familje në mënyrë të planifikuar në çdo pesë vjet e lindin edhe nga një fëmijë, në mënyrë që të mos u ndërpritet ndihma sociale.

Avokati i Popullit e paraqiti para nesh sot në diskutimin e tij rekomandimin nr. 382 në lidhje me cenimin e dinjitetit dhe së drejtës së pensionistëve për pensione. Avokati i Popullit më 25 nëntor 2016 ia ka përcjellë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale raportin me rekomandime, i cili ka të bëjë me detyrimin e shfrytëzuesve të pensioneve që pensionistët të paraqiten për çdo gjashtë muaj pranë organit kompetent, në mënyrë që të mos u ndërpritet pensioni. Andaj, Avokati rekomandon që Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale të plotësojë dhe ndryshojë Ligjin për skemat pensionale me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit të pensionistëve.

Në përfundim do të thosha se realizimi i rekomandimeve të Institutit të Avokatit të Popullit rrit besimin e qytetarëve tek institucionet e Republikës së Kosovës. Këtë raport e kemi diskutuar, si në Komisionin Parlamentar, po ashtu edhe në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe e mbështetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe, fjalën e ka deputetja Miljana Nikoliq. Urdhëroni!

MILJANA NIKOLIĆ: Poštovani,

Godišnji izveštaj Institucije Narodnog advokata za 2016.-u godinu ima dosta polovičnih informacija koja iskrivljuju pravu sliku. Ja sam predstavnik Srpske zajednice. Uz dužno poštovanje prema ostalim zajednicama, ovde ću isključivo pričati o Srpskoj zajednici.

Na strani 53 Izveštaja Omdusmana naslov je “Jednakost pred zakonom, ne diskriminacija”, a naše pitanje je da li je tako na terenu sa Srpskom zajednicom?

Na strani 63, Omdusman piše: “Albanci na severu Kosova i ostale nesrpske zajednice su nedovoljno uključeni u procesu donošenja odluka na opštinskom nivou, i nemaju dovoljno svojih

predstavnik...". Ja to moram demantovati. To nije tačno. Bila sam odbornik u Opštini Severna Mitrovica, od 19 odbornika 6 je nevećinskih zajednica, od kojih 5 Albanaca. Zna da na severu Kosova je 90% naroda srpske nacionalnosti, 10% je naroda ostalih nevećinskih zajednica. Od svih zahteva koji su upućeni Opštini Severna Mitrovica za renoviranje kuća, socijalnu pomoć, i tako dalje, realizovano je 55% zahteva za građenje iz nevećinskih zajednica.

U izveštaju se ne govori o raseljenim Srbima koji su bili primorani da napuste Kosovo. Mali broj povratnika, negde od 1,6-1,9% svakodnevno je izloženo problemima. Narodni Advokat uz mogućnost 'ex officio' da analizira ove slučajeve, nije to odradio. U ovom izveštaju ih nema. Isto tako, izveštaj ne sadrži nijedan primer uzurpiranih stanova, nekretnina, čiji su vlasnici Srbi.

U izveštaju nema ni problematike oko ličnih dokumenata. Mi Srbi smo diskriminirani, jer ne možemo izvaditi lična dokumenta, a za ista se čeka više meseci.

Nigde nisam pročitala u izveštaju ni neki primer za nestala lica srpske nacionalnosti, kojim se inače bavi multietnička kancelarija. Da bi porodice nestalih ostvarila novčanu naknadu, samo Srbima se uz osnovnu dokumentaciju traži i očitana Srpska lična karta, kao i račun za električnu struju. U odboru, to jest Komisiji za ljudska prava, ravnopravnost, nestala lica, peticije su izneti ovi nedostaci. Srpska lista je stava da ne podrži izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesja e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu. Urdhëro!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ne sot para vetes e kemi në diskutim raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2016. Ashtu sikur edhe kolegët e mi, edhe në komision e kemi shqyrtuar këtë raport.

Sinqerisht më duhet ta përgëzoj Avokatin e Popullit për raportin që sot ne po e shqyrtojmë, por të ju them sqerisht se me vëmendje i kam lexuar dhe raportet e tjera, me të cilat u është drejtuar Institucioni i Avokatit të Popullit institucioneve të Qeverisë, në veçanti duke e paraqitur veç e veç secilën ankesë të qytetarëve, njëkohësisht rekomandimet nga vetë institucioni, një shembull që nuk e kemi pasur asnjëherë.

Prandaj, e përgëzoj njëkohësisht për shkak se që të gjitha raportet janë publike, edhe për qytetarët, por edhe për vetë institucionet. Prandaj, në këtë drejtim, jo që do të duhej të bashkëpunojnë vetëm qytetarët, por ftoj institucionet e vendit, jo vetëm të bashkëpunojnë, por shumë herë është me interes të marrin edhe sugjerime nga vetë Institucioni i Avokatit të Popullit, në mënyrë që të mos shkelen të drejtat e njeriut.

Po i kthehem raportit. Tipar kryesor i raporteve të Avokatit të Popullit është se ato nuk e kanë për qëllim vetëm ta përshkruajnë punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, siç praktikohet zakonisht nga shumica e organeve që i raportojnë Kuvendit, por qëllimi më i rëndësishëm kryesor i këtyre raporteve është të japin informacione për gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, si dhe të paraqesin rekomandime konkrete drejtuar institucioneve publike përgjegjëse për përmirësimin e gjendjes, në veçanti.

Ky rol i Avokatit të Popullit, në paragrafin e rekomandimeve konfirmohet në Kushtetutë, si dhe në Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 135 i Kushtetutës - Raportimi i Avokatit të Popullit përcakton shprehimisht se Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vërehen shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e Administratës Publike dhe organet tjera shtetërore.

Pse është i rëndësishëm zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të raportit pra që është paraqitur? Në këtë raport të Avokatit të Popullit për vitin 2016, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit është 1 694, ndërsa numri i personave të përfshirë në ankesa është 3 686.

Nënkryetar, pak vëmendje për deputetët e LDK-së, sepse u ke dhënë sot shumë përparësi, prandaj kërko që të kenë vëmendje, sepse nuk është e parëndësishme edhe tema.

Prandaj, për autoritetet janë 500 ankesa drejtuar gjykatave. E tha edhe vetë Avokati në fjalën e tij, por sinqerisht do të duhej të shohim se është një sinjal i dritës së kuqe, për ç'gjë do të duhej të mendojmë të gjithë së bashku, sepse këto ankesa dhe atë që e përmendi Avokati në fjalën e tij, rreth 60 000 aktgjykime të paekzekutuara nga Gjyqësori tregojnë diçka që nuk jemi duke ecur përpara. Gjithashtu, 476 ankesa që janë të drejtuara për ministritë. Është një numër i madh gjithashtu edhe te komunat, që janë 283, pasuar edhe me shumë ankesa të tjera nga institucionet tjera.

Bazuar në raport, pra në tabelën nr. 7 në raport, implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raport për rastet që janë paraqitur te ky institucion është: Rekomandime të implementuar 36, të paimplementuara gjithashtu 36, që është 50:50, kurse rekomandime në pritje janë 101. Sipas këtij raporti, kemi rritje të rekomandimeve në vitin që jemi, po flasim për vitin 2016, në nivelin 203%, pra krahasuar me raportin e vitit 2015. Kjo tregon një anë pozitive që vetëdija e qytetarëve është në rritje, por mos harroni që janë ankesa për shkelje të të drejtave të njeriut.

Shihet një trend i rritjes së raporteve me rekomandime, sidomos për çështje sistematike të të drejtave të njeriut, ku përfshihet një numër mjaft i madh i qytetarëve, të drejtat e të cilëve janë shkelur, ndër to mund ta përmendim rastin e mosekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme të Gjyqësorit, ashtu siç edhe u tha, mungesën e mjeteve efektive juridike, çështjen e dinjitetit të

njeriut në rastin e detyrimit të pensionistëve që të dëshmojnë se janë gjallë, siç e tha edhe vet Avokati, dhe rastin e mirënjohur Grudiq, që sinqerisht nuk është kurrë e tepërt të flitet e të përmendet sa herë edhe në Kuvend, prandaj edhe pak do të ndalem këtu.

Është e rëndësishme të ndalemi pak tek opinioni i Avokatit të Popullit te ky rast. Ky opinion paraqet rastin e parë ku një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut i drejtohet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. bazuar në nenin 9 të Rregullores, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve për zbatimin e një vendimi të GjND-së kundrejt një vendimi të tretë. Po e përmend me qëllim, ngase edhe në mandatin e kaluar e kemi diskutuar bashkërisht edhe këtu. Edhe, institucionet, Qeveria e kaluar, pa e hequr fajin, r uroj që kjo qeveri të merret shumë seriozisht me këtë çështje.

Aktgjykimi i GjND-së në rastin Grudiq kundër Serbisë është aktgjykim parimor, me të cilin Serbia është obliguar që t'i kompensojë në mënyrë të njëjtë sipas aktgjykimit të lartpërmendur pensionet kontributdhënëse, pensionet invalidore të punës dhe pensionet familjare për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i kanë gëzuar këto pensione deri në vitin 1999, kur edhe janë ndërprerë në mënyrë arbitrare nga Serbia.

Serbia në vazhdimësi ka dhënë arsyetime për t'i ikur zbatimit të këtij vendimi të GjND-së, përkundër detyrimit për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Së këndejmi, obligimi për zbatimin e vendimeve të GjND-së, në anën tjetër, duke marrë parasysh se deri më tani institucionet e Republikës së Kosovës nuk e kanë ngrehur këtë çështje në instanca, nëpërmjet të cilave do të kërkohej zbatimi i aktgjykimit të GjND-së.

Së këndejmi, për të gjitha rastet tjera të kësaj natyre, Avokati i Popullit e ka parë të arsyeshme ta japë këtë opinion. Duke u bazuar në Rregulloren e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve, opinioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të detajuar e sqaron sfondin ligjor dhe kronologjik lidhur me çështjen në fjalë dhe del me rekomandime konkrete. Uroj që Qeveria ta marrë këtë parasysh dhe sinqerisht të bëjë, në fakt të fillojë, sepse deri më tani nuk kemi parë diçka në këtë drejtim.

Prandaj, Kuvendi, nëpërmjet komisioneve funksionale do të duhej të diskutonte hapur mbi rekomandimet e nxjerra nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të kërkojë informacione prej autoriteteve publike përkatëse sa është niveli i zbatimit dhe për t'i mbajtur gjithnjë përgjegjëse këto institucione për moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për shkak se paraqitja e rekomandimeve dhe zbatimi i tyre në praktikë e luan një rol kaq të rëndësishëm në raportimin e Avokatit të Popullit, votimi për miratim i raportit të Avokatit të Popullit do të dukej sikur nuk ka kuptim.

Këtë po e përmend, edhe një herë po e theksoj, për shkak se në legjislaturën e kaluar, pra unë bashkë me nëntë kolegë deputetë, e kemi thirrur një debat që është mbajtur në Kuvend dhe kanë dalë rekomandimet që mua më duhet t'ua rikujtoj disa nga kolegëve, të cilat janë votuar nga të gjitha subjektet politike, ndoshta më duhet t'i përmend edhe votat, prej 72 deputetëve që kanë qenë të pranishëm, 64 kanë qenë për, 5 kundër dhe 3 abstenime. Janë 7 rekomandime, por unë po i citoj vetëm 2 prej tyre me qëllim.

Rekomandimi që ka dalë nga ai debat, i pesti me radhë, “komisionet parlamentare përkatëse t'i ftojnë në debat udhëheqësit e institucioneve në komisionet përkatëse në Kuvend për t'i kuptuar arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit”.

Rekomandimi tjetër, që nuk po punohet në plotësim-ndryshimin e Rregullores, është rekomandimi i 6-të, “Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë plotësim-ndryshimit të Rregullores të parashohë vetëm diskutimin e raportit të Avokatit të Popullit, e të mos hedhet në votim”.

Prandaj edhe një herë, duke e ditur rëndësinë e këtij institucioni dhe duke e ditur që po flitet për të drejtat e njeriut dhe Avokati po i konfirmon, po jep rekomandime, atëherë unë e theksoj edhe një herë, është komplet e pakuptimtë që të hedhet në votim një raport për të thënë që është i saktë apo nuk është i saktë dhe, në fund të fundit, përvoja jo e mirë e Kuvendit për raportet e institucioneve të pavarura, të cilat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Mua më duhet t'ua sqaroj se unë s'e kam asnjë të drejtë t'u kërkoj deputetëve që të... Arben, s'mund të ju kërkoj që të ju ndjekin juve, duke e cilësuar fjalimin si interesant, ose jo, sepse këta ju ndjekin dhe e vlerësojnë vetë. Dhe, po të ishte ashtu, ju do të dilnit shumë keq, sepse unë e shoh këtu një pjesë të madhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju ishit vetëm deri tani, s'e keni asnjë koleg të grupit tuaj parlamentar, e para.

E dyta, unë gjatë gjithë seancës e kam respektuar Rregulloren pikë për pikë, 100%. Nëse Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës flet tri herë më shumë se ju, është normale sepse është tri herë më i madh se sa ju. Tani unë ju njoftoj se do t'ia jap fjalën edhe përfaqësueses së Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën”, zonjës Albulena Balaj-Halimaj. Pas fjalës së saj, meqë Grupi Parlamentar “6+” është deklaruar për këtë pikë të rendit të ditës, do të shkojmë në pauzë deri në orën pesëmbëdhjetë e tridhjetë.

Urdhëroni Albulenë, e keni fjalën. Faleminderit!

ALBULENA BALAJ - HALIMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të gjitha të gjeturat në këtë raport janë tema më vete, të cilat do të duhej të trajtoheshin një nga një, por në pamundësi të kësaj, ne po i trajtojmë disa tema, me të cilat vërtet duhet të merret Qeveria, e të gjithë ne, e ta përmirësojmë gjendjen në secilën fushë.

Institucioni i Avokatit të Popullit na raportoi për një situatë pothuajse të njëjtë në të gjitha fushat. Meqë janë identifikuar problemet, tashmë e kemi më të lehtë të merremi me to, sepse e kemi edhe detyrim të përbashkët. Ndër më shqetësueset janë lëndët e pazgjidhura nëpër gjykata, që sipas statistikave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2016 kanë ngelur 417 333 sosh. Prandaj, në këtë fushë secili është obliguar të punojë shumë më shumë për ta arritur zvogëlimin e këtyre lëndëve.

Një fushë tjetër me rëndësi është arsimi, pra të drejtat e fëmijëve, konkretisht pika 1.4.5 të faqja 45, tek dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla. Avokati i Popullit i ka pasur si raste vetëm katër dhe mua kjo shifër nuk më duket reale, sepse ne jemi dëshmitarë të më shumë rasteve të dhunës nëpër shkolla, e të cilat shpeshherë madje na prezantohen edhe nëpër rrjetet sociale. Andaj, unë e inkurajoj komunitetin e prindërve që ta njoftojë edhe Avokatin e Popullit në raste të tilla të dhunës.

Ndërsa për fushën shëndetësore, edhe ky raport vlerëson se kjo fushë mbetet njëra ndër fushat më së paku të financuara në Republikën e Kosovës dhe ky është njëri nga faktorët që qytetarët nuk e kanë shërbimin e duhur në institucionet shëndetësore. Pra, nëse e lexoni pikën 1.4.6 tek e drejta shëndetësore, ju vëreni se Institucioni i Avokatit të Popullit pothuajse të gjitha informacionet i ka marrë nga mediet, të cilat janë të pakta, sepse raste të shkeljes së të drejtave të njeriut në të drejtën shëndetësore ka të shumta.

Përveç tjerash, këtu thuhet edhe se nëpër spitale nuk ka barna, gjë për të cilën janë të njoftuar dhe e dinë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, por përveç kësaj nuk kanë, ose nuk janë në funksion aparaturat e nevojshme, të cilat kushtojnë fare pak, por që pa to rrezikohet jeta e qytetarëve. Dua ta marr shembull, në qytetin e Prizrenit, në Repartin e Peditrisë, po hiç më larg se dje pashë se fëmijëve u rrezikohej jeta për shkak të neglizhencës së institucioneve, ose personave përgjegjës, të cilët lejojnë mungesa të tilla.

Pra, në Repartin e Peditrisë mungonte një aparat rëntgen, i cili mund të kushtojë një 50 mijë euro, por që rëndësia e tij nuk diskutohet. E meqë jemi këtu, pra në këtë temë dhe në këtë çështje, i bëj thirrje ministrit të Shëndetësisë për t'u marrë me këtë problem dhe e lus që sa më shpejt që të jetë e mundur të ndërmarrë hapa të duhur për këtë çështje.

Pra, "Nisma për Kosovën" e mbështet raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016 dhe i propozon Institucionit të Avokatit të Popullit që në funksion të përmirësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë të organizohen fushata publike, pra fushata publike

nëpërmjet të cilave do të sensibilizohet publiku për të drejtën, ose për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të tyre në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Atëherë, punën e vazhdojmë në orën 15:30. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetaria e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.

KRYESUESJA: Përshëndetje, i vazhdojmë punimet e seancës. Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci. Urdhëroni!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje të pranishëm,

Në fillim dua të falënderoj zotin Jashari për fjalën e tij sot këtu dhe gjithë Institucionin e Avokatit të Popullit, pra avokatin dhe kolegët dhe bashkëpunëtorët e tij për angazhimin dhe punën që e bëjnë.

Në anën tjetër, është vërtet shqetësuese të shohim se përkundër që është një institucion i rëndësisë së veçantë, që duket se punon në realizimin e synimeve të tij dhe gjetjet e rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit akoma edhe sot nuk e marrin vëmendjen e duhur dhe, për më shumë, nuk arrijnë që nëpërmjet institucioneve tona shtetërore, personave përgjegjës, të krijojmë parakushte bazike për të përmirësuar gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

Ajo që është shqetësuese dhe bie në sy është se sivjet janë adresuar 173 rekomandime për institucionet publike të Republikës së Kosovës, gjë që sipas raportin në krahasim me vitin e kaluar shënon një rritje prej 203%, përderisa është shënuar rritje edhe në nivelin prej 100% të rasteve të hetuara sipas detyrës së tyre zyrtare, apo me vetiniciativë nga ana e institucionit. Të gjitha këto raste kanë të bëjnë me shkeljen sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kjo, në fakt, e paraqet një dëshmi për punën e Institucionit të Avokatit të Popullit, por është shqetësuese për gjendjen reale në Republikën e Kosovës në aspektin e respektimit të të drejtave të njeriut, aq më tepër kur kemi parasysh se një numër i madh i rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut as që adresohet fare për arsye nga më të ndryshme.

Po aq shumë shqetësuese mbetet edhe zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve, po ashtu kur kemi parasysh rekomandimet e institucioneve të pavarura, përfshirë këtu edhe rekomandimet që dalin nga ky raport.

Duke filluar që nga pjesa që ka të bëjë me përgjegjësinë për mjedisin jetësor që paraqet një analizë mjaft gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale në këtë fushë dhe ndikimit në të drejtat e njeriut, është shqetësuese të shohim se buxheti i planifikuar për mbrojtje të mjedisit është shumë i ulët.

E, nga ana tjetër, ndotja e ajrit është shumë e lartë dhe kjo ndikon në gjendjen e përgjithshme shëndetësore, duke sjellë pasoja serioze për qytetarët tanë.

Akoma edhe sot nuk është arritur që mjedisi të vendoset si një nga prioritetet e Qeverisë, përkundër situatës së vështirë mjedisore, edhe kjo gjë do të duhej të adresohet në mënyrë adekuate.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve si një formë e degradimit ujor po vazhdon akoma edhe sot e kësaj dite.

Dhe, obligimi ligjor i shtetit për sigurimin e zhvillimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm, si një prej resurseve që janë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe për zhvillimin social ekonomik ka mbetur vetëm një nga dispozitat ligjore, të cilat fare nuk gjejnë zbatim në vendin tonë.

Dua të ndalem pak te pjesa, e cila ka të bëjë me sigurinë e fëmijëve dhe e kemi parasysh se është shumë dëshpëruese fakti se nuk është përmirësuar infrastruktura, e cila do të garantonte të drejtën e jetës, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve pranë shkollave dhe institucioneve të tjera, përfshirë këtu edhe çerdhet apo kopshtet e fëmijëve.

Mungesa e rrethojave adekuate, madje edhe asaj të gjelbër, si pjesë përcjellëse e shtigjeve apo trotuareve të këmbësorëve pranë çerdheve, kopshteve dhe shkollave si dhe nënkallimet e mbikalimet të rrugët magjistrale, të cilat janë shqetësuese dhe sado që janë raportuar disa raste, madje raste konkrete, jemi dëshmitarë që akoma edhe sot nuk është arritur një koordinim i mirë në mes të komunave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Policisë së Kosovës, e për shkak të këtij moskoordinimi akoma rrezikohet jeta e fëmijëve, përkatësisht e nxënësve tanë edhe afër objekteve shkollore.

Një gjendjeje të këfillë i kontribuon edhe mospërfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, përfshirë edhe interesat e tyre para fillimit të ndërtimit të rrugëve, gjë që shpeshherë ata janë të painformuar dhe nuk mund të japin kontributin e tyre.

Dhe përderisa po flasim për të drejtat e fëmijëve në këtë periudhë raportuese, korniza ligjore në lidhje me të drejtat e fëmijëve nuk u plotësua me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Sipas raportit, shihet se Institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar 73 ankesa të parashtruara kryesisht nga prindër të fëmijëve dhe ashtu sikurse besoj edhe në raste të tjera, ky është një numër shumë i vogël se sa shqetësimet e përditshme të cilat i kanë prindërit, e të cilët nuk i adresojnë për arsye të ndryshme.

Ajo që bie në sy është se në shumicën e rasteve hulumtimet e kanë trajtuar mungesën e kushteve elementare për mësim në disa shkolla, përfshirë vështirësitë dhe pengesat për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, të cilët për çdo ditë janë të diskriminuar në qasje në arsim cilësor dhe në shumicën e rasteve mungon infrastruktura bazike, duke filluar prej asaj fizike, pastaj edhe mbështetja profesionale që do t'u ndihmonte këtyre fëmijëve që të arrijnë kompetencat, të cilat i kanë të garantuara edhe me Kushtetutë.

Problematik mbetet edhe sigurimi i transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ajo që bie në sy është se dallon prej komunës në komunë dhe në rastet më të shpeshta, kjo është lënë në vetë vullnetin e komunave, duke mundësuar kështu shkeljen shpesh të të drejtave të fëmijëve, gjegjësisht të fëmijëve me nevoja të veçanta në këtë rast.

Pra, akoma edhe sot gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë mbetet shumë e rëndë dhe barriera apo vështirësia kryesore nuk është vetëm mbështetja në transport, por e përsëris, edhe në infrastrukturën fizike dhe në punën që për çdo ditë duhet t'u ofrohet atyre në përmbushjen e kompetencave, nevojave dhe kërkesave të tyre.

Derisa po flas për fushën e arsimit, gjegjësisht në shkollë shqetësuese mbetet edhe çështja që adresohet edhe në këtë raport, e që ka të bëjë me dhunë dhe gjendjen e sigurisë në shkolla.

Sipas raportit janë zhvilluar katër hetime, por në bazë të asaj që ne përcjellim për çdo ditë në media, gjendja vazhdon të mbetet shumë shqetësuese në aspektin e përdorimit të dhunës, qoftë të bashkëmohatarëve apo edhe nga ana e personave të rritur ndaj fëmijëve, duke shkaktuar kështu një shkelje serioze të të drejtave të tyre.

Dhe, derisa po flas për dhunën, është shqetësuese dhe adresojnë edhe të gjeturat e këtij raporti edhe çështjen e dhunës në familje, si një problem shumë serioz në shoqërinë tonë.

Në këtë drejtim është shqetësuese pasi bëhet fjalë edhe për dhunën në familje, pasi që vetëm një numër i vogël i rasteve raportohen tek autoritetet kompetente dhe e dënueshme është se edhe në rastet kur ka pasur një denoncim të dhunës, gratë të cilat i kanë paraqitur rastet e tilla nuk kanë gjetur përkrahje nga institucionet, të cilat do të duhej t'u ofronin mbështetje. Vetëm kohëve të

fundit kemi pasur raste që dhuna e bashkëshortëve ndaj bashkëshorteve, gjegjësisht ndaj grave të tyre ka përfunduar edhe në mënyrën më të rëndë, pra kemi pasur së fundmi tri vrasje të bashkëshorteve nga bashkëshortët dhe nuk janë shumë të largëta kur ato kanë qenë edhe të raportuara.

Në përgjithësi ky raport i adreson një varg çështjesh në të gjitha fushat dhe ashtu sikurse ata kanë paraqitur në kërkesën e tyre, unë uroj dhe besoj që ne do të gjejmë secili mundësitë dhe hapësirat ligjore në dispozicion, po do të iniciojmë edhe vetë çështje, që i përkasin fushës sonë dhe të cilat do të ndihmonin respektimin e të drejtave të njeriut dhe do të bënë një presion, gjegjësisht një mbikëqyrje kryesisht të ekzekutivi, në mënyrë jo vetëm të përmirësohet legjislacioni në këtë drejtim, por të mundësohet respektim i plotë i tij. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: E nderuar kryesuese,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë të dashur,

Desha fillimisht të adresoj një çështje që u përmend dhe u mohua, një konkludim i Avokatit të Popullit lidhur me të drejtat e njeriut që shkelen në katër komunat në veri të vendit, ku përfaqësuesja e Listës Serbe tha “nije taçno”. E unë po dua t’i them që “taçno” është deri në pikë të fundit, sepse përdërisa qytetarët tanë në ato katër komuna kanë frikë që edhe të kthehen në banesat e tyre, qytetarët e komunitetit serb trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Po arsyeja pse u paraqita sot është që të diskutoj një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, sepse jetojmë në një vend ku qytetarëve të këtij vendi pothuajse në baza ditore u shkelen të drejtat e njeriut dhe kemi Avokatin e Popullit, i cili me aq kapacitet sa ka, qoftë financiar, qoftë burime njerëzore, e bën atë që është e mundur.

Por kisha pasur dëshirë të fokusohet në një çështje të cilën desha ta ngre sot, e ajo është ‘pingpongu’ që luhet me qytetarët e këtij vendi që ballafaqohen me administratën publike, veçanërisht me institucionin e ekzekutivit, pra me Qeverinë.

Çka ndodh zakonisht është që me një vendim të padrejtë qytetari detyrohet të shkojë në shkallën e dytë dhe aty pothuajse menjëherë i vërtetohet ose ka heshtje administrative dhe me atë rast bëhet vendimi i formës së prerë, me ç’ rast ai ballafaqohet pastaj me gjykatë dhe gjykata e dërgon rastin prapë te ministria apo ATK-ja ose Dogana, e cila prapë shpërfill ose nuk vepron fare, prapë i duhet të ngre padi dhe kështu shkon 2-3 herë.

Pasi të kryhet krejt kjo procedurë, duhet të ankimohej kjo procedurë dhe pastaj për çdo rast pritet 10 deri 15 vjet për ta përfunduar një shkelje shumë të lehtë ose shumë të vogël që mund të adresohet në momentin ose instancën e parë.

Pra, vetëm pse ekziston një diskrecion, ai nuk po përdoret ose po përdoret në të keq të qytetarëve dhe unë vërtet kisha pasur dëshirë që në raportin e 2017 ose të vitit të ardhshëm ta shohim nga Avokati i Popullit një rekomandim edhe për ne se si mund ta adresojmë këtë problem që është jetik për qytetarët e këtij vendi.

Është duke shkaktuar probleme të jashtëzakonshme edhe për bizneset e Republikës së Kosovës, veçanërisht në raport me Administratën Tatimore dhe Doganat, ku mjetet e tyre mbeten të bllokuara me vite të tëra vetëm e vetëm që pas shuarjes ose shkatërrimit të tërësishëm të biznesit, të marrin një vendim gjyqësor me të cilën ata fitojnë.

Pra, po flasim jo vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik, po në aspektin e respektimit të të drejtave elementare dhe krijimit pikërisht të këtyre lëndëve të shumta, ku prej një lënde po krijohen 2, 3, 4 ose më shumë lëndë, ku po bëhet fjalë për të njëjtin vendim dhe për të njëjtin person.

Pra, kisha pasur dëshirë që Avokati i Popullit të na bie edhe neve një rekomandim dhe të na tregojë dhe të kërkojë edhe ndihmën tonë dhe besoj që të gjithë jemi të vullnetit të punojmë së bashku në atë drejtim që t'i adresojmë dhe të eliminojmë këtë lojë të 'pingpongut' që po bëhet në mes të këtyre dy institucioneve, të Qeverisë dhe gjyqësorit të Kosovës me qytetarët e Republikës. Faleminderit!

KRYESUEJA: Faleminderit, Korab! Fjalën e ka deputetja Luljeta Veseli-Gutaj.

LULJETA VESELI-GUTAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Avokatit të Popullit, hartuar dhe prezantuar në një dokument është i një rëndësie të veçantë dhe paraqet një vlerësim mbi gjendjen reale të zhvillimeve brenda shoqërisë dhe shtetit tonë.

Para disa ditësh Avokati i Popullit ka raportuar para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në Kuvendin e Kosovës, gjatë raportimit dhe diskutimeve të përbashkëta kemi reflektuar për të gjeturat dhe rekomandimet e dala, gjithashtu edhe për shqetësimet me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Tani para nesh kemi një të detajuar, i cili reflekton seriozitetin dhe punën e mirë që ka bërë Avokatit të Popullit për periudhën kohore janar-dhjetor 2016, lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Gjatë leximit dhe analizimit të këtij raporti unë do të bëj rezonim në disa fusha.

Këtu vërehet arritje e veçantë në kategorizimin e këtij institucioni si detyrim kushtetues si dhe miratimi i Ligjit për Avokatin e Popullit.

Sa i përket besimit të qytetarëve në raport me Institucionin e Avokatit të Popullit, është për t'u admiruar e vlerësuar lart se Kosova radhitet e para në rajonin e Ballkanit.

Adresimi i 173 rekomandimeve për institucionet publike të Republikës së Kosovës shënon rritje të lartë pozitive në krahasim me vitin paraprak.

Gjithashtu rritje e lartë është shënuar edhe në raste të rasteve të hetuara 'ex officio', krahasuar me vitet e kaluara që kanë të bëjnë kryesisht me shkelje sistematike të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ajo çka konsideroj se është shumë e rëndësishme të thuhet bazuar në këtë raport, është se ka ngecje, apo më mirë të thuhet, nuk kemi përparim të theksueshëm në shumë fusha. Kjo nënkupton se nuk kemi reforma të mirëfillta brenda institucioneve, e cila rezulton nga vetë ankesat e qytetarëve, për çka është çudi se këto ankesa të tyre si taksapagues të shtetit nuk merren parasysh me seriozitet nga institucionet relevante të zbatueshmërisë.

Ky raport bazohet në disa shtylla, si: deputete dhe anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, gjatë analizimit të këtij raporti kam vërejtur shumë faktorë shqetësues relevantë bazuar në numrin e madh dhe në rritje të ankesave që kanë të bëjnë me gjyqësorin, administratën publike në nivel lokal dhe qendror si dhe ankesat për të drejtat ekonomike dhe sociale.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me rekomandimet e duhura lidhur me këto çështje dhe konsideroj se të gjitha institucionet publike duhet t'i marrin parasysh sa më parë rekomandimet e Avokatit të Popullit për t'i përmbushur detyrimet e tyre, në mënyrë që jeta e qytetarëve tanë të bëhet më e besueshme në raport me mekanizmat shtetërorë.

Përkatësisht sa i përket sistemit gjyqësor këtu vërehet qartë se kjo shtyllë e shtetit po përballlet me një zvarritje të proceseve gjyqësore, ku dëshmia më e madhe është numri i lëndëve të pazgjidhura, që kalon 415 mijë lëndë nëpër gjykata dhe kjo është shqetësuese për vetë faktin se ndikon negativisht në shumë procese të një shteti demokratik.

Gjithashtu dëshiroj të theksoj se në këtë raport mbetet shqetësuese mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, respektimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, sektori i shëndetësisë, barazia gjinore, ku kërkohet në rekomandimet e Avokatit një bashkëpunim i ngushtë të profesionistëve dhe institucioneve përkatëse, tek të cilat janë drejtuar nëpërmjet këtij raporti me rekomandimet përkatëse.

Shqetësim tjetër mbetet edhe dhuna në familje, e cila po paraqet një problematikë shumë serioze në shoqërinë kosovare.

Personalisht unë u jap mbështetje të fuqishme çështjeve të ngritura në këtë raport, me theks të veçantë respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe kundër dhunës, duke kërkuar nga ka Kuvend që t'i adresojë mirëfilli këto çështje, duke rishikuar dhe hartuar ligjet për të gjitha institucionet publike, ku duhet kërkuar llogaridhënie dhe ngritje të efikasitetit të punës së tyre.

Po ashtu e rëndësishme është për t'u vlerësuar puna e Avokatit të Popullit në ngritjen e çështjeve të skemave pensionale, me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit të pensionistëve dhe mundësisë që qenësisht dhe të papenguar ata ta gëzojnë të drejtën e tyre, për çka i rekomandon Ministrisë së Punës Mirëqenies Sociale që të iniciojë procedurat për ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Në atë mënyrë që të riparojë shkeljet ndaj pensionistëve, si dhe të funksionalizojë burimet e saj verifikuese në raport me statusin e pensionistëve dhe nëpërmjet formave të tjera, siç janë analizuar në raport, të bëjë njoftim publik për ndryshimin e procedurave.

Shumë e rëndësishme për t'u veçuar dhe për t'u përgëzuar puna e Institucionit të Avokatit të Popullit është ngritja e çështjes së faturimit të rrymës për katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, drejtuar me rekomandime ZRRE-së dhe institucioneve të tjera përkatëse si shqetësim dhe shkelje të të drejtave të njeriut në raport me qytetarët e Republikës së Kosovës.

Asnjëherë dhe askund nuk guxojnë të vlejnjë standarde të dyfishta brenda një sistemi ligjor të një shteti dhe këtu bazuar në të gjeturat e këtij raporti është konstatuar se faturimi dhe shtrenjtimi i energjisë elektrike është bërë mbi baza diskriminuese, për çka janë dëmtuar qytetarët për katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Zbatimi i rekomandimeve të paraqitura në këtë raport nga Institucioni i Avokatit të Popullit është domosdoshmëri e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, duke tejkaluar të gjitha sfidat me guxim e qëndrueshmëri nga autoritetet përkatëse.

Duke marrë parasysh të gjitha këto çështje të ngritura në këtë raport bazuar në të gjeturat reale dhe me argumente, me rekomandimet e dala unë përgëzoj Institucionin e Avokatit të Popullit dhe

Avokatin e popullit, zotin Hilmi Jashari, për punën me përkushtim që ka bërë dhe konfirmoj mbështetjen e plotë të raportit në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Unë e përgëzoj Avokatin e Popullit për këtë raport jashtëzakonisht të mirë, të thuktë dhe faktik, që për mua institucioni i cili na përfaqëson është pas Gjykatës Kushtetuese, më i rëndësishmi i këtij vendi.

Është për të ardhur keq që mekanizmi i ndëshkueshmërisë në shtetin e Kosovës pothuajse nuk ekziston.

Në bazë të gjeturave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, natyrisht se në një vend gjysmënormal sikur të funksiononte prokuroria e shtetit ishin ngritur shumë akuza dhe ishin bërë shumë hetime rreth të gjeturave që Avokati i Popullit i ka parashtruar në raportin e tij.

Po e marr një shembull shumë skandaloz, me vite të tëra qytetarët e Kosovës janë vjedhur në faturat e rrymës nga KEDS-i dhe kjo duket sikur një përrallë e keqe, sikur një shaka e dhimbshme, por askush nuk ka kaluar në përgjegjësi të këtij akti të shëmtuar, të kësaj hajnie publike dhe kësaj plaçkitjeje të jashtëzakonshme. Përkundrazi flitet nga Rregullatori i Energjisë për rritjen e mundshme të çmimit të energjisë elektrike.

Shkelja e të drejtave të njeriut në Kosovë bëhet pikërisht nga organet e drejtësisë, nga gjykatat, nga prokuria, nga hetuesia e shtetit, nga Ministria e Drejtësisë dhe nga institucionet e tjera qeveritare.

Ku e mbështes këtë? Për shembull, është e drejtë elementare e çdo qytetari, e çdo gazetari, e çdo deputeti që të ketë qasje në dokumentet zyrtare të vendit të vet. Kjo e drejtë, edhe pse e garantuar me ligj, u mohohet edhe qytetarëve, edhe deputetëve, edhe gazetarëve dhe çdo kujt në këtë vend.

Ne e dimë se kur ne si deputetë nuk arrijmë të marrim informacionet zyrtare, për shembull, se çfarë ndodh në ndërmarrjet publike të këtij vendi, imagjini se nëpër çfarë katrahurash kalon një gazetar, e të mos flasim për një qytetar të thjeshtë.

Në këtë vend çdo njeri i thjeshtë, e lëre më deputet, e di se ka drejtësi absolute selektive. Kjo drejtësi selektive vërehet çdo ditë brenda vendit tonë. Fatkeqësisht, për drejtësi selektive thirret edhe brenda përbrenda Kuvendit të Kosovës nga rryma dhe parti të ndryshme politike, ku për shembull, njëra parti politike thotë është kapur sistemi i drejtësisë, po e shkapëm, do ta kapim ne si parti.

Nuk flitet për drejtësi, por flitet që kur një gjykatës ose një prokuror merr vendim të gabuar, por që dëmton anëtarin e një partie të caktuar politike, atëherë nuk ka drejtësi. Ndërsa kur kundërshtarin tjetër e godet kjo shtrebbësi institucionale, atëherë ka drejtësi. Kjo është gabim që të paktën brenda përbrenda Kuvendit të Kosovës dhe logjikës së deputetëve të Parlamentit të Kosovës nuk do të duhej të ekzistonte.

Nuk po flas për gjendjen e mjerueshme të të drejtave të fëmijëve e as të femrave, e as të pleqve, sepse ato dihen dhe janë shumë mirë të raportuara në këtë dokument që na e ka sjellë Avokati i Popullit.

Dëshiroj të ndalem te një kategori që është nga më të dhimbshmet, kategoria e të burgosurve në Kosovë.

Ne e dimë se ka shumë të burgosur që nëpërmjet gjykimeve paushall janë dënuar dhe dënohen dy herë, edhe nga shoqëria, por edhe nga institucionet e burgjeve.

Për shembull, është për të ardhur keq që në Burgun e Dubravës, sipas raportit të Avokatit të Popullit, nuk ekziston një kuzhinë, jo moderne, nuk ekziston pothuajse fare kuzhina atje dhe kur ne shpenzojmë miliona për gjëra krejt pa lidhje, atje ndihet mungesa e një kuzhine.

Po e mbyll fjalimin me një rekomandim dhe lutje të Avokatit të Popullit që ta ketë parasysh për vitin e ardhshëm ta dijë që gjatë hetimeve në Kosovë kur një njeri shpallet i dyshimtë dhe merret në pyetje nga policia e shtetit, por edhe nga prokuroria, a është e drejtë elementare e njeriut që ky persona ta ketë një kopje të raportit, të protokollit, të deklaratës, të cilën e jep pranë organit të hetuesisë. Një gjë e tillë nuk i garantohet asnjë qytetari të Kosovës

Dhe, e dyta, Avokati i Popullit të interesohet shumë më shumë se në çfarë forme merren vendimet paushall nga ana e gjykatave të Kosovës, pikërisht për shkak të gjendjes së mjerueshme ekonomike, për shkak të kushteve tepër të vështira në të cilën punojnë gjykatësit dhe stafi tjetër i gjykatave të Kosovës, duke mos harruar edhe ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë, ku është bërë pa xhama, ka mungesë të oksigjenit dhe në të shumtën e rasteve gjykatësve u bie edhe të fiktë dhe të bëjë një hulumtim Avokati i Popullit në të ardhmen se çfarë mundësie kanë të burgosurit për rishqyrtimin e lëndëve të tyre, në qoftë se ata mendojnë që janë dënuar pa të drejtë. Sepse në bazë të përvojës time dhe hulumtimeve të mia që kam të kaluarën në kohën kur kam qenë gazetar, edhe pse njerëzit kanë sjellë fakte të pamohueshme, fakte të reja, Prokuroria dhe gjykatat e Kosovës nuk kanë pranuar t'i rihapin këto raste.

Përndryshe, zoti Jashari, edhe një herë faleminderit shumë dhe unë si deputet i Parlamentit të Kosovës do të mundohem të luftoj edhe për rritjen e buxhetit të këtij institucioni, i cili po them, është një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm për funksionimin normal të shtetit të Kosovës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti pa grup, Veton Berisha.

VETON BERISHA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Avokat i Popullit, zoti Hilmi Jashari,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që fillimisht të falënderoj Avokatin e Popullit për prezencën e tij dhe përkushtimin e tij ligjor dhe po e kryen një obligim jashtëzakonisht të rëndësishëm, aq më tepër që është i përgjegjshëm edhe ndaj neve këtu si deputetë dhe, në të njëjtën kohë nuk dëshiroj të përsëris ato çka u thanë në pjesën më të madhe të diskutueseve, pajtohem sepse janë gjëra të ditura dhe evidente.

Por fokusin tim të diskutimit normalisht që do ta fokusoj bazuar edhe në mandatin tim të përfaqësimit të komunitetit egjiptian dhe ashkali që përfaqësoj këtu në Kuvend dhe normalisht diskutimin tim do ta drejtoj mbi këtë bazë.

E komplimentoj zotin Jashari për raportin e tij, përkushtimin dhe hapjen e Institucionit të Avokatit të Popullit në masë të madhe.

Gjithashtu është vërejtur një qasje dhe një promovim më i madh i konventave ndërkombëtare, deklaratave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe instrumentet përcjellëse si akte shumë të rëndësishme të inkorporuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat janë obligime shtesë dhe të pranuar vullnetarisht nga shteti i Kosovës. Akte këto, të cilat mbajnë mbi barrë të drejtat themelore të njeriut.

Inkurajoj Institucionin e Avokatit të Popullit të vazhdojë ashtu siç është duke këmbëngulur në implementimin dhe promovimin e Konventës për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe kërkoj që mbi këtë dokument Institucioni i Avokatit të Popullit të vazhdojë të mbajë aktivitetet.

Unë si përfaqësues i komuniteteve egjiptian dhe ashkali e konsideroj Institucionin e Avokatit të Popullit si një prej institucioneve më të besueshme, aq më tepër më bën të ndihem mirë kur edhe në barometrin e Ballkanit për vitin 2017 ky institucion është ranguar si më i besueshmi në Kosovë dhe ky vlerësim është bërë nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, bazuar në hulumtimin vjetor të opinionit publik, dhe kjo më bën të ndihem mirë.

Është vërejtur po ashtu një rritje të përqindjes në statistikat e rasteve të ankesave të pranuar dhe të shqyrtuara nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit edhe nga komunitetet tona.

Nga kjo evidencë vlerësohet që nga vitet e kaluara nga 1%, tani aktualisht komuniteti egjiptian dhe ashkali numëron rritje 4%. Po megjithatë, mendoj se nuk është e mjaftueshme dhe mendoj se

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe të gjithë ne kemi nevojë për një promovim më të madh të mandatit në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe të ketë më tepër dëgjime publike në terren.

E vlerësoj shumë prezencën e dukshme të Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesve të tij në terren, përkatësisht në lagjet e banuara me komunitetet tona dhe theks të veçantë e vlerësoj shumë ndërhyrjen e tij në zgjidhjen e problemit të vendbanimit të lagjes “Kristal” në Pejë.

Po ashtu është për t’u vlerësuar menaxhimi i rasteve, të cilat me vite të tëra kanë qenë në sirtarë dhe tani ato e kanë marrë epilogun e zgjidhjes.

Institucioni Avokati i Popullit ka rritur dukshëm rastet e hapura ‘ex officio’ për komunitetet egjiptian dhe ashkali.

Mbetet shumë punë për t’u bërë, sidomos në çështjet të cilat do t’i potencoj në vijim, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me të drejtat e njeriut.

Zoti Jashari, kërkohet angazhim më i madh në fushën e arsimit, ku kërkohet të bëhet monitorimi i ligjeve, akteve nënligjore, udhëzimeve administrative që prekin çështjet e komuniteteve egjiptian dhe ashkali, sidomos në rastet e braktisjes së procesit mësimor të mësimin fillor. Po ashtu, kërkohet të monitorohet Udhëzimi administrativ për qendrat mësimore dhe Udhëzimi administrativ për aplikimin e masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrimin e kandidatëve nga komunitetet joshumicë në institucionet publike të arsimit të lartë. Ne ballafaqohemi me problemin e uzurpimit të pronave dhe ekzistimi i rasteve të pengesave për të ushtruar të drejtën pronësore dhe neglizhimi apo mosprioritetizimi i këtyre rasteve nga gjykatat, me ç’ rast po mohohet një e drejtë, e cila ka impakt të drejtpërdrejtë edhe në çështjet e tjera të rëndësishme për komunitetin tonë.

Kërkohet më tepër angazhim i të gjithë neve dhe meqenëse është evidentuar edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit, duhet kushtuar prioritet më të madh rasteve të familjeve për strehim të qëndrueshëm dhe të nevojshëm dhe kërkohet siguri më e mëdha në këto vendbanime, si dhe kërkohet angazhim më i madh në eliminimin e zvarritjeve të proceseve gjyqësore nga ana e gjykatave për rastet e tilla. Kërkoj nga Institucioni i Avokatit të Popullit që të angazhohet më tepër në çështjen e punësimit të komuniteteve egjiptian dhe ashkali, duke vepruar dhe duke monitoruar Ligjin për shërbimin civil, më saktësisht, nenin 11 dhe duke monitoruar aktet e tjera përcjellëse, të cilat janë obliguese për Ministrinë e Administratës Publike që të jenë të implementuara.

Gjithashtu, vlerësohet dhe kërkohet monitorim më i madh i bashkëpunimit dhe rritjes së besimit për bashkëpunim në mes të komunitetit egjiptian dhe ashkali dhe Policisë së Kosovës, pasi që mendoj që në një masë të caktuar ky raport nuk është i kënaqshëm, sepse janë krijuar barriera jo

të dobishme nga të dyja palët, qoftë nga neglizhimi i rasteve nga Policia e Kosovës, ashtu edhe nga vetë komuniteti, për shkak të humbjes së besimit dhe këtu kërkohet ndërhyrje e Institucionit të Avokatit të Popullit, në mënyrë që të relativizohet ky raport.

Kërkoj dhe mendoj që duhet një përkushtim më i madh në kooperimin në mes të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave joqeveritare që merren dhe janë nga komunitetet egjiptian dhe ashkali dhe po ashtu, organizatat që merren me të drejtat e tyre. Shqetësuese është mospjesëmarrja e këtyre organizatave nga komunitetet egjiptian dhe ashkali në Ditën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mosnënshkrimi i deklaratës nga ana e tyre. Po ashtu, kërkohet sipas detyrës zyrtare të monitorohen rastet e largimit të familjeve nga skemat sociale pa bazë ligjore apo të kushtëzuara dhe me çështje të caktuara nga individë të caktuar. Kërkohej monitorim i procesit të kthimit dhe të realizimit të të drejtave të tyre qoftë nga vendet e treta, apo edhe nga diaspora. Shteti i Kosovës ka marrë obligime shtesë, të cilat në masë të madhe nuk po i implementon. Andaj, kërkojmë monitorim të këtij procesi. Kërkojmë reagimin tuaj të menjëhershëm në rastet e përdorimit të gjuhës së përdorur të urrejtjes, të cilat janë me plot elemente raciste, e sidomos kur kjo bëhet nga zyrtarët shtetërorë, shërbyes civilë, media e të tjerë.

Kërkohej ndërhyrje e institucionit tuaj në të gjitha rastet kur për ne dhe ndaj nesh përdoret termi famëkeq i ashtuquajtur “RAE” si shkurtesë me të cilën ne çdo ditë ofendohemi dhe aq më tepër kur ky term konsiderohet antikushtetues. Gjithashtu, kërkohet vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit për ekzistimin e strategjive kinse për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ndërsa bazën kryesore e ka në një element shumë racist, e që aludohet në ngjyrën e lëkurës të këtij komuniteti dhe në 10% të komunitetit që mund të kenë probleme të njëjta.

Ju njoftojmë se egjiptianët janë larguar nga kjo strategji dhe kërkojnë trajtimin e tij sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi. Kërkohej vazhdimi i bashkëpunimit me zyrat komunale të komuniteteve, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i punës dhe mandatit të tyre dhe duhet të vlerësohet se a janë në shërbim të komuniteteve apo të dikujt tjetër. Kërkohej shtimi i rasteve mbi hetimet efektive në prokurorinë, në rastet kur kanë të bëjnë me rastet e komuniteteve tona. Ju inkurajojmë në marrjen e rasteve të personave pa shtetësi, ku akoma komuniteti im numëron raste të shumta dhe shpeshherë mohohet apo neglizhohet kjo e drejtë. Mendoj që kjo e drejtë duhet t’i takojë secilit nga ne.

Zotin Jashari e falënderoj shumë për trajtimin e një rasti që është shumë i ndjeshëm, është fjala për rastin e zhdukjes së një qytetari nga komuna e Gjakovës, zotit Xhemshit Jashari, i cili në janar të vitit 2015 është zhdukur dhe në raportin tuaj pas hetimit të këtij rasti keni evidentuar shkelje të shumta që janë bërë nga mekanizmat e hetuesisë, së hetimit të këtij rasti. Pres që institucionet e mbikëqyrjes të sistemit të drejtësisë të lexojnë raportin dhe të ndërmarrin masat e nevojshme. Gjithashtu, kërkohet monitorimi i rasteve të hetimit dhe procedimit të lëndëve të

viktimave civile, të të vrarëve dhe të të zhdukurve të familjarëve nga komuniteti egjiptian dhe ashkali.

E fundit, kërkoj vazhdimin e monitorimit të ndërmarrjes së masave në lidhje me vendbanimin e banorëve të ashtuquajtur “ish-burgu i Gurakovcit” në Istog dhe kërkojmë që Komuna e Istogut të marrë masa duke siguruar kushte më të përshtatshme banimi. Ju si përfaqësues i Institucionit të Avokatit të Popullit normalisht që e keni një rol jashtëzakonisht në çështjet, të cilat unë i potencova. Unë, e përkrah raportin tuaj, sepse vërtet pasqyron në mënyrë precize, saktë, veprimet apo mosveprimet e institucioneve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Shkojmë me rend, Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Unë kam folur në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, tash po flas në emrin tim. Faleminderit!

Megjithatë, unë po vazhdoj aty ku mbeta, edhe kjo kishte të bënte me mbrojtjen e ambientit, shqetësim i veçantë është edhe shkarkimi i kanalizimeve në rrjetet ujore, në rrjedhat ujore që është bërë një normalitet tragjik dhe ligji e ministria në këtë drejtim kanë dështuar. Keqmenaxhimi i deponive të mbeturinave përcillet me një parregullsi të natyrave të ndryshme dhe paraqet një rrezik permanent, po ashtu përmendet në këtë raport. Për personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta në të vërtetë organizohen vetëm takime solemne dhe ndonjë tubim ceremonial, por në këtë drejtim sa i përket përmirësimit të kushteve për jetë dhe lëvizje të lirë, nuk bëhet diçka thelbësore, sidomos të rrezikuar janë fëmijët si kategori e veçantë e shoqërisë sonë.

E drejta për qasje në dokumente publike, megjithëse është e garantuar me Kushtetutë dhe e konkretizuar me ligj, vazhdon të shkelet dhe të mos respektohet nga zyrtarët publikë. Kjo në instancë të fundit nuk do të thotë asgjë tjetër veçse fshehje nga qytetari. E drejta në punë, të drejtat e punëtorëve, zbatimi dhe kontrollimi i Ligjit të punës janë pothuajse inekzistente në sektorin privat, edhe kapacitetet e dedikuara janë në po atë nivel. Ndërsa, për sigurimet shëndetësore nuk ka asnjë lëvizje, kjo paligjësi vazhdon. Një brengë shoqërore e përcjell me neglizhencë institucionale, por me pasoja tragjike vazhdon të mbetet dhuna në familje, e cila kryesisht shfaqet në formën e dhunës brutale fizike ndaj gruas, fëmijëve dhe, gjithnjë e më shpesh, ndaj të moshuarve.

Diskriminimi në baza gjinore vazhdon të jetë plagë e pashëruar, kjo prek thelbin e barazisë shoqërore. Diskriminimi përbën thelbin e pabarazisë sistemore institucionale, jo vetëm në rastet individuale, por më e keqja është se diskriminimi i grupeve dhe shtresave të caktuara shoqërore

vazhdon. Diskriminohen personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta, familjet me fëmijë dhe familjarët e tillë janë veçanërisht të diskriminuar dhe të rrezikuar në qenien e tyre ekonomike. Personat me aftësi të kufizuara diskriminohen në çdo aspekt, infrastrukturë, punësim, ndihma sociale, si dhe në fushat e tjera.

Avokati i Popullit ngre po ashtu edhe rastet të moskorrektësisë dhe diskriminimit nga komisionet mjekësore për vlerësim dhe vendime diskriminuese në këtë drejtim. Po ashtu, në raport vërehet edhe diskriminimi i komuniteteve pakicë, që prek bazën ekzistenciale të tyre dhe sidomos i komuniteteve ashkali, rom e egjiptian, në çdo sferë të jetës ky diskriminim vazhdon të thellohet. Natyrisht, ne jemi të ndërgjegjshëm se diskriminimi institucional është po ashtu, pjesërisht edhe pasojë e kulturës shoqërore, mirëpo ajo që presim është luftimi më energjik, i pakompromis, i diskriminimit sistemor ndaj grupeve dhe shtresave shoqërore që pikërisht për këtë arsye shndërrohen në grupe të marginalizuara.

Grupet e marginalizuara janë pasojë e diskriminimit sistemor institucional dhe jo e kundërta. Prandaj, ne kërkojmë një fokusim sistemor institucional kundër diskriminimit. Sa i përket mekanizmit kombëtar për parandalimin e torturës është për t'u përshëndetur raporti i parë i këtij mekanizmi dhe puna, pa marrë parasysh kualitetin dhe përmbajtjen e rekomandimeve. Mirëpo, ajo që bie në sy në këtë raport është mungesa e një analize edhe ndonjë raporti hetues në lidhje me vdekjet e aktivistëve politikë, vdekjen e dhunshme të Astrit Deharit, si dhe vdekjen e pashpjegueshme të dëshmitarit kryesor që ka qenë bashkëbanues i Astrit Deharit, Naser Makollit, disa muaj, pesë muaj më vonë në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan.

Unë kërkoj që Avokati i Popullit të bëjë hetime të hollësishme në lidhje me këto dy raste dhe të dalë me raporte të veçanta për secilin rast. Po ashtu, në raport vërehet edhe një mungesë, kjo është mungesa e analizës së sjelljeve të Policisë së Kosovës ndaj deputetëve dhe përfaqësuesve të opozitës, kryesisht të Lëvizjes “Vetëvendosje” në tubimet publike, por edhe brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Tash, po u kthehem disa çështjeve procedurale. Botimet e veçanta me përmbledhjen e raporteve me rekomandime nga Avokati i Popullit është për t'u përshëndetur shumë, mirëpo për shkak të ngarkesës së madhe të deputetëve me dokumente për shqyrtim, do të ishte shumë e vlefshme dhe i rekomandoj Avokatit të Popullit që të gjitha rekomandimet e nxjerra nga Avokati i Popullit të botohen në një dokument të veçantë për të pasur një pasqyrë të qartë dhe shqyrtim më të lehtë nga deputetët. Avokati i Popullit me të drejtë ka bërë edhe rekomandimin dhe kërkesën për interpretimin e nenit 72 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas të cilit raporti i Avokatit të Popullit duhet t'i nënshtrohet votimit në Kuvend. Unë e mbështes rekomandimin e Avokatit të Popullit që raporti i Avokatit të Popullit të mos i nënshtrohet miratimit me votim në Kuvend, por të merret obligim që Kuvendi të shqyrtojë hollësisht raportin,

të lejojë Avokatin e Popullit të përgjigjet në të gjitha pyetjet dhe shqetësimet e deputetëve në seanca shqyrtuese.

Po ashtu, kërkoj nga Kuvendi i Kosovës të krijojë një komision ad hoc ose të përhershëm të udhëhequr nga opozita, për çdo rast, për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit brenda periudhës kohore njëvjeçare dhe të informojë Kuvendin dhe Qeverinë me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në seancën e njëjtë, kur shqyrtohet raporti vijues i Avokatit të Popullit.

Është për të ardhur keq gjendja e tashme, në sallën e tashme, interesimi i gjithë Kuvendit, përfshirë edhe Qeverinë e Kosovës, me numrin e njerëzve që janë të interesuar për të drejtat e njeriut dhe për shqyrtimin e një raporti, për të cilin të gjithë deklarohemi se është i dëshmuar, i dokumentuar, profesionalisht shumë i mirë. Po ashtu, është shqetësues fakti se Avokatit të Popullit, si një institucion kredibil, nuk i sigurohet një karrige në sallën e Kuvendit që ai të jetë i gatshëm që, sikurse Qeveria, t'u përgjigjet në kohë reale të gjitha pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga deputetët në bazë të raportit të ofruar për shqyrtim. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Mirjeta Kalludra.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka sjellë para nesh për shqyrtim raportin vjetor për vitin 2016, nëpërmjet të cilit është bërë përshkrimi dhe vlerësimi i situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2016. Mund të themi se është raport i përgatitur mirë sipas standardeve, është mjaft përmbajtjesor, informues, i qartë dhe pasqyron aktivitetin apo punën e këtij institucioni shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Unë konsideroj se është njëri prej raporteve më të mira që kemi pasur për shqyrtim deri më tani. Siç e dimë, Avokati i Popullit, si kategori kushtetuese, në mandatin e tij ka mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.

Andaj, ne si deputetë, duhet ta mbështesim Avokatin e Popullit në përmbushje të këtij misioni nëpërmjet zbatimit apo monitorimit të zbatimit të rekomandimeve që kanë dal nga Avokati i Popullit, edhe përkundër se kemi progres të vazhdueshëm sa i përket zbatimit të rekomandimeve. Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit para Kuvendit të Republikës së Kosovës është një mundësi e mirë që ne si deputetë të njoftohemi nga afër për punën njëvjeçare të tij, ku me anën e këtij raporti njoftohemi në mënyrë të tërthortë për punën dhe shërbimet e autoriteteve publike lidhur me përmbushjen e përgjegjësiave të tyre në raport me qytetarin. Në këtë raport janë prezantuar se janë trajtuar çështje të rëndësishme, si nga aspekti legjislativ, gjyqësor,

ekzekutivit, e gjithashtu edhe problemet e natyrave të tjera, si pronësia, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, liritë fetare në Kosovë, e drejta në punë, e drejta në pronë dhe trashëgimi, e drejta në mbrojtjen shëndetësore, dhuna në familje, si dhe çështjet e mekanizmit për mbrojtje nga torturat e tjera.

Është raport i strukturuar mirë dhe me rekomandime konkrete për institucionet përkatëse. Edhe pse zbatimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, edhe pse ka rritje, ende nuk është në masën e dëshirueshme, në këtë rast institucionet kanë ende shumë punë për të bërë, sepse duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Numri i ankesave të shpallura, të papranueshme nga ana e institucioneve të Avokatit të Popullit, është edhe një sinjal që edhe më tej duhet të vazhdojë të zhvillojë edhe më shumë fusha sensibilizuese, në mënyrë që qytetarët të njoftohen për rolin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit.

Dhe, krejt në fund, unë e përkrah raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe më lejoni, meqenëse është Avokati i pranishëm në Kuvend, ta falënderoj dhe ta përgëzoj në emër të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, pas hetimeve që ka zhvilluar Avokati i Popullit, ku pas ushtrimit të padisë dhe Gjykatës së Apelit, pas Gjykatës Themelore ka vendosur që të pezullohet vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, i cili detyronte qytetarët që nëpërmjet faturave të energjisë të paguajnë për energjinë që nuk e kanë shpenzuar vetë, por që është shpenzuar nga qytetarët e katër komunave veriore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar ministra,

I nderuar Avokat i Popullit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mendoj se forma e raportimit të Avokatit të Popullit duhet të ndryshojë, kjo formë e raportimit përpara se të hyjmë në detaje të raportit ose elementeve të caktuara rreth këtij raporti mendoj që duhet të ndryshojë forma e raportimit, sepse sot po diskutojmë në fund vitit 2017, për raportin vjetor për vitin 2016, një periudhë kohore e cila përfshin shkeljen e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e tyre, adresimin e atyre problemeve nga Avokati i Popullit për vitin 2016 që tani mund të duken edhe të tejkaluara dhe nuk janë adresime në përputhje me kohën dhe me ngjarjet, të cilat kanë ndodhur.

Ne do të donim, personalisht do të doja që Avokatit të Popullit t'i bëhej një ulëse këtu pranë ulëseve të Qeverisë, ose të jetë gjatë raportimit të tij i ulur këtu, një vërejtje që mendoj që mund të jetë teknike edhe për Kuvendin e Kosovës, sepse Avokati i Popullit i ulur atje në ulësen e mysafirëve do të thotë se nuk ka ardhur këtu mysafir, por është raportues për punën e tij dhe për

gjendjen e shkeljes së të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe mendoj se kjo vërejtje duhet të përmirësohet në vitet në vijim.

Te fjala e Avokatit të Popullit që angazhimin e tij e ka në rivendosjen e të drejtave të censuruara, do të thotë të individëve apo cenimin e atyre të drejtave të individëve, mendoj se duhet të përfshihen edhe ato grupe, sepse përveç cenimit të drejtave së individëve, kemi pasur edhe cenime grupe. Po e marr vetëm një shembull që e kam adresuar këtu në Kuvend nëpërmjet debatit për të drejtat e punëtorëve për një shkelje kushtetuese që ka ndodhur nga ana e KEDS-it me largimin kolektiv të 95 punëtorëve nga KEDS-i vitin e kaluar dhe mendoj se do të duhej të ishte pjesë e adresimit edhe të Avokatit të Popullit, sepse kemi pasur një cenim të tillë të të drejtave edhe grupe dhe largime kolektive nga puna që është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Rritja e këtyre adresimeve për 203% është shqetësuese dhe, në vend se kjo të zvogëlohej nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, në veçanti nga institucionet publike, nga viti në vit kjo ka shkuar duke u rritur dhe mendoj që do të duhej të parashihej edhe me masa ndëshkimore në të ardhmen. Në mandatin e kaluar kemi ngritur shqetësimin bashkë me deputeten, kemi bërë debat me deputeten Izmaqi, për të drejtat e punëtorëve, në veçanti kur këto të drejta të punëtorëve shkelen përveç në ndërmarrjet private apo në sektorin privat të të punësuarve, që kemi një abuzim eklatant të drejtave themelore të njeriut, por shkelje të drejtave të njeriut ka edhe në institucionet që janë qeveritare, ndërmarrje publike, institucionet që menaxhohen edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe kjo përbën edhe një shqetësim në vete dhe mendoj se kjo duhet të adresohet.

Nëse flasim për të drejtat e punëtorëve, sigurisht mendja na shkon për ata minatorë që punojnë në horizontin e 11 në Trepçë, a janë të adresuara ato probleme të minatorëve që paguhen nga buxheti i shtetit, po që të drejtat e tyre cenohen edhe në aspektin shëndetësor, sepse nuk u ofrohet shujta ushqimore, sipas kërkesave që duhet të jetë dhe, në veçanti për afatet kohore të tyre të punës dhe mbrojtja dhe siguria në punë, sepse kemi pasur raste të tilla. Kur këto adresime kanë ndodhur edhe nga Inspektorati i Punës dhe pastaj janë heshtur po nga i njëjti Inspektorat i Punës, qoftë për shkeljen e të drejtave të punëtorëve në KEDS, qoftë për ato në Trepçë, atëherë plotësim-ndryshimi i Ligjit për Inspektoratin e Punës, i planifikuar ose i paraparë nga rekomandimet e Avokatit është më se i qëlluar dhe më se i domosdoshëm dhe nevojë, e cila gjithsesi duhet të ndodhë.

Të drejtat e fëmijëve, mbrojtja e tyre, ky është viti i pestë që unë e ngre shqetësimin për çantat e stërngarkuara të fëmijëve dhe kjo ende vazhdon të silltet si e tillë, pa një adresim të qartë të institucioneve përkatëse, qoftë drejtorive të arsimit, qoftë drejtorive përkatëse në kuadër të Ministrisë së Arsimit. Gjithashtu, me konventa ndërkombëtare barazia para ligjit dhe barazia në ofrimin e shërbimeve shëndetësore është e garantuar dhe qytetarëve të Kosovës sot kjo barazi u

mohohet. Po e marr vetëm një shembull. Nëse ndodh që të keni rastësisht sëmundje kardiovaskulare ose të keni një atak të zemrës dikush një qytetar i Republikës së Kosovës dhe ka fatin që ai atak i zemrës ta takojë para orës 3 merr tjetër tretman dhe trajtohet në institucionet publike, por nëse ndodh që atë atak të zemrës ta ketë pas orës 4, procedura ndryshon, procedura ndryshon në thelb, sepse pastaj trajtimi i tyre është nëpërmjet institucioneve private dhe dokumentacioneve që duhet t'i rregullojë nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë. Prandaj, qasja nuk është e njëjtë.

Tek sfondet edhe ndotja e ambientit, e paraqitur drejt në disa pjesë nga Avokati i Popullit, në veçanti për ndotjen e ambientit në kryeqytet dhe në komunën e Obiliqit, por mendoj të menaxhimi i deponive, në veçanti me theks të veçantë i deponisë në Mirash, duhet të adresohet saktë, sepse ujërat e zeza dhe gjendja aktuale në Mirash është si pasojë e keqprojektimit, jo keqmenaxhimit, por e keqprojektimit, ku deponia në Mirash është ndërtuar nën nivelin e lumit Sitnica dhe rrjedhja e ujit atje ka qenë si pasojë e asaj edhe mosizolimit të lumit Sitnica, prandaj në vazhdimësi ka qenë një rrjedhje e ujit dhe një gjendje alarmante e ambientit atje, e paraqitur në të gjitha raportet e ambientit, me adresime të veçanta për zgjidhjen e kësaj dhe për fatin e keq të qytetarëve atje nuk është trajtuar me buxhetin e Republikës së Kosovës, edhe pse është paraparë në projektbuxhetet që do të duhej të ishte i tillë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, nuk është e paraparë dhe mendoj që do të duhej të ishte një adresim i kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa që të planifikohet si investim me interes për qytetarët e komunës së Obiliqit dhe me gjerë. Sepse, kompania për menaxhimin e deponive, e vetmja nga ndërmarrjet publike ka marrë rekomandimet pozitive për menaxhim nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar për menaxhim të suksesshëm dhe përmirësim të gjendjes krahasuar vit pas viti.

Prandaj, mendoj se adresimet do të duhej të ishin të sakta sa i përket kësaj. Në përgjithësi, mendoj se ky raport është i saktë në tërësinë e tij, me vërejtjet që i potencova dhe që duhet të përmirësohet, mendoj që raportimi i Avokatit të Popullit në Kuvend duhet të jetë gjashtëmujor. Raporti të vijë në Kuvend për miratim, por raportimi për të drejtat e njeriut i Avokatit të Popullit duhet të ndryshojë dhe ai të jetë një raportim përpara Kuvendit, me adresime të qarta dhe me mundësinë edhe të diskutimit të këtij raporti, edhe të raportimit të vetë Avokatit të Popullit para deputetëve që kjo të ketë edhe kërshërinë edhe ndjesinë përpara opinionit publik, në veçanti përpara deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht edhe unë e përshëndes raportin e Avokatit të Popullit dhe i mbështes të gjitha ato çka u folën nga kolegët tanë dhe desha të theksoj se Avokati i Popullit është institucion i krijuar nga

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ne të gjithë e dimë qëllimin e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe më lejoni t'ju përkujtoj se ligji ka për qëllim krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve të tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, si dhe krijimin e mekanizmit kombëtar për parandalimin të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë, pa diskriminimin në bazat e mbrojtura nga Ligji për barazi gjinore dhe Ligji për mbrojtje nga diskriminimi. Neni 3, ku flitet për parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, thotë: “Avokati i Popullit është institucion i pavarur që udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Nën dy, dispozitat e këtij ligji zbatohen për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të të gjithë personave në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të autoriteteve publike”.

Të nderuar, e di që i keni të njohura këto, por dua t'i bëj edhe një herë të njohura për publikun, sepse duke pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, angazhimet e tij në sensibilizimin e padrejtësive të shumta ndaj shumë qytetarëve të Republikës së Kosovës që dalin nga papërgjegjësia ligjore kushtetuese, atëherë më duhet të ngre një dilemë dhe një pyetje për Avokatin e Popullit: A ka ndërmarrë ai dhe institucioni i tij që ai drejton ndonjë veprim pas raportimeve të shumta në media për shkeljet ligjore dhe ofendimet e rënda që kanë ndodhur në rastin “Drenica”? Sepse tashmë jemi dëshmitarë dhe asgjë më nuk ka mbet pa u ditur, të paktën nga opinionimi i gjerë, nga mediat dhe raportimet në media sepse rasti “Drenica” do të futet në histori dhe do të lërë gjurmë si rasti më eklatant i padrejtësisë në Kosovë, por tanimë jo vetëm në Kosovë. Kjo do të mbetet si gjurmë e keqe, si gjurmë e turpit edhe për drejtësinë ndërkombëtare, duke ditur se ky problem ose kjo çështje ka qenë dhe mbetet në duart e drejtësisë ndërkombëtare, në këtë rast misionit të EULEX-it në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Përpos që pata qëllim të përgëzoj Avokatin e Popullit për raportin e vitit 2016, qëllim tjetër e kisha jo të kritikoj, po të lusja Avokatin e Popullit që të shpjegojë për komunikimin intern të gjykatësve ndërkombëtarë rreth rastit “Drenica”, por meqenëse parafolësja ime e konsumoi këtë temë, s'më mbetet gjë tjetër vetëm presim komentin e Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit dhe po më vjen mirë që për një kohë të gjatë një femër po i udhëheq seancat e Parlamentit, se po më duket po shkojnë pak më në rregull, se kur po e udhëheqin meshkujt, gjithmonë po i favorizojnë meshkujt. Faleminderit edhe një herë!

Unë po dua të përgëzoj si të gjithë të tjerët Avokatin e Popullit për një raport gjithëpërfshirës dhe përmbajtësor, në të cilën i ka sqaruar shkeljet e të drejtave të njeriut në secilën sektor dhe vërtet tash ne e kemi parasysh dhe e kemi me vetëdije të plotë, e dimë se ku janë shkeljet e të drejtave të njeriut, sipas këtij raporti. Detyrë e deputetëve nuk është veç ngritja e shqetësimeve të tjera, por është edhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, në këtë rast edhe raportit të Avokatit të Popullit, ku gjithsej i kemi 173 rekomandime dhe unë mendoj që këto rekomandime, varësisht prej lëmit, komisionet parlamentare duhet t'i ndajnë punët dhe obligimet dhe të mbikëqyrin sa po implementohen këto rekomandime të dhëna nga Avokati i Popullit.

Ne si Komision Parlamentar për Shëndetësi, para dy ditësh bashkë në Komisionin Parlamentar e kemi trajtuar zbatimin e rekomandimeve të dala nga vlerësimi nacional i të drejtave të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe e kemi parë se prej vitit në vit vërtet ato nuk janë realizuar dhe si komision e kemi marrë obligim që në ditët në vazhdim të bëjmë trysni në organet përgjegjëse për implementimin e këtyre rekomandimeve.

Desha t'i bëj një pyetje, meqenëse kur përfundon debati, Avokati i Popullit do të përgjigjet në pyetje, kërkoj nga Avokati i Popullit një sqarim. E kemi rastin e familjeve të dëshmorëve, të cilët për shkak se gjatë periudhës së luftës iu ka vrrarë një djalë, e ka marrë një pension si familje e dëshmorëve, mirëpo në Qeverinë e kaluar e kemi parë se është bërë një shkelje ligjore, sepse prindi i dëshmorit, nëse e ka marrë edhe pensionin e pleqërisë, është detyruar të zgjedhë mes pensionit të familjes së dëshmorit dhe pensionit të pleqërisë, gjë që unë po mendoj që kjo është një shkelje drastike e të drejtave të njeriut, sepse pensioni i dëshmorit është një pension që jepet për një kontribut të jashtëzakonshëm të familjeve të dëshmorëve për shkak të kontributit që e kanë dhënë, ndërsa, pensioni i pleqërisë është një pension që duhet ta gëzojë çdo i vjetër në Kosovë.

Andaj, ndoshta në fund Avokati i Popullit do të na përgjigjet. Unë mendoj se këto 173 rekomandime duhet të mbikëqyren dhe vërtet prej viti në vit të shihet sa po zbatohen në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti pa grup, zoti Islam Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesuese!

Kolegë të nderuar,

Media,

AKR-ja e ka shqyrtuar këtë raport, sigurisht që ka shumë të meta dhe probleme. Ajo që kisha dashur që ne t'i bëjmë thirrje dhe në të njëjtën kohë të kërkojmë edhe nga Avokati se çka bën me këto shkelje, të cilat i ka identifikuar. Unë e kam trajtuar një çështje rreth konkurseve të arsimit, janë 9 komuna që kanë shkelur ligjin vazhdimisht, apo një kohë të gjatë, çka do të ndodhë me këto çështje? Deri kur ne do të shkojmë me shkelje të ligjit? Pse ne mund të identifikojmë një problem dhe si përfundon ai problem pastaj. Ne qytetarët e Republikës së Kosovës do të jemi të barabartë, t'i gëzojmë të drejtat e barabarta, të mos kemi standarde të dyfishta dhe ta kemi trajtimin e njëjtë të gjithë, pavarësisht ngjyrave politike, për arsye se nëse ne vazhdimisht i ndjekim vetëm ngjyrat politike, Republika e Kosovës asnjëherë s'ka mundësi të shkojë përpara, ta zhvillojë vendin e vet, t'i krijojë kushtet për qytetarët e saj.

Këtu ka shumë probleme, por ajo që ishte shumë e rëndësishme për mua, janë të drejtat e njeriut, të cilat kanë të bëjnë pikërisht me të drejtat e barabarta si qytetarë të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputete Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministrat nuk i paskemi në sallë.

I nderuar Avokat i Popullit,

Natyrisht se edhe unë jam në vazhden e kolegëve deputetë që e vlerësojnë raportin e fundit të Avokatit të Popullit, zotit Jashari, si një raport përmbajtësor lidhur me sfidat dhe përmbushjen e sfidave të institucioneve për t'i përmbushur këto obligime të parapara me ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Dua të ju përgëzoj për përkushtimin institucional që ka treguar dhe po tregon ky institucion për t'u dalë në mbrojtje interesave të qytetarëve të këtij vendi dhe këtë, kolegë të nderuar, e them me shumë përgjegjësi, meqë dua ta adresoj një çështje, që në të kaluarën ky Kuvend ka vendosur që t'ia besojë drejtimin e Institucionit të Avokatit të Popullit si institucion i pavarur, që me Kushtetutë mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e njeriut, atyre që pas përfundimit të mandatit të marrë pikërisht nga ky Kuvend e ndryshuan diskursin e tyre dhe në vend të mbrojtjes, ata u lëshuan në ofendime, u lëshuan në akuza të ulëta ndaj grave ministre.

Kjo për mua përbën shqetësim të madh, të nderuar kolegë deputetë, kur gjuha e ofendimit shkon aq larg sa të fyhet e ofendohet gruaja në politikë nga dikush që e ka marrë legjitimitetin e plotë nga ky Kuvend që të jetë përfaqësues i tyre dhe mbrojtës i të drejtave dhe interesave të

qytetarëve të këtij vendi. Dhe, unë pajtohem me plot të drejtë se në Kosovë ka ende dhunë, ka dhunë në familje, ka ende vrasje të grave që po ndodhin çdo ditë në Republikën e Kosovës, sepse këtë fenomen, të nderuar kolegë deputetë, po e nxitim edhe në gjatë seancave tona, kur diskursi ynë ofendues, poshtërues, ndaj gruas, nënës dhe motrës në Kosovë po merr përmasa të tmerrshme.

Unë besoj që këto shqetësime duhet të adresohen me të drejtë dhe mua më vjen keq nga zoti Jashari që e mora këtë të drejtë të flas, por sinqerisht besoj që personat që e marrin këtë mbështetje dhe legjitimitet nga ky Kuvend duhet ta gëzojnë, në radhë të parë, një integritet të plotë dhe të mos lëshohen në akuza të tilla, siç jemi mësuar t'i shohim në të kaluarën. Do të thotë, ka ende fyerje ndaj gruas në pozita shtetërore, janë bërë traditë tashmë nga politikanët tanë, duke e shpërfaqur kështu edhe realitetin e hidhur, diskursin publik, për përfshirjen e grave në jetën publike. Besoj që Avokati i Popullit si institucion duhet t'i trajtojë me shumë seriozitet këto lëshime që kanë ndodhur, por assesit që politikanët të lëshohen në ofendime të tilla.

Do të ndalem në dy-tri fjalë sa i përket raportit të Avokatit të Popullit. Mendoj që fuqizimi i kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë, në mbështetje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit duhet të jetë prioritet. Besoj që zoti Jashari, por edhe i tërë institucioni, në përgjithësi kanë sjellë rekomandime të qarta dhe të sakta, të cilat ne si institucione duhet t'i marrim me shumë seriozitet.

Fundja, është Raporti i Progresit për Kosovën që në secilin vit na sjell rekomandime, të cilat ne si institucione kemi qenë të obliguar t'i marrim në konsideratë dhe t'i zbatojmë, por që nuk kemi arritur t'i përmbushim në tërësi.

Mendoj se duhet të ketë përkrahje institucionale për rangimin e Avokatit të Popullit si i pari në Ballkan, si institucion me besueshmërinë më të madhe në vitin 2016 në bazë të vlerësimeve të barometrit të Ballkanit, që është mekanizëm i Parlamentit Evropian. Natyrisht që përgëzimet e mia shkojnë për përkushtimin e madh që zoti Jashari po tregon për t'i adresuar të gjitha sfidat dhe kritikën, por gjithsesi besoj shumë që Qeveria do t'i marrë në konsideratë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe t'i adresojë si duhet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! A ua ka përmendur emrin? Të lutem, edhe ti e di, Albulenë. Faleminderit! Fjalën e ka Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje e nderuar kryesuese e Kuvendit!

Kolege deputete,

Kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Është për t'u habitur në çfarë paradoksi jetojmë! Pothuajse të gjithë që e morën fjalën këtu e lavdëruan raportin e shkruar mirë, të përgatitur mirë, të Avokatit të Popullit. Tash, çfarë paradoksi, pra? Diçka që është e përgatitur mirë, por që në përmbajtje ka veç gjëra të këqija. Në përmbajtje të saj ka shkeljen e të të drejtave të njeriut, shkelje të të drejtave të punëtorëve, shkeljen e të të drejtave nga Gjyqësori, shkeljen e të të drejtave të njeriut nga Qeveria, shkeljen e të të drejtave të njeriut nga pothuajse të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, gjykatat, Prokuroria. Të gjitha me radhë!

Pra, e keqja që ndodh çdo ditë në Kosovë e përmbledhur bukur. Çfarë paradoksi!

Do të kisha pasur dëshirë që raporti i Avokatit të Popullit t'i përmbajë tre-katër faqe, hiç më shumë, në të cilat do të thuhej se respektimi i të të drejtave të njeriut në Kosovë është në nivelin e kënaqshëm, në nivelin të cilin duhet ta ketë një vend që aspiron për t'u anëtarësuar në vendet e Bashkimit Evropian. Por, nuk jemi në këtë gjendje. Jemi në atë që e përshkruan raporti. Tash, kur hyn edhe i analizon rastet veç e veç, prapë vijmë te një lajm që dhemb edhe më shumë. Shumica e të gjithë atyre që u janë shkelur të drejtat janë zakonisht njerëz që nuk kanë asnjë fuqi në këtë shoqëri, janë fukarenj, janë njerëz pa mundësi për të kërkuar mbrojtjen e të të drejtave të tyre nëpërmjet rrugëve tjera, qoftë nëpërmjet avokatëve, jo të popullit, po të cilët i paguajnë vetë, qoftë nëpërmjet lidhjeve të ndryshme që funksionojnë zakonisht në shoqëritë në tranzicion, siç jemi ne.

Pra, kjo shëmtia, kjo e keqja, bëhet edhe më e madhe, sepse goditet vetëm një kategori e njerëzve që vërtet janë të pambrojtur në këtë shoqëri, në këtë shtet, në këtë vend. Kjo e bën edhe më të dhembshme, se sikur të ishte kjo shkelje njësoj sikur për atë që ka, sikur për atë që nuk ka, do të thoshim se nuk ka ndonjë qëllim të keq, por thjesht nuk po arrijnë t'i kryejnë detyrat e tyre, qoftë gjykatësit, qoftë prokurorët, qoftë policët në rrugë, qoftë Qeveria, cilido institucion i Republikës së Kosovës. Mirëpo, këtu e shpërfaq edhe atë që e thashë deri më tani, se shkeljet kryesisht po bëhen ndaj atyre që janë të pafuqishëm, nuk kanë mekanizëm tjetër, veçse të shkojnë të raportojnë te Avokati i Popullit që, në esencë, duke marrë parasysh që nuk ka asnjë mekanizëm që Institucioni i Avokatit të Popullit i detyron për t'i respektuar të drejtat, pos të raportojë, qoftë një herë në gjashtë muaj, qoftë një herë në vit, fakti që nuk ka asnjë instrument e bën Institucionin e Avokatit të popullit më shumë institucion raportues, një institucion ku mblidhen ankesat dhe pastaj raportohen në Kuvend, sesa një avokat nëpërmjet të cilit njerëzit kanë ndonjë shpresë, s'po them të gjithë, që ndonjë rast edhe mund të ndikohet për t'u ndihmuar njerëzit, por në përgjithësi më shumë ka një rol vajtues, një rol kur vetëm ngrihen shqetësimet, por mungojnë instrumentet për t'i detyruar institucionet që ta zbatojnë ligjin dhe t'i respektojnë të drejtat konform ligjit.

Ndoshta në të ardhmen, duke pasur parasysh edhe rekomandimet që i ka dhënë Institucioni i Avokatit të Popullit, do të ishte mirë që në kuadër të Ligjit për Avokatin e Popullit të shikohet

mundësia e pajisjes me ndonjë instrument. Nuk jam tash këtu për ta dhënë zgjidhjen, por thjesht për ta dhënë një ide, që institucionet që nuk i zbatojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit të penalizohen nëpërmjet formave të ndryshme, qofshin ata gjykatës, qofshin prokurorë, qofshin ministra ose zëvendësministra, qofshin ministre... kushdo që të jetë, të jetë i detyruar t'i respektojë ligjet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit jo të jenë vetëm në dëshirë për institucionet për të cilat jepen rekomandimet, por të jenë obligative.

Nëse vazhdojmë kështu siç kemi bërë deri në këtë raport, Avokati i Popullit vetëm me këto kompetenca që i ka tani me ligj, e tëra që mund të themi se respektimi i të të drejtave të njeriut në Kosovë është çështje vullneti të cilitdo që e ka në dorë një vendimmarrje. Pra, për të mos mbetur ajo çështje vullneti, sepse ligji nuk është vullnet, ligji është detyrim, prandaj thuhet "sundimi i ligjit", për të pasur mundësi që puna e Avokatit të Popullit të jetë edhe më e dobishme, më produktive, që të shkojë në funksion të përmirësimit çdo ditë e më shumë në respektimin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut sipas Kushtetutës dhe ligjeve, në të ardhmen duhet ta shohim mundësinë që e tëra kjo të mos mbetet vetëm në nivel të kritikave, informatave e rekomandimeve, por edhe e penalizimeve në një të ardhme nëpërmjet së cilës do të përmirësohej edhe më shumë kjo fushë. Kjo nuk mund të bëhet pa amendamentim të ligjit dhe pa i dhënë fuqi edhe më të madhe në këtë drejtim këtij institucioni.

Uroj që raporti i ardhshëm për 2017-ën, 2018-ën, të jenë më keq të përgatitura, por në përmbajtje të jenë më të mira sesa ky që e lavdëruam për formën e përgatitjes, por fatkeqësisht ajo e bukura që fsheh shëmtinë brenda këtyre dy kopertinave të kaltra. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

I respektuar dhe i nderuar Avokat i Popullit dhe gjithë stafi që e përcillni sot seancën, jeni në sallë, apo nuk jeni këtu,

Për mua qenë shumë të rëndësishme informacionet që i mora edhe prej kolegëve deputetë, sepse secili në mënyrën e vet i trajtoi problemet, për të cilat kemi nevojë ne si deputetë që t'i shqyrtojmë, e veçanërisht pjesët që për mua janë shumë të rëndësishme, pjesët sociale, që edhe zoti Haxhiu e përmendi edhe një herë dhe për çështjet për të cilat jemi interesuar bashkërisht, domethënë për problemet dhe të drejtat e punëtorëve në sektorin privat, që për mua është shumë e rëndësishme si temë.

Veçanërisht më lejoni, Avokat i nderuar, të shpreh admirimin tim për gjithë stafin tuaj, për ju, për trajtimin që ua bëni në raport me të gjitha kategoritë, gruas dhe fëmijëve. Mendoj se në vendin tonë ende ka nevojë, sepse kemi problematika, mirëpo unë s'jam këtu pesimiste në këtë

drejtim, sepse ne jemi një shoqëri në ndërtim e sipër dhe e dimë që këto probleme i kanë kaluar të gjitha vendet që kanë kaluar nëpër tranzicione politike e sociale, si vendi ynë.

I nderuar Avokat,

Unë në vend se t'i përmend këto që i dëgjuam prej kolegëve dhe janë konsumuar si tema, por ishin me të vërtetë me interes secili veç e veç. Unë mora informacione për mënyrën se si janë trajtuar. Mendoj se ne do të kemi mundësi që nëpërmjet rekomandimeve si deputetë t'i përcjellim të ngjashmet për t'i trajtuar në sektorët që i mbulojnë, pra në komisionet përkatëse, ashtu siç kemi bërë me Raportin e Progresit, pra mendoj se është një model shumë i mirë, ku ne kemi mundësi në mbledhje, veçanërisht domethënë deputetët që marrin pjesë në komisione, që prekin specifikat e këtij raporti, t'i trajtojmë të gjitha këto rekomandime dhe të dalim sigurisht me një interaktivitet, pse jo edhe në seanca të tjera, jo vetëm në seancën në të cilën diskutohet raporti i Avokatit.

Edhe unë jam pak e dyshimtë nëse ne duhet të votojmë për ose kundër për raporte të tilla, mirëpo ne këtë problematikë nuk e kemi veç me raportin e Avokatit, por e kemi edhe me agjencitë tjera, meqë si Kuvend nuk e kemi një praktikë që penalizojmë nëse ne votojmë për ose kundër një raporti. Mirëpo, sigurisht se i paraprijmë që të ketë përmirësim të performansës së këtyre agjencive.

Unë kam disa propozime. Nëse ju duhen, sigurisht që do t'i përdorë Avokati, nëse jo, atëherë le të mbeten si ide. I nderuar Avokat, mendoj që keni mundësi ende që puna juaj shumë kualitative të përsoset nëse ju bëni pak më shumë bashkëpunim me institucione të tilla, si Policia e Kosovës, Komisioni i Pavarur për Medie. Pastaj konsideroj se ka shumë nevojë që opinionin ende të njoftohet për punën që ju e bëni, sepse jam e sigurt që ka kategori të ndryshme që nuk e dinë se Avokati i Popullit kryen shërbime pa pagesë. Pra, njerëzit hezitojnë dhe nuk dinë as ku të ju gjejnë. Ndoshta është mirë të krijohen edhe ekipe mobile që ju i vizitoni në vende të ndryshme, pse jo, në vende periferike, rurale, po edhe nëpër fabrika, markete, ku ekipi ose pjesë nga stafi juaj mund të diskutojnë me vajzat dhe gratë që neve si deputete shpeshherë na drejtohen për keqpërdorimet që bëhen në raport me punët që i kryejnë në sektorë të veçantë. Pra, kemi edhe punëtorë që trajtohen jo mirë nëpër vendet e tyre të punës.

Unë konsideroj se jo gjithmonë duhet pritur që vetëm me rastin e raportimeve që vijnë nëpër institucione të ndërmermi iniciativa dhe të dilni me deklaratë. Mendoj se duhet pak më shpesh të ju shohim nëpër medie, jo vetëm juve, por edhe stafin tuaj, që të dilni me deklaratë dhe shpeshherë kur shihni se bëhen linçime të ndryshme ndaj personave, ose organizatave, ta merrni fjalën, sepse ju jeni në krye të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vendin tonë dhe ne presim që këtë ta bëni, dhe unë besoj që ju mund ta bëni këtë.

Unë ju falënderoj që me përpikëri i keni përmendur skemat sociale, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e gruas, mirëpo tek e drejta në punë mendoj se duhet edhe një bashkëpunim, pse jo edhe pak më i madh, edhe me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil, sepse këtu e kemi parë që tek ankesat që vijnë, veçanërisht gratë hezitojnë të bëjnë ankesa, gratë që kanë detyra të veçanta dhe kanë detyra si eprore, sepse e dimë që mentaliteti në vendin tonë ende është i tillë, na vjen keq të themi, por sigurisht se burrat kanë përparësi edhe në paga pak më shumë, por edhe në gradime kur vjen fjala, ata depërtojnë shumë më lehtë se gratë.

Meqenëse dëgjuam shumë, unë mendoj se e kemi bërë një vlerësim pozitiv të punës që ju e keni kryer dhe ne presim rezultate të tilla edhe për agjencitë tjera. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi. Nëse shkojmë me replika, atëherë rendin e ka Albulena. Lëre Bekim, të lutem! E keni fjalën, zonja Lirije.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Unë mendova shumëçka të prezantoj, por e thashë edhe nëpërmjet fjalës si përfaqësuese e Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Megjithatë, e shoh në interes ta shtoj edhe një çështje. Nga të gjithë diskutuesit, ne sikur harrojmë se kryeministri është kryesues i grupit ndërmintor për të drejtat e njeriut, që ka obligim të raportojë në Kuvend së paku një herë në vit. Prandaj, mendoj se shumë çështje që i ngritëm këtu janë në obligim për kryeministrin, sidomos brenda kompetencave për rekomandimet që u adresohen qeveritarëve.

Ajo që dua ta them, u pa dhe është pjesë e Ligjit për Avokatin e Popullit, kompetenca e Avokatit edhe për sektorin privat të punësimit, besoj se Avokatit i është dhënë edhe nga instanca, nganjëherë më shumë ndërkombëtare, si vërejtje, se e kalon kompetencën e tij ligjore. Besoj që ai në përfundim na e sqaron këtë.

Është parë shumë e nevojshme që të mbulohet edhe ai sektor, edhe pse kemi Inspektorat të Punës dhe institucione të tjera, megjithatë unë kisha dashur që ai të na e sqarojë këtë, a është brenda kompetencave dhe a mendon se duhet të vazhdohet kështu si është shkruar në ligj? Dhe, një gjë tjetër, që ndoshta është vërejtje për të gjithë ne në Kuvend. Siç e dini, mandati i zëvendës-Avokatëve të Popullit ka kaluar kohë të gjatë, thujse ata e kanë duplikuar mandatin shtesë jashtë afatit dhe duke i parë neglizhencat e tilla, apo defektet që bartin nga jeta politike e Kuvendit, unë kisha propozuar që ndoshta edhe vetë Avokati të vijë me propozimin që përzgjedhjen e zëvendësve ta bëjë ai, pa ia lënë kompetencën Kuvendit, se nuk e ka dhënë shembullin e mirë me të gjitha vonesat e veta.

Besoj, Avokat, edhe këtu do të na ndihmoni se cila do të jetë forma më e mirë, por është parë që është një vërejtje, e cila do të ishte shumë më mirë që ju si institucion i pavarur ta keni përzgjedhjen e stafit përbrenda. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Për replikë, fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu. Një minutë e ke, Bekim!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese, e në veçanti deputete Izmaqi, në veçanti për një bashkëpunim që e kemi pasur për të drejtat e punëtorëve. Jo për të replikuar, por më shumë për të avokuar për të drejtat e punëtorëve, të cilat në veçanti po shkelen në sektorin privat, por edhe për një shkelle të të drejtave që deputetët e Kuvendit të Kosovës, një pjesë e tyre, mund të them ndoshta mbi 50% sot i kanë nga dy pasaporta, ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës nuk mund të lëvizin lirshëm.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës disa kanë pasaporta të Bashkimit Evropian, disa të Shqipërisë, disa të Maqedonisë, disa edhe të Serbisë, dhe me nga dy pasaporta lëvizin lirshëm. Ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës nuk mund të lëvizin lirshëm, sepse e kanë vetëm një pasaportë dhe e kanë një shtet.

Prandaj, mendoj se në Legjislacionin e ardhshëm duhet të parashihet që deputetët e Republikës së Kosovës ta kenë pasaportën vetëm të Republikës së Kosovës, të jenë të barabartë me qytetarët e tyre që i votojnë ata. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Teuta Haxhiu. Urdhëro, deputete!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

E mora fjalën normalisht për një çështje që e ngrehu anëtarja, njëkohësisht nënkryetarja e Komisionit Funkcional për të Drejtat e Njeriut, zonja Kajtazi, e cila tha se kryeministri do të duhej të raportonte një herë në vit. Është e vërtetë, por një vendim i tillë është marrë në Qeverinë Mustafa në vitin 2016 dhe nëse s'gaboj në pjesën e parë të vitit 2016. Është fundi i 2017-tës dhe asnjëherë të vetme nuk e ka parë të arsyeshme ish-kryeministri Mustafa.

Uroj që kjo normalisht të mos ndodhë në këtë Qeveri, por e kemi kërkuar sa herë që të vijë në Kuvend dhe të raportojë kryeministri Mustafa, e edhe përkundër kërkesës së Avokatit që ka ndodhur në vitin e kaluar, kjo asnjëherë nuk ka ndodhë dhe nuk e ka pasur gatishmërinë asnjëherë për të raportuar para Kuvendit për të drejtat e njeriut, pra sa shkelen ato.

Prandaj, unë uroj që të mos përsëritet dhe jam e sigurt që kjo nuk do të ndodhë në këtë Qeveri. Prandaj, është mirë të merren modelet e mira, por në këtë rast nuk kemi për çka të mburremi,

ngase nuk ka ndodhur diçka që është kërkuar edhe nga Avokati, edhe nga një vendim i marrë vet nga ish-kryeministri Mustafa. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Për replikë, fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Desha t'i replikoj deputetit Haxhiu, kur tha se ka deputetë dhe ka qytetarë. Unë jam edhe qytetar i Kosovës, jam edhe deputet, edhe e kam pasaportën e Kosovës, edhe jam kundër demarkacionit. Të tria! Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Kundër-replikë, Bekim Haxhiu, e ke një minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit kryesuese dhe zotit Haradinaj!

Unë nuk e përmenda demarkacionin, unë e përmenda vetëm faktin që deputetët janë të favorizuar në raport me qytetarët, ata që kanë nga dy e tri pasaporta, ndërsa qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë nga një. Do të ishte shumë normale që deputetët ta kishin një pasaportë në momentin që zgjidhen, jo të atillë që kanë pasaporta të Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tjera dhe të lëvizin lirshëm, e kjo s'ka të bëjë fare me demarkacionin.

Është çështje parimore, qytetare, e barazisë përpara të gjithë qytetarëve, e në veçanti para atyre që na kanë votuar. Demarkacionin kur të vijë e trajtojmë, ia japim zgjidhjen që duhet dhe që secili mendon se duhet të ketë zgjidhje të tillë. Nuk është temë demarkacioni në këtë çështje, vetëm për pasaportat, sepse ka deputetë këtu që kanë pasaporta të shteteve të Bashkimit Evropian, të Shqipërisë, të Maqedonisë e të Serbisë, lëvizin lirshëm, ndërsa qytetarët jo.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka Lirije Kajtazi për replikë. Dy minuta i ke!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

Ndoshta edhe më shkurt! Sa për të sqaruar për opinion, unë asnjë moment nuk mendova se ia prishi qejfin koleges sime, Haxhiu, kur thashë se kryeministri duhet të raportojë, aq më tepër që ajo e promovon si një kryeministër të fortë. Ndërsa, rreth asaj nëse është dashur apo s'është dashur zoti Mustafa, ai e ka bërë punën e vet me Këshillin Ndërmnistror që t'i mbledhë nga maji i këtij viti është ngrehur mocioni për Qeverinë Mustafa dhe ai nuk ka qenë në detyrë. Si matematikane që promovohet shpesh, le t'i mbledhë sa kohë ka pasur, a ka kaluar viti dhe të mos e dezinformojë opinionin.

KRYESUESJA: Faleminderit! Enver Hoti e ka fjalën. Urdhëroni, deputet!

ENVER HOTI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Avokatit të Popullit mund të cilësohet se është i strukturuar mirë dhe sjell disa fakte për të dhënat nëpër institucionet tjera. Unë do të ndalem te parashkrimi i lëndëve.

Avokati i Popullit ka vërejtur se ende vazhdohet me parashkrimin e lëndëve edhe në gjykata, edhe në Prokurori. Prandaj, mendoj se ky është një rast shqetësues, sepse nëse i referohemi këtij raporti, kur parashkruhen lëndët, si në procedurë, si në rastet e parashkrimit të ekzekutimit. Për vitin 2015 rezulton se janë të parashkruara 59 126 raste, të cilat Buxhetit të Republikës së Kosovës i kushtojnë mbi 800 mijë euro. Unë do të thosha edhe përtej kësaj, kush janë ato raste që parashkruhen? Cilat janë motivet dhe arsyet dhe a ka një padrejtësi që bëhet për qytetarët në këtë rrafsh? Dhe, unë mendoj se po.

Për më keq, edhe Zyra Disiplinore e Prokurorit Disiplinor nuk i ka hetuar këto raste deri në fund. Mendoj se është një shqetësim që duhet të na shqetësojë të gjithëve që jemi këtu, çfarë po ndodh me barazinë dhe sigurinë juridike për qytetarët e vendit. Kjo është tepër shqetësuese, sepse edhe vazhdon të përsëritet, edhe vazhdon të jetë një numër jashtëzakonisht i madh i lëndëve që parashkruhen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! E kemi kryer me diskutimet. Teuta, sipas Rregullores, edhe ti e di që nuk ke të drejtë. Një minutë e ke Teuta, pas saj Milaim Zeka, dhe e kemi kryer.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare, por sinqerisht është për informim për të gjithë ata dhe për zonjën Lirije.

Domethënë, kur ne kemi thirrur debat ka qenë viti 2017, në prill të 2017-tës. Për t'ia rikujtuar, po flasim për 2016-tën apo 2015-tën, kur është marrë vendim në Qeverinë Mustafa. Debatit parlamentar për rekomandimet e Avokatit të Popullit ka ndodhur tek në prill të 2017-tës. Po flasim për një vit e më shumë që ish-kryeministri Mustafa asnjëherë nuk e ka marrë mundin, edhe përkundër kërkesave tona në Kuvend, por edhe përkundër kërkesës së Avokatit me shkrim që i është drejtuar si kryeministër për të raportuar në Kuvend. Është vendimi, mund t'jua sjell.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Shkojmë me radhë, Milaim Zeka. Urdhëro!

MILAIM ZEKA: Desha t'i replikoj për dy gjëra deputetit Bekim Haxhiu.

E para, ajo është shkelje flagrante e ligjit, sepse nënshtetësinë, varësisht prej shteteve, unë i kam dy nënshtetësi. Kam pasaportë suedeze dhe nuk mund ne t'i shkelim ligjet e një vendi, kur lejon nënshtetësi. Tash mund t'i teket këtu ndonjë deputeti, çohet thotë: “ne që i kemi gratë e huaja”, për shembull, unë të Shqipërisë, “t'i lëshojmë gratë...”

Kështu që, lloj-lloj propozimesh, por para Vitit të Ri ndoshta gjysma e kemi trurin te pushimi, prandaj është mirë të mendojmë pak çka po flasim. Po çka ka lidhje a e ke pasaportën e Suedisë, a të Shqipërisë a...?! Deputetët serbë që janë këtu krejt i kanë pasaportat e Serbisë. Çka na pengon kjo?

Prandaj, Bekimit ia uroj Vitin e Ri, veç në janar që ketë propozime më racionale.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Urdhëroni, deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Shumë shkurt! Çështja që e ngrehu kolegja për debatin parlamentar e kemi parasysh, debati është zhvilluar në Kuvend, e jo në Qeveri, kështu që duhet të dallohet ajo, se pavarësisht sa muaj ka pritur debati, agjendën e Kuvendit e bën Kryesia, e jo kryeministri. Ndërsa, vendimi i kryeministrit Mustafa ka folur për gatishmërinë që ai t'i drejtohet Kuvendit dhe prapë po them, llogaritini muajt deri në kohën kur ai ka qenë në detyrë nuk ka kaluar një vit. Prandaj, besoj se korrektësia i bën nder edhe koleges, edhe mua, dhe gjithsecilit nga ne.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Nëse e dëshiron fjalën Avokati i Popullit?

Për sot e kemi kryer. Për vazhdimin e seancës do të ju njoftojmë. Mirupafshim!

* * *

E enjte, 25 janar 2018

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 14 dhjetor 2017

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Sot po e mbajmë seancën e parë plenare për Sesionin pranveror dhe më lejoni me këtë rast të ju uroj punë të mbarë! Edhe pak ditë na ndajnë nga festimi i dhjetëvjetorit të Pavarësisë sonë. Gjatë këtij rrugëtimi ne kemi pasur shumë suksese, por edhe sfida, të cilat i kemi kaluar së bashku. Uroj që ky vit të jetë vit i vendimeve të mëdha, në interes të shoqërisë dhe qytetarëve tanë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju kisha ftuar që të jeni sa më aktivë dhe t'i përmbushim detyrimet tona ndaj institucionit më të lartë shtetëror dhe qytetar.

Me këtë rast, pasi është fillimi i Sesionit pranveror, i falënderoj edhe gazetarët dhe përfaqësuesit organizatave të shoqërisë civile për bashkëpunimin konstruktiv.

I hap punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Aktualisht në sallë janë 61 deputetë, përkatësisht 62.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, ju njoftojmë me vendimet e Presidentit të Republikës së Kosovës lidhur me zëvendësimin e deputetëve, si në vijim:

Zoti Shemsi Syla, në vend të ish-deputetit Mytaher Haskuka dhe zoti Sali Zyba, në vend të ish-deputetit Qëndron Kastrati. Këto janë zëvendësime që vijnë nga subjekti politik i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Betimi i deputetëve është një veprim i barabartë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit për ta përmbushur këtë detyrim.

Lus deputetët e rinj që të vijnë brenda dhe ta japin betimin.

Të nderuar kolegë deputetë të rinj, pasi ta jepni betimin ju kisha lutur që në bazë të procedurës të ngriheni në këmbë, e dëgjoni tekstin që unë do ta lexoj dhe vetëm në fund e shqiptoni fjalën “Betohe”.

Teksti i deklaratës është ky: “Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe

për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Beto hem!” Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë të rinj ju dëshirojmë mirëseardhje, ju ftoj që ta nënshkruani tekstin e betimit, pastaj atë e ia dorëzoni personalit të Administratës. Urime!

Seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 14 dhjetor 2017, nuk i ka përfunduar të gjitha pikat e rendit të ditës.

Fillojmë me pikat e papërfunduara të rendit të ditës, si në vijim.

5. *Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016*

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 14 dhjetor 2017, po për mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e tij.

Andaj, vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 62 deputetë, 53 për, 7 janë kundër dhe 2 abstenime. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016.

6. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016*

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Lumir Abdixhiku, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e Komisionit.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti vjetor i fundit të kursimeve pensionale të Kosovës për vitin 2016 i është dorëzuar në Kuvend në pajtim me Ligjin për Fondin Pensionale të Kosovës. Si i tillë ai përmban të dhëna për financimin dhe shpenzimet e fondit, investimet, kontribuimet dhe pensionimet.

Pjesë e raportit vjetor është edhe raporti i Auditorit të Pavarur dhe pasqyrat financiare për vitin 2016.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016 dhe ka vlerësuar se mjetet e tij janë investuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës dhe me qëllim të rritjes së fitimit në investim, vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve gjatë investimeve janë marrë parasysht siguria e Fondit Pensional, shumëllojshmëria e investimit, fitimi maksimal në përputhje me sigurinë e Fondit Pensional.

Gjithashtu është mirëmbajtur edhe likuiditeti adekuat, gjë që tregon se edhe performansa pozitive në kthimin e mjeteve të investuara është aty.

Si rrjedhojë, raporti vjetor i fondit përmbush kushtet ligjore për raportim dhe Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë atë.

Meqenëse e kam fjalën, po e shfrytëzoj këtë hapësirë që ta jap edhe mendimin në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

LDK-ja është e kënaqur me mënyrën se si janë menaxhuar 1,4 miliard euro të kursimeve pensionale gjatë vitit 2016, dhe me faktin që janë realizuar 64 milionë euro kthim bruto në investim.

E vlerësojmë investimin e 87% të mjeteve në fonde jashtë Kosovës dhe 13% brenda Kosovës, ndonëse këto të fundit kanë pasur normë më të vogël të kthimit sesa mjetet e investuara jashtë.

Konsiderojmë dhe vlerësojmë se investimet për ekonominë e Kosovës japin siguri më të mirë dhe asistencë financiare të tregut tonë.

Prandaj, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës i japim mbështetje raportit vjetor të fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Mysafirë,

I nderuari ministër,

Këtu para nesh po paraqitet raporti vjetor i fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016 dhe për ata që kanë pasur kohë ta lexojnë, besoj që informacioni në të është edhe i bollshëm, edhe i hollësishëm.

Pra, është i mjaftueshëm për ta vlerësuar punën e këtij institucioni dhe më duhet të them që për këtë saktësi dhe këtë përmbledhje të mirë më duhet ta uroj fondin dhe ata që e kanë përgatitur këtë dokument.

Por, para se të japim vlerësimin sa i përket përmbajtjes dhe jo përgatitjes së dokumentit.

Më duhet këtu, së bashku me ju të ndaj një përvojë interesante që e kisha në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Aty para ca javësh ishte një grup ekspertësh të kontraktuar nga Zyra e Komisionit Evropian, e që ishin në kuadër të Projektit të Binjakëzimit. Pas pyetjeve që kishin deputetët, kuptuam diçka interesante: ekzistimin e mekanizmave sovranë dhe fondeve zhvillimore edhe në kuadër të Bashkimit Evropian. Gjë që për shumë vjet na thuhet që është një politikë, e cila do të ishte joadekuate, në shpërputhje me mekanizmat e ekonomisë së tregut.

Për më shumë, ata na treguan për një numër të madh të ndërmarrjeve strategjike që janë në pronësi publike.

Shembull këtu është EDF-ja franceze, me mbi 80,3% pronësi shtetërore. Për ata që nuk e dinë, EDF-ja është KEDS në Francë, i cili është privatizuar për 26 milionë në Kosovë.

Tutje, aty u shpjegua një shembull që është në Hungari, e që është gjithashtu pjesë e Bashkimit Evropian, për ekzistimin e një banke shtetërore zhvillimore, e cila përkrah ekskluzivisht ndërmarrje që krijojnë bazë industriale, e që është e domosdoshme për zhvillim, punësim e bilanc të mirë tregtar, në këtë rast kjo ishte një bankë zhvillimore shtetërore në kuadër të Bashkimit Evropian.

E për më shumë, na u tha gjithashtu një diçka edhe më interesante, këta ishin kontraktorë të Komisionit Evropian që raportnin në Komisionin e Kuvendit për masat që i merr Bashkimi Evropian për zhvillim ekonomik dhe në kuadër të Projektit të Binjakëzimit. Ata na treguan që në shtetet e Bashkimit Evropian secila veç e veç, pra secili shtet veç e veç, i përkrah edhe me anë të prokurimit publik ndërmarrjet e shteteve amë. Interesant, edhe kjo diçka që nuk është trajtuar asnjëherë në mënyrën e duhur në këtë Republikë.

Për mua këtu janë interesante dy gjëra, e para se si krejt këto politika zhvillimore asnjëherë nuk u menduan nga qeveritë e pasluftës në Kosovë. Ndonëse në Bashkimin Evropian këto janë ekzistente dhe përdoren në mënyrë intensive.

Dhe, e dyta, sipërfaqja të cilën ne si Lëvizje “Vetëvendosje” e kemi kërkuar tash e sa vjet, ndihmë industrive strategjike me anë të fondeve publike apo, në këtë rast, me anë të Fondit të Kursimeve Pensionale, i cili është fond investiv.

Zoti Abdixhiku na foli për shpërndarjen e investimeve që i ka bërë Trusti i Kursimeve Pensionale gjetiu nëpër botë. Dhe, na foli gjithashtu për vlerësimin sa u përket investimeve që janë bërë në Kosovë nga ky fond.

Fondet pensionale, të nderuar qytetarë, janë investitorë institucionalë dhe ata investojnë në industri të cilat krijojnë kthim në investim për kursimtarët.

Pra, sot këtu po e shqyrtojmë këtë raport të Fondit Pensional dhe që të konkretizojmë gjërat në raport të këtij Fondi nga thuhet që ky fond menaxhon me mbi 1,4 miliard euro të kursimeve pensionale të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Prej të cilave diku 8% janë të investuara në Kosovë, kryesisht në bono thesari dhe në depozita bankare, instrumente komplet të thjeshta financiare apo, thënë thjesht, prej 1,4 miliard eurove, 95 milionë euro janë në Kosovë, 1,3 miliard janë në shtetet e tjera.

Për ta shpjeguar, prej këtyre 1,3 miliard eurove, diku 40% janë në shtetet e Bashkuara të Amerikës, 45% janë në BE dhe nga këto investime kthimi për vitin 2016 është 4,4% neto. Pra, në ndërkohë të gjitha qeveritë e pasluftës, po i themi këtyre dy ekonomive të mëdha botërore, SHBA-ve dhe Shteteve të Bashkimit Evropian, ejani investoni në Kosovë, po ja që ne paratë tona, kursimet tona pensionale, fondet tona institucionale po i investojmë te ju dhe kështu po u tregojmë sa e sigurt është ekonomia dhe potenciali zhvillimor e industrial i kësaj Republike.

Thjesht, po u themi: ne paratë tona nuk ia besojmë ekonomisë tonë, ua besojmë juve, e ju investoni te ne. Është këtu një paradoks i çuditshëm.

Gjithashtu këtyre ditëve na është bërë me dije që marrëveshja me “Contour Global” për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re është arritur dhe ministri Lluka e ka bërë publike kontratën, jo të tërën, por një pjesë të madhe. Aty kemi parë që kthimi do të jetë diku 18,5%. Qytetarëve të Kosovës po u themi: ju kënaquni me 4,4% në pensione, derisa atyre investitorëve, ju po u thoni investitorë, sepse janë para publike, po u themi 18,5% kthim.

Këtë kthim ne po ua garantojmë me këtë kontratë, me mekanizma që prekin drejtpërdrejt konsumatorin, pra edhe individual, rezidencial, edhe biznesin. Qytetarëve po ua rrisim çmimin e

rrymës të energjisë elektrike, ndoshta jo menjëherë, po në periudhë besoj 2-3 vjeçare kjo do të reflektohet. Derisa bizneseve po u themi koston fikse po ua ngremë pak, pra edhe më të vështirë po ua bëjmë juve të jeni konkurrues, sepse kjo kosto fikse në prodhim tashmë po rritet, se i kemi thënë “Contour Global”-it 18,5%.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Këtë kthim ne mund t’ia sigurojmë Fondit Pensional, nëse Fondin Pensional nuk e trajtojmë thjesht si një agjenci, e cila menaxhon në mënyrë pasive fondet, kursimet pensionale të qytetarëve, por ndërtojmë rregullore, të cilat në industrinë strategjike i lejojnë Fondit të Kursimeve Pensionale të investojë në termocentrale dhe në industri të tjera, të cilat mund të sjellin rimëkëmbje ekonomike në Republikën e Kosovës.

Në këtë përmbledhje e shihni problemin e kontratës me “Contour Global”, pak jo në tërësi, është e gjatë dhe gjithsesi do ta kritikojmë edhe atë, sepse mendoj që ka probleme të jashtëzakonshme, sidomos me garantimin e cilësisë së qymyrit, sidomos me garantimin e temave të cilat kanë të bëjnë me çmime, e tjera, e tjera, por këto i trajtojmë në tema të tjera.

Pra, ne po paguajmë ndërtimin e një termocentrali nga paratë tona për fitim të huaj, e fitim ky, i cili po t’i garantohej Fondit Pensional do të ishte edhe më i mirë, por nuk do të ishte 4,4% neto dhe në këtë formë edhe do të ruanim dorën e shtetit në aset strategjik, edhe do të rritnim kursimet pensionale, edhe do të silleshim si shtet, i cili beson në potencialin ekonomik të kësaj Republike.

Pra, krejt këto duhet dhe mund t’i bëjmë vetëm nëse e trajtojmë Fondin Pensional si investitor institucional dhe jo si menaxhues pasiv i mjeteve, ashtu siç na paraqitet në këtë raport para nesh.

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Ky raport vetëm sa shpërfaq në saktësi dhe pa ekuivoqe që tash Kosova ndonëse ka fonde, ende vazhdon të sillet në politikëbërje si shtet i varfër.

Në gjithë botën fondet pensionale janë investitorët më të mëdhenj institucionalë në ekonomitë e tyre dhe jo në gjithë botën, po edhe në rajon, në Maqedoni, Kroaci, Slloveni, gjithandej ku ka fonde të tilla, këta janë investitorët më të mëdhenj institucionalë dhe në ekonomitë e tyre.

Ndërsa në Kosovë Fondi është shndërruar në menaxhues pasiv të mjeteve, në dobi të ekonomive të huaja, ndonëse mundësi të mira investimi ka edhe në Kosovë. Rasti i termocentralit Kosova e Re është edhe shembull, edhe mundësi, edhe rasti, edhe momenti. Por ja që për këtë na duhet një Qeveri, e cila e ka guximin që të trajtojë Fondin e Kursimeve Pensionale si investitor

institucional, e jo si menaxhues i kursimeve pensionale që garanton kthim minimal në investime dhe nuk trajton ekonominë e vendit si potencial e mundësi për zhvillim.

Ju faleminderit dhe Lëvizja “Vetëvendosje” do ta përkrahë raportin për saktësinë dhe jo për përmbajtjen.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016 dhe ka ardhur në konstatimin se raporti është përmbajtjesor, përmban të gjitha të dhënat, të cilat janë paraparë me Ligjin për Fondin e Kursimeve Pensionale.

Nga raporti vërejmë se Fondi i Kursimeve Pensionale ka pasur në menaxhim mjete neto në fund të vitit një miliard e 417 milionë euro, që krahasuar me vitin e kaluar ka pasur rritje të mjeteve për 10,2%.

Mjetet në menaxhim të Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2016 përbëjnë 23,7% të bruto produktit vendor, krahasuar me 21,3%, sa kanë qenë në vitin 2015.

Sipas raportit, gjatë vitit 2016 ka pasur kthim pozitiv nga investimet bruto për 64,56 milionë euro, apo kthimi neto për 4,4% të çmimit të njësisë.

Gjatë vitit 2016, në Fondin e Kursimeve Pensionale kanë kontribuar 312 mijë e 672 kontributdhënës, që krahasuar me vitin 2015 ka pasur rritje për 5,1%.

Nëse shikojmë demografinë e kontributdhënësve, vërejmë se 70% të kontributdhënësve janë meshkuj, kurse vetëm 30% të kontributdhënësve janë femra, çka do të thotë se ka një diferencë të madhe të të punësuarve kontributdhënës në mes të femrave dhe meshkujve të punësuar. Mbetet obligim i qeverisë t’i rishikojë politikat e punësimit, përmes të cilave do të krijohet mundësia për uljen e një difference të tillë në mes të të punësuarve.

Qeveria duhet të ketë politika stimuluese për punësimin e grave dhe vajzave, por edhe të kategorive të marginalizuara në shoqërinë tonë, përmes këtyre politikave të krijohen mundësi për rritjen e numrit të të punësuarve.

Nga raporti shohim se gjatë vitit 2016 ka pasur 34 mijë e 18 kontributdhënës të rinj, që është numri i vogël krahasuar me numrin e madh të papunëve që mbizotëron në vendin tonë.

Në Fondin e Kursimeve Pensionale ka trend të rënies së kontributeve të paalokuara, por ende ka mjete të paalokuara prej 9,45 milionë, për çka janë dëmtuar kontributdhënësit.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës gjatë vitit ka investuar në tregjet financiare globale 87% të mjeteve nën menaxhim, kurse në tregun vendor ka plasuar 74 milionë euro, me një kthim bruto prej 3,4%.

Prej këtyre mjeteve, 20 milionë i ka plasuar në depozitat me afat në tri bankat vendëse dhe 54 milionë në Thesarin e shtetit.

Këtij raporti po ashtu i është bashkangjitur edhe raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare, sipas të cilave vërehen se pasqyrat financiare janë të përgatitura në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratimin e raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës fjalën e ka deputeti Blerim Kuçi. Urdhëro, Blerim!

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar me kujdes të veçantë raportin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

Duke e ditur se ky fond është i rëndësisë së veçantë, si nga madhësia, me vlerën sot rreth 1.6 miliard euro, ose më saktë në fund të vitit 2016, sipas këtij raporti, është një miliard e 417 milionë e 970 mijë e 874 euro, jo më pak se 23% e GDP-së së Kosovës.

Po ashtu për nga rëndësia apo lidhja direkte me interesat e qytetarëve, mbi 500 mijë qytetarë janë të lidhur me këtë fond, ose saktësisht deri në fund të vitit 2016, 541 mijë e 923 qytetarë janë kontribuues të këtij fondi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, ne si grup parlamentar jemi fokusuar me theks të veçantë në kapitujt ose pjesë të raportit që kanë të bëjnë me:

1. Investimet e kursimeve pensionale dhe kthimi i investimeve, ku pothuajse i tërë fondi është investuar jashtë vendit dhe kthimi neto në formë të rritjes së fondit për vitin 2016 është 4.4%.
2. Kontribuimi dhe pensionimet që janë mjete të arkëtuara gjithsej një miliard e 266 milionë.
3. Siguria e këtij fondit, e sidomos gjendja e sigurisë, e paraqitur në grafikun e ashtuquajtur ‘çmimi i njësisë’, prej themelimit.

Po ashtu jemi të fokusuar edhe te pjesa ligjore të deklaratës së parimeve dhe politikave të reja investuese të vendosura në vitin 2014, që është së pari të ruajë dhe së dyti të rrisë kapitalin e investuesve.

Dhe, në përfundim të këtij deklarimi dhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës ne do ta miratojmë këtë raport dhe vlerësimi ynë që raporti i Fondit të Kursimeve të vitit 2016 është i përgatitur shumë mirë, me një tërheqje të veçantë të vëmendjes për sigurinë e këtij fondi, tani dhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, deputeti Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

“Nisma” e ka trajtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016 dhe e mbështet plotësisht, edhe sigurinë, edhe ruajtjen e atij kapitali dhe njëkohësisht i bën thirrje Qeverisë që të merren hapa konkretë që këto investime të kthehen në vend, sepse janë në interes të qytetarëve dhe sigurisht do të shtohet vlera e tyre. Po ashtu, ne do ta miratojmë dhe e përkrahim.

Mirëpo, gjithmonë qëndrojmë në thirrjen se investimet duhet të kthehen brenda, sepse janë të qytetarëve të Kosovës. faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Albert Kinolli, në emër të Grupit “6+”.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016 dhe ne si të tillë e miratojmë dhe do të votojmë për këtë rekomandim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina, Shqipja nuk është, po e vazhdojmë. Deputeti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Kolegë,

Përshëndetje, media,

Kor diplomatik,

Aleanca Kosova e Re e ka shqyrtuar këtë pikë dhe duke marrë parasysh se Aleanca Kosova e Re interesohet për investimin e parasë publike, po edhe ato të bizneseve, thithjen e investimeve, ka dëshirë që të bëjë thirrje që të shqyrtohet dhe të gjendet mënyra e mundshme që Fondi i Trustit Pensional të kthehet në Kosovë dhe të bëhen investime.

Me të vërtetë është pak vështirë që ne të deklarohejmë apo të vijmë deri te ajo që ne nuk jemi vend i sigurt për mbajtjen e parasë sonë, por po u bëjmë thirrje të tjerëve.

Megjithatë, AKR-ja do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, Valentinë!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Sapo hyni në Agjencinë Kundër Korrupsionit, zgjidhni vitin 2017, rubrikën ‘institucionet e pavarura’, pastaj shtypni mbi Fondin e Kursimeve Pensionale, do t’ju dalin tetë emra e mbiemra të Fondit të Kursimeve Pensionale në pozitën e drejtuesit menaxhues, zëvendës drejtorit dhe anëtarëve të Bordit.

Nëse klikoni në formularin e deklarimeve të pasurisë të drejtorit menaxhues të Fondit të Kursimeve Pensionale, te kolona ‘paga dhe mëditje’, si të hyra vjetore, shuma neto është rreth 61 mijë euro.

Po nuk mjafton vetëm paga astronomike e drejtorit menaxhues, por edhe zëvendës drejtori, rreth 40 mijë euro të hyra vjetore, si paga dhe shtesa të tjera të regjistruara.

Pastaj, tronditja vazhdon me pagat e anëtarëve të Bordit. Për shembull, anëtari i parë i Bordit rreth 17 mijë euro si të hyra vjetore i merr nga Fondi i Kursimeve Pensionale, ndërsa rreth 6 000 euro të hyra vjetore nga Ministria e Financave.

Të nderuara deputetë,

Është lakuar herë pas here kjo temë në opinionin publik, por asnjëherë nuk është adresuar ky nivel i pagës super të lartë në organet përgjegjëse për t'i ndryshuar ato.

Pozita e drejtorit menaxhues, e zëvendës-drejtorit apo edhe e anëtarëve të Bordit, pavarësisht se janë pozita me përgjegjësi të larta, nuk mund të arsyetohet në rrethana të Kosovës të jetë në këtë nivel rroga apo koeficienti i tyre.

Është e papranueshme me shifrën zyrtare prej 30% papunësi në Kosovë, me papunësinë ekstreme të grave, me pagën minimale në Kosovë që nuk arrin as 200 euro në muaj.

Nuk është normale as për një taksist që punon me përqindje dhe mezi arrin 250 euro një pagë mujore.

Nuk është normale një pagë e lirë që e kalon dyfishin e pagës së Presidentit të vendit, gati dyfishin sa paga e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila për mendimin tonë është përgjegjësi ndoshta më e madhe se e krejt të tjerëve, për shkak të ndjeshmërisë të interpretimit objektiv, me që një interpretim i gabuar kushtetues rrënon edhe themelet e shtetit.

Të nderuara deputete dhe ju deputetë,

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, pavarësisht se brenda emrit të vet mban edhe një fjalë me rëndësi, “kursimet”, do të duhej të ishte shembull për të tjerët se si duhet të kursehet, ndërsa kanë paga shumë të larta.

Pagat e punonjësve të këtij fondi duhet të nivelohen, ose të paktën të përgjysmohen, sepse kjo është simbolika më e madhe e pabarazisë dhe pagave absurde në vendin tonë.

Nuk mund të mbetet kjo çështje më vetëm në nivel raportimi mediatik, por të bie shumë më poshtë nga organet përgjegjëse sipas ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse kjo është hera e vetme kur ne mund të diskutojmë për pensionet në përgjithësi dhe aktivitetet e Trustit në veçanti, unë më shumë dua të ngre një shqetësim, i cili është shqetësim i

pensionistëve, gjegjësisht atyre që kanë arritur moshën që mund t'i përfitojnë mbrapa fondet, të cilat i kanë kursyer gjatë kohës sa kanë punuar.

Kanë qenë dy probleme me të cilat Trusti ua ka vështirësuar këtyre kontributdhënësve në të kaluarën, e tani që i tërheqin paratë e tyre.

E para, sepse vetëm një bankë ka qenë e licencuar, nëpërmjet së cilës pensionistët kanë mundur t'i tërheqin paratë e tyre.

Unë po shpresoj se ky problem tashmë është zgjidhur, sepse në herën e fundit, pothuajse dy vjet u bënë tashmë, Bordi kur ka raportuar në komision pati thënë se kanë hapur tender që edhe bankat e tjera të mund t'i ofrojnë këto shërbime për pensionistët. Nuk po shoh në raport nëse kjo çështje tashmë është zgjidhur.

Por është një problem tjetër, të cilin Bordi i Trustit duhet ta adresojë, e ai është shuma minimale, të cilën një pensionist apo një ish-kontributdhënës e që tani ka arritur moshën për të tërhequr kursimet e tyre, e ka vënë Bordin, e ai është lartësia e shumës minimale, do të thotë 170 euro, përderisa shumë nga këta pensionistë janë të interesuar që kjo shumë të jetë më e vogël, sepse duan që atë ta gëzojnë sa më gjatë, pasi që nga Trusti ata mund të tërheqin vetëm aq para sa kanë kursyer.

Për më tepër, kjo bëhet dhe shpeshherë kjo shumë ka arritur 200 apo 250, edhe pa dëshirën e pensionistëve, sepse pastaj mbi këtë shumë ata duhet edhe të paguajnë tatim.

Unë e kuptoj se në momentin kur këto para ndahen për t'u dërguar te Fondi i Kursimeve, nuk ndalet tatimi mbi të ardhurat personale, por po bëjmë fjalë për pensione. Janë njerëz me të hyra shumë më të larta, janë biznese me qarkullime milionëshe që nuk paguajnë tatim, ndonëse e bëjnë jashtëligjshëm, natyrisht, duke iu shmangur tatimeve dhe mendoj se ne duhet të gjejmë një mënyrë që këta pensionistë t'i lirojmë nga tatimi, sepse edhe ashtu shuma që përfiton shteti nga ta është tejet e vogël, bëhet fjalë për nga 5 apo 10 euro për secilin pensionist, por për një pensionist, i cili varet nga ato 170 euro apo edhe më pak, edhe këto 5 euro janë tejet shumë, i bie diku të jetë gati 15% e të hyrave të tyre.

Pra, unë i kërkoj Bordit të Trustit që t'i shqyrtojë edhe një herë këto vendime dhe Bankës Qendrore të Kosovës, e cila e mbikëqyr Trustin, por edhe bankat, që të gjejë mundësinë që këta pensionistë të lirohen nga të gjitha këto pagesa administrative që për mendimin tim janë të panevojshme, të cilët janë të detyruar t'i paguajnë ndaj bankave të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Faton Topalli dhe unë nuk shoh që ka të tjerë deputetë të paraqitur për këtë pikë të rendit të ditës. Urdhëro, Faton!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Së paku prej vitit 2013 i kam përcjellë vazhdimisht raportet e Fondit të Kursimeve Pensionale dhe mund të them që gjatë të gjitha këtyre viteve nuk ka asnjë ndryshim, përveç ndryshimit në shifra, respektivisht një rritjeje të vogël të fondit nga viti në vit, por asnjë ndryshim sa u përket politikave.

Natyrisht, që raporti i Fondit të Kursimeve Pensionale është korrekt sa i përket prezantimit të shifrave. Shifrat janë korrekte, por ajo çka nuk është korrekte në këtë raport dhe në përgjithësi në punën e fondit janë politikat, të cilat janë duke u zhvilluar. Pra, ne po diskutojmë prej vitit në vit të njëjtat raporte dhe po flasim njësoj për të njëjtat politika, flasim për investimet të cilat janë duke u bërë jashtë Kosovës, e që ne kemi kërkuar vazhdimisht të bëhen brenda Kosovës. Arsyeja e sjelljes së Fondit Pensional, respektivisht mënyra se si menaxhohen këto mjete ka shumë të bëjë me rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës. Në njëfarë mënyre, e ndiej veten të turpëruar si deputet, përkundër faktit që jemi të vetëdijshëm që Banka Qendrore e Kosovës dhe Fondi Pensional varen nga Kuvendi i Kosovës dhe nga angazhimi i neve si deputetë. Megjithatë, deri më tash nuk kemi bërë asnjë ndryshim dhe nuk kemi bërë asnjë kërkesë përmbajtjesore që këto politika të ndryshojnë. Edhe sot ne u ankuam që po investohen paratë jashtë vendit, që po krijojmë faktikisht vende të punës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Shtetet e Bashkimit Evropian, po i ndihmojmë ekonomitë e këtyre vendeve të zhvillohen, ndërsa më pak se 10% e këtij fondi ne i shpenzojmë në Kosovë, respektivisht i përdorim për investime në Kosovë, që janë investime shumë të vogla.

Për të mos qarë me lot krokodili për Fondin Pensional të Kosovës, në qoftë se vërtet dëshirojmë që ky fond të përdoret për zhvillim ekonomik, në qoftë se dëshirojmë vërtet që vitin e ardhshëm, kur ta diskutojmë raportin të shohim që këto mjete janë investuar në Kosovë, ku ka mundësi jashtëzakonisht të mëdha për t'u bërë investime, atëherë duhet t'i ndryshojmë politikat tona, respektivisht duhet t'i ndryshojmë rregulloret e BQK-së që përcaktojnë mënyrën se si do të investohen këto mjete. Pra, nuk është Fondi Pensional ai, i cili ka gabimin kryesor për këtë çështje, po ashtu dhe Banka Qendrore e Kosovës, e cila me rregulloret e veta, të cilat i ka krijuar kështu, nuk lejon që ky fond t'i përdorë mjetet për investime brenda Kosovës.

Unë ju ftoj juve si deputetë, por edhe si Qeveri, por edhe komisionet përkatëse që të angazhohemi për t'i ndryshuar rregulloret e BQK-së. Ne të gjithë së bashku, në mënyrë që këto mjete të investohen në Kosovë që të mos vijë puna që edhe në raportin e vitit kur do ta diskutojmë raportin e vitit 2018 të ankohemi prapë që këto mjete nuk janë investuar në Kosovë e politikat e tilla të vazhdojnë edhe më tutje. Pra, përgjegjësia nuk është tash as te BQK-ja, as te

Fondi Pensional, por është te ne si deputetë, si Qeveri, se si do ta bëjmë këtë ndryshim që këto mjete pastaj të përdoren vërtet për investime në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për fjalë është paraqitur edhe deputetja Teuta Haxhiu. E keni fjalën, zonja Teuta!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Derisa ne po flasim për raportin vjetor të Trustit të vitit 2016, normalisht që secili prej qytetarëve që dëgjon diskutimet e deputetëve, vërtet shqetësohet, por mbi të gjitha jemi të shqetësuar edhe ne. Por, të ndalemi njëherë e përgjithmonë si Kuvend, si deputetë, në momentet e caktuara, meqë këto janë institucione të themeluara nga Kuvendi dhe vërtet nëse flitet për një fond shumë të madh, për të cilin domethënë gati të gjitha diskutimet po flasin që janë të shqetësuar dhe vërtet jemi të shqetësuar, edhe unë si deputete jam e shqetësuar për sigurinë e këtij fondi, derisa ne si deputetë do të duhej të punojmë në momentet e caktuara, dhe gjatë miratimit të këtyre raporteve, raporte të këtyre institucioneve të themeluara nga Kuvendi që shumë herë edhe raportet që nuk janë miratuar apo edhe janë miratuar, në njëfarë forme asnjëherë nuk janë marrë parasysh nga Kuvendi, edhe nëse nuk miratohen.

Po flasim në njërin anë që raporti është shumë i mirë, por ka edhe diskutime për rritje pagash, në fakt, për pagën shumë të lartë. Në fakt, më shqetësuese për mua është jo vetëm paga shumë e lartë e anëtarëve të bordit që vërtet është diçka që secili qytetar e ka të drejtën të mendojë se përderisa paga minimale në Kosovë nuk është në nivelin se si ishte dashur të ishte për secilin të punësuar në vend, por megjithatë më shqetësuese është se çfarë ndodh me këtë fond dhe ku e kemi siguruar ne këtë fond. Pra, e kemi dërguar diku, ku ne po flasim për pasigurinë e këtij fondi. Atëherë, kush mund të vendosë pos deputetëve, pos këtij Kuvendi dhe të definojmë, pra të japim mendime në momentet e duhura që ky fond të jetë pjesë ndihmëse e buxhetit të Kosovës, si një stabilitet të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Andaj, të gjitha obligimet i takojnë Kuvendit, neve si deputetë, që këto institucione, për të cilat shumë herë po kemi shumë shqetësime si Kuvend, i kemi themeluar vetë si Kuvend, i monitorojmë dhe në fund po dalim edhe po ankohe mi. Sinqerisht shumë shqetësuese është mossiguria e këtij fondi. Andaj, të nderuar kolegë deputetë, të gjithë jemi të shqetësuar, por pikërisht ne si Kuvend jemi ata, të cilët do të duhej të punojmë, në mënyrë që edhe kur ka raporte që miratohen apo nuk po miratohen, është e njëjta logjikë. Askush nuk po jep llogari, sado që shqetësuese është pikërisht edhe politizimi i skajshëm i këtyre agjencive a i këtyre bordeve që po ndodh pikërisht prej Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për fjalën, lus përfaqësuesit e Qeverisë nëse duan fjalën? Jo! Atëherë, e vazhdojmë procesin e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Në sallë janë 70 deputetë, atëherë unë edhe një herë lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

A ka deputetë pa kartelë?

Meqë kanë votuar vetëm 60 deputetë, do të thotë s'ka pasur kuorum, unë po kërkoj që të përsëritet edhe një herë procesi i votimit.

Atëherë, edhe një herë lus administratën që të konstatojë kuorumi. 69 deputetë janë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët që të bëhen gati për votim, votojmë tani.

A ka deputetë pa kartelë? Jo!

Atëherë, kanë marrë pjesë në votim 68 deputetë, për kanë votuar 67.

Asnjë kundër, një abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016. Faleminderit!

7. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Lumir Abdixhiku, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin e komisionit. Urdhëro, Lumir!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Para se të nis raportin të qartësoj se komentet e bëra për pagat e Trustit Pensional vlejné për këtë pikë të rendit të ditës, jo për pikën paraprake. Fondi i Kursimeve Pensionale për vitin 2018 i ka propozuar Kuvendit miratimin e dy taksave: Taksën operacionale në vlerë prej 0,071%. Pra, i ka kërkuar 1,3 milion euro për shpenzime operacionale për vitin 2018, për paga të veta, për shërbime e mallra, e të tjera. Dhe, i ka kërkuar taksë investimeve në vlerë prej 0,381, ose 5,8 milionë euro para, që shërbejnë për fondet dhe aktivitetet investive.

Shpenzimet investive janë të lidhura me kosto që ngarkojné menaxhuesit e fondeve të investimeve apo asetmenaxherët, përmes të cilëve fondi investon mjetet pensionale. Fondi ka planifikuar që mjetet të investojë nga asetmenaxherët e ndryshëm nëpër botë, ndërkaq shpenzimet operacionale janë të lidhura me aktivitetet e brendshme të Trustit. Pra, Fondi ka planifikuar ta fillojë vitin 2018, këtë vit, me 1 miliard e 611 milionë euro dhe kthimin e investimeve ta ketë 3% prej kësaj vlere. Kontributet shtesë do të jenë 144 milionë euro, ndërkaq tërheqjet e kursimeve parashihen të jenë 26,4 milionë euro. Tash, komisioni e ka shqyrtuar

kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale dhe në mënyrë unanime, me përfaqësuesit e të gjitha partive politike, ka konsideruar se taksa operationale, ndonëse këtë vit është më e ulët, vazhdon të jetë e padrejtë sa i përket kompensimit të pagave dhe benefiteve që udhëheqësit e Trustit i marrin.

Meqenëse këtë vit kemi qenë vonë me kohë për të ndërmarrë një masë adekuate, ne kemi paraparë që gjatë vitit 2018, si komision të ndërtojmë një grup punues, i cili do të bëjë nivelimin e kostove dhe pagave të Trustit Pensional me Bankën Qendrore të Kosovës dhe këtë propozim do t'ia prezantoj Kuvendit këtë vit, pra në vitin 2018. Prandaj, si komision ndonëse konsiderojmë që taksa është e lartë, të themi që koha për të cilën kemi qenë të angazhuar, të gjithë anëtarët e komisionit, të të gjitha partive politike, ka qenë e shkurtër dhe si komision ju kërkujmë së paku një vit që të sjellim një skemë të re dhe të niveلوjmë pagat e Trustit për vitin 2018. Ju rekomandojmë që këtë taksë të sivjetme ta aprovoni dhe të na jepni kohë brenda një viti që të zgjidhim këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani sipas radhës fjalën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Së pari, përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Ismajl Kurteshi.

Dardan Sejdiu e ka fjalën. Urdhëro!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Përfaqësues të mediave,

E para, më duhet të përshëndes iniciativën e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të trajtojë temën e taksës operationale dhe me anë të këtij trajtimi të sigurohem që shpërblimi për punën që e bën Trusti apo stafi në Fondin e Kursimeve Pensionale të jetë adekuat me përgjegjësitë që i ka.

Unë do të mundohem, meqë vij prej industrisë financiare, që për qytetarët e Republikës të sqaroj llojin e punës që e ka stafi i Fondit të Kursimeve Pensionale, në mënyrë që të kuptojmë se si menaxhohen kursimet pensionale. Zoti Abdixhiku i përmendi menaxherët e mjeteve. Menaxherët e mjeteve apo asetmenaxherët janë kompani të kontraktuara, të cilat paguhen me taksën tjetër. Kjo taksë akumulon një shumë të caktuar vjetore dhe ky është shpërblimi që ne si Republikë, si fond u japim menaxherëve të mjeteve për kthimin në investim që na sigurojnë me anë të investimit të kursimeve pensionale në tregjet ndërkombëtare, kryesisht në SHBA dhe në Bashkimin Evropian.

Pra, kjo taksa për menaxhimin e mjeteve, e që këtu po propozohet të jetë 0,381%. Pra, 0,3% në baza vjetore. Dhe, kjo taksë zbritet nga totali i mjeteve të investuara dhe me këto para ne i paguajmë këta menaxherë të mjeteve. Mendoj se kjo taksë është më e ulëta për menaxherë të mjeteve dhe kjo faktohet në rajon, e që besa edhe më gjerë. Arsyeja pse është kështu, është sepse në Kosovë është marrë vendim që të kemi vetëm një Fond të Kursimeve Pensionale, pra të kemi monopol në tregun e kursimeve pensionale dhe ky vendim është i diskutueshëm, mund të jetë i mirë apo jo, por ky është vendimi që e kemi marrë.

Ajo për të cilën unë dua të diskutoj është taksa operacionale. Pra, nëse Bordi i Kursimeve Pensionale, Bordi i Fondit të Kursimeve Pensionale kontraktton menaxherë të mjeteve, atëherë stafi i Fondit të Kursimeve Pensionale, pra drejtori, zëvendës drejtorët dhe stafi bëjnë administrim të një softueri, administrojnë softuer. Një pjesë të madhe të punës e bën Administrata Tatimore e Kosovës, pjesa tjetër është rekonsilimi, apo barazimi i kontributeve me llogaritë individuale, llogaritë e qytetarëve të Republikës dhe për këtë punë ne i ndajmë një shumë, të cilën zoti Abdixhiku e prezantoi.

Mendoj që po të kishim menaxhimet në Trustin e Kursimeve Pensionale, i cili do të merrej me menaxhim aktiv të kursimeve pensionale, atëherë ka edhe kuptim shpërblimi me të cilin ne i paguajmë, pra pagat e këtyre njerëzve. Pra, nëse menaxhmenti i Fondit të Kursimeve Pensionale prezanton ide, menaxhim aktiv, merret me menaxhim të fondeve, ka kuptim pagë prej 6-7 mijë eurosh. Por, nëse vetëm se administrojmë një llogari, atëherë cila është logjika, cila është logjika që ne të kemi taksë operacionale të kësaj natyre, e posaçërisht në kontekst ekonomik, ku kemi monopol në kursime pensionale. Pra, treg i garantuar, punën operacionale e bën Administrata Tatimore e Kosovës, punën e investimeve e bëjnë menaxherët e mjeteve të cilët i paguajmë dhe punën komplet teknike administrative e paguajmë në shumë prej 1,5 milion euro në vit. A ishte kështu, zoti Abdixhiku?

Pra, mendoj që ky komision të cilin po e propozon zoti Abdixhiku është edhe me vend, edhe i domosdoshëm, nëse vendoset nga ky Kuvend që të mos ndërrohet sistemi në aspektin e konkurruesve në shtyllën e dytë të kursimeve pensionale. Pra, nëse duam që vetëm fondi të jetë ai i cili menaxhon me kursime pensionale, atëherë na duhet që në mënyrë serioze t'i qasemi taksës operacionale dhe të merremi me këtë temë. Gjithashtu, më duhet të potencoj që menaxherët e mjeteve, të cilët e kanë këtë taksë investive, e kanë të tillë dhe të ulët për faktin që bëjnë menaxhim pasiv të mjeteve, pra investojnë në produkte, të cilat janë kombinim i shumë asetëve,... dhe këto paraqesin rrezikshmëri të ulët, pra në frymën e kursimeve që të mos investohet në diçka që mund të paraqesë rrezik. Por, gjithsesi e kemi të njëjtin portofolio, të njëjtin lloj të investimeve tash e tetë vjet. Nëse e merrni raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale dhe e analizoni, do të shihni se nuk ka ndërruar asgjë në portofolion e Trustit të Kursimeve Pensionale tash e tetë vjet, në të njëjtat instrumente financiare këta menaxherë të mjeteve investojnë, në të njëjtat mënyra, në të njëjtat periudha dhe për këtë arsye s'ka kuptim të

paguajmë më shumë, sepse s'po bëjnë edhe ata ndonjë punë të madhe, veçse po vazhdojnë të bëjnë investime në të njëjtat instrumente.

Rrjedhimisht, ne si Lëvizje “Vetëvendosje”, por edhe në komision ka qenë ky vendim, siç tha edhe zoti Abdixhiku unanim, e përkrahim këtë ulje të taksës, por përsëri kjo ulje e taksës nuk është në përputhje me përgjegjësitë që i kanë, definitivisht paguajmë për administrim llogarish, e jo për menaxhim të mjeteve, po flas për taksë operationale dhe kjo vazhdon prej vitit 2002, kur është themeluar Trusti i Kursimeve Pensionale. Kemi paguar njerëz në shuma të tmerrshme për punë administrative dhe kjo nuk është në rregull, në një fond i cili ka monopol në treg. Ju faleminderit dhe përkrahim uljen e taksës, gjithashtu përkrahim edhe iniciativën për themelimin e një grupi apo komisioni, i cili e trajton taksën operationale, por jo vetëm, do të insistoja që jo vetëm taksën operationale, por komplet konceptin e të hyrave, me të cilat mirëmbahet Trusti i Kursimeve Pensionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Ne si Lidhje Demokratike e Kosovës e kemi përshëndetur dhe e mbështesim faktin që taksa operationale këtë vit është më e ulët se secilin vit tjetër dhe në të njëjtën kohë nuk kemi qenë të kënaqur me shumën e pagesave që shkojnë në operationet e Trustit. Rrjedhimisht, mbështetja e bërë për Komisionin për Buxhet dhe Financa në riformulimin e pagesave vjen edhe prej Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Pra, koha kur dikush në Kosovë për një menaxhim të një fondi paguhet me 6 -7 mijë euro do të marrë fund këtë vit, këtë po e themi edhe ne dhe se brenda pak javëve, brenda muajve të parë të punës së komisionit, siç është paraparë në planin e punës që e kemi prezantuar edhe në kryesi, do t'i trajtojmë këto kërkesa dhe këtë iniciativë që është dashur të trajtohet kaherë. Fatkeqësisht, nuk është trajtuar, por ka gatishmëri të të gjitha partive politike dhe këtij Parlamenti duhet t'i vijë propozimi me taksë të re operationale dhe do të jetë në duart e deputetëve të këtij Parlamenti që të votojnë taksën e re operationale në momentin e parë që Komisioni për Buxhet dhe Financa e miraton.

Edhe një herë, modelin që do ta ndjekim në komision, në grupet punuese është modeli i nivelimit me Bankën Qendrore të Kosovës, sepse konsiderojmë se institucion më të lartë financiar në Kosovë se sa Banka Qendrore e Kosovës nuk ka dhe s'duhet të ketë dhe çdo pagesë, çdo kompensim duhet të jetë së paku në nivel të BQK-së ose më poshtë, jo më lart se atë. Dhe, ne do të konsultohemi edhe me BQK-në, edhe me Bordin e Trustit, ky Parlament e ka zgjedhur, legjislatura e kaluar në fakt dhe do të konsultohemi edhe me organizatat e tjera. Çdo deputet, çdo parti politike është e mirëseardhur të marrë pjesë në grupet tona punuese, të japë komentet e veta,

por edhe një herë si Komision për Buxhet dhe Financa një problem që ka qenë i kahershëm, pagesa e padrejtë, e lartë dhe e kushtueshme në Kosovë, 20 herë më shumë se sa paga mesatare në Kosovë, do të ketë fund këtë vit dhe jo vetëm ajo do të ketë fund, edhe beneficionet e tjera shtesë që janë bërë në Trust, të cilat i kemi vërejtur në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Prandaj, LDK-ja mbështet taksën e tanishme operationale, e mbështet idenë që është më e ulët se sa vitet paraprake. Inkurajojmë Trustin që të punojë siç ka punuar deri më tani edhe me taksat e reja që të ketë së pari për target kontribuuesin, pra që njerëzit që kontribuojnë të jetë prioriteti i fondit që kthimet e tyre të rriten pavarësisht se ku investohen ato dhe më pas të shohë edhe sigurinë e Trustit Pensional. Deri më tani ne nuk kemi parë si komision ndonjë indikacion se Trusti është në gjendje të pasigurt, në fakt, është shumë i sigurt dhe ka kthime të mira. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas radhës fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Safete Hadërgjonaj. Urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për miratimin e taksës vjetore për vitin 2018. Fondi i Kursimeve Pensionale e ka parashtruar kërkesën të bazuar në ligj për caktimin e taksës vjetore për financimin e aktiviteteve operationale dhe investive për miratim në Kuvend, duke respektuar Ligjin për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, si dhe ka specifikuar edhe shpenzimet e përlogaritura për vitin 2018 ashtu siç e parasheh ligji.

Mjetet e kërkuara për aktivitete investive për vitin 2018 janë 6 milionë e 459 mijë e 321 euro, apo 0,381% të mjeteve në menaxhim të Fondit të Kursimeve Pensionale, kurse mjetet e kërkuara për aktivitetet operationale janë 1 milion e 343 mijë e 780 euro, apo 0,071% të mjeteve në menaxhim. Në Komisionin për Buxhet dhe Financa në vazhdimësi është diskutuar çështja e këtyre dy taksave, ka pasur diskutime të llojllojshme, por njëkohësisht edhe arsyetime nga ana e përfaqësuesve të Fondit të Kursimeve Pensionale.

Ne në komision kemi vendosur që të bëjmë monitorimin e Ligjit për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës gjatë këtij viti, kemi paraparë në planin e punës, ku do të shohim mundësinë e plotësim-ndryshimeve të këtij ligji, nëse e shohim të arsyeshëm që mund të bëhet diçka më mirë edhe në menaxhimin e mjeteve, por edhe sa u përket shpenzimeve, të cilat ndodhin brenda Fondit të Kursimeve Pensionale.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka përkrahur rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratimin e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale për taksën operacionale dhe taksën investive për vitin 2018. Ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa si grup parlamentar do të japim kontributin tonë për një analizë të mirëfilltë të taksës menaxhuese, për një analizë të mirëfilltë të shpenzimeve, të cilat ndodhin në këtë institucion, si dhe do ta japim kontributin tonë edhe sa i përket nivelimit të pagave të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe? S'është paraqitur askush. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Grupi Parlamentar, e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018, duke pasur parasysh edhe kërkesën që duhet të bëhet ndryshim-plotësimi i ligjit dhe po ashtu nivelimi i pagave.

Në këtë rast ne si grup parlamentar e përkrahim kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar "Nisma", deputeti Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

"Nisma" e ka trajtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për taksën investive dhe taksën operacionale dhe e mbështesim. Po ashtu, e mbështesim nismën e Komisionit për Buxhet që të monitorojë Ligjin për Fondin dhe gjithsesi do të punojmë fuqishëm që të bëhet një nivelim i pagave në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Gjithë kontributin tonë do ta japim nëpërmjet Komisionit për Buxhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "6+", Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar "6+" e përkrah kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operacionale dhe investimeve 2018.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, kemi marrë deklaratimet e grupeve parlamentare, unë pyes përfaqësuesit e Qeverisë nëse e kërkojnë fjalën? Jo! Qeveria s'do që të deklarohet. Tash, sipas

radhës duhet t'u jap fjalën deputetëve, të cilët janë paraqitur. Së pari, fjalën e ka deputeti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të nderuar qytetarë,
Kryesues,
Kolegë,

Kur erdhi kjo kërkesë, natyrisht më është dashur të ulem dhe ta analizoj edhe në kontekst të asaj se çka prezanton. E pashë që këtu bëhet fjalë për dy taksa të ndara: e para është ajo investive dhe analiza jonë duhet më shumë të fokusohet në atë se sa është konkurrenca në tregjet financiare, kjo përqindje ose kjo vlerë që po kërkohet karshi konkurrencës dhe menaxherëve të tjerë të aseteve. Por, brenga ime ishte më e fokusuar te buxheti operacional për vitin 2018, e në fakt e përgëzoj uljen prej 1,5%. Është fatkeqësi e madhe që kjo nuk është kjo shifër -80% e jo -5%. Pse po e them këtë? Çështja e buxhetit operacional ndërlidhet me funksionet që personat në fjalë, që përfitojnë nga ky buxhet, funksionet të cilat ata i kryejnë. Unë u ula pikë së pari te shpenzimet e Bordit Drejtues dhe, para se të them se a janë të arsyeshme apo jo, unë fillimisht shkova dhe e analizova historinë profesionale të anëtarëve të Bordit të Trustit dhe pashë se vetëm një prej anëtarëve kishte përvojë që ndërlidhet me tregjet financiare.

Ne të gjithë e dimë se si emërohen njerëzit nëpër borde të ndryshme, por veçanërisht kur kemi të bëjmë me të hollat që qytetarët tanë me mundin më të madh i kanë kontribuar në këtë trust, atëherë është e udhës që, nën një, të vendosim anëtarë të Bordit që janë kompetentë për të menaxhuar me këto kursime, ose së paku nëse nuk janë kompetentë, atëherë t'u lihet përgjegjësia tërësisht këshilltarëve, ose menaxhuesve të aseteve, por të mos kemi përfitime marramendëse.

Vetëm sa për ta zbrërthyer, për këta anëtarë të Bordit alokohen diku 1 700 euro në muaj, për shtatë anëtarët. Do të thotë, këto janë përfitimet e tyre dhe për ta kuptuar edhe qytetarët dhe ne pak më mirë këtë punë, nuk po flasim për njerëzit që kanë punë me orar të plotë të të qenët anëtar i Bordit, por po flasim për njerëz që mbledhen 3-4 herë në vit, eventualisht mund të mbledhen edhe për ndonjë konferencë për shtyp për ta informuar publikun rreth të arriturave të Fondit. Mirëpo, prapë po them nuk janë persona që e alokojnë tërë kapacitetin e tyre për menaxhim dhe për punën e Trustit. Do të thotë, janë persona që këtë e kanë si angazhim anësor dhe për këtë përfitojnë 1 700 euro në muaj, që është në disproporcion të plotë edhe me pagën minimale, por edhe me pagën mesatare në Republikën e Kosovës.

Nëse vazhdohet tutje te shpenzimet e personelit, u tha më parë nga kolegët deputetë dhe u qartësua shumë mirë që po flasim për një staf, i cili nuk është i angazhuar drejtpërdrejt në menaxhimin e aseteve. Pra, këta janë një staf teknik dhe ky staf teknik përfiton përafërsisht 1 600 euro në muaj, do të thotë kjo është mesatarisht sa përfitojnë. E kuptoj që jo i tërë stafi e merr këtë rrogë, sepse me siguri menaxhmenti e ka një pagë shumë më të lartë sesa punëtorët, por duke pasur parasysh që këta nuk marrin pjesë as aktive, as pasive në menaxhimin e fondeve të Trustit

Pensional, këto paga, ose këto përfitime janë në shpërputhje totale me përgjegjësitë që i kanë, aq më tepër me përfitimet e qytetarëve tanë, qoftë si pagë minimale, apo si pagë mesatare, që mbizotëron në Republikën e Kosovës.

Pra, sikur Bordi dhe personeli i Trustit t'i menaxhonte drejtpërdrejt asetet tona, në fakt këto shpenzime do të ishin të ulëta dhe do të duhej të ngriheshin, mirëpo duke pasur parasysh angazhimin e tyre, duke pasur parasysh mungesën e kompetencës të një pjese të Bordit për t'i adresuar në mënyrë adekuate dhe profesionale dhe për të vlerësuar nëse po kryhet menaxhimi i duhur apo jo nga aset-menaxherët që janë jashtë Kosovës, atëherë unë nuk e shoh të arsyeshme që kjo taksë të jetë në vlerën që është propozuar, edhe pse është më e ulët sesa vitin e kaluar. Unë përkrah çfarëdo iniciative që është që ndërmerret për t'i rivlerësuar përfitimet e personave në fjalë dhe kësaj organizate në tërësi, vetëm një shembull konkret ku sigurimi fiduciar prej 25 500 eurove i jepet Bordit për t'i mbrojtur ata nga përgjegjësia profesionale, përderisa në fakt ata nuk marrin asnjë vendim profesional lidhur me menaxhimin e aseteve. Pra, është shpenzim i kotë.

Kështu që kërkohet një analizë e thellë e këtij buxheti. Unë nuk mund ta përkrah këtë buxhet me ndërgjegje të lehtë, sepse nuk besoj që i meritojnë 1 700 euro për person në Bord, 1 600 euro mesatarja për stafin e shpenzimeve të personelit dhe nuk mund ta përkrah këtë me ndërgjegje të lehtë dhe të lirë, veçanërisht duke pasur parasysh gjendjen ekonomike, vështirësitë buxhetore që i kemi dhe pamundësitë që ekzistojnë sot për qytetarët tanë për ta pasur edhe një rrogë të vetme minimale, e aq më tepër të lartë sikur këta zonja dhe zotërinj që janë pjesë e Trustit. Ju falënderoj për vëmendje dhe shpresoj në një rishikim të plotë të këtyre alokimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë, sinqerisht, duke dëgjuar debatin dhe duke e parë që drejtori i Trustit e ka një pagë mujore 6 000 eurove, goxha vështirë e kam të më dalin fjalët në një vend kur unë mendoj që një motër medicinale që punon dhjetë orë në spital e ka rrogën mesatare 300 euro. E kam vështirë të flas kur e di që polici i Kosovës e ka rrogën mesatare 350 euro, ndërsa një hetues i Policisë e ka rrogën mesatare 450 euro. Vështirë të bësh krahasime, kur një mjek, një neurokirurg në spital e ka rrogën mesatare diku 700-800 euro. Unë personalisht, jo që jam kundër kësaj, por po të kisha ndonjë lloj fuqie magjike si deputet komplet do ta kisha rishikuar ligjin dhe në mënyrë absolute nuk do ta miratoja një gjë të tillë.

Dikur në fillim të punës së këtij Kuvendi i kam pasur goxha shumë shpresat te "Vetëvendosja", thosha këta 32 deputetë, edhe ne këndeja disa, edhe LDK-ja disa deputetë, kështu që rezonojnë pak më normalisht, se na ka humbur normaliteti, thosha ndoshta bëjmë ndonjë farë komisioni hetimor për këto agjenci, e hetojmë korrupsionin, e hetojmë hajninë edhe në Trust, edhe në Postë, edhe në Aeroport, edhe në Agjencinë e Privatizimit, edhe në KEK, edhe kah të duash, kah

të prekësh, por tani kam ardhur në përfundim që shumica e këtyre punëve të zeza i kanë “shtikerat” bash këtu në Parlament.

Domethënë, kur ti e ke “shtikerin” e të së zezës të kyçur brenda Parlamentit dhe brenda deputetëve të Parlamentit të Kosovës, e ke vështirë të bësh diçka, sepse ne si Parlament e kemi një detyrë që t’i kontrollojmë agjencitë, e kemi detyrë ta kontrollojmë punën e Qeverisë, jo t’ia bëjmë aminin Qeverisë edhe kur punon keq. Ne s’kemi as rregullore brendapërbrenda punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Tani të mendojë një njeri normal në këtë fukarallëk kaq të madh që një njeri tjetër e ka rrogën 6 mijë euro dhe një anëtar i Bordit e ka rrogën 1 700 euro, unë si deputet i Republikës së Kosovës e kam 1 400 euro, e që mediet e hapin llafin se ku me ditë sa marrim ne, e të mos flas që shumica e gazetarëve të Kosovës e kanë rrogën mesatare 250 euro, e s’kanë fare kontrata të punës. Prandaj, shkruajnë lidhje e pa lidhje, qysh t’u thonë shefat e vet, se i ka kap fukarallëku përpara, thotë më mirë ta dëgjoj shefin çka të më thotë, të shkruaj e t’i marr 200 euro sa për ta paguar rrymën, sesa të shkoj në shtëpi.

Prandaj, krejt kjo katrahurë në të cilën ne jemi fundosur është rezultat i bllokimit total të punës së Parlamentit, i mosangazhimit të deputetëve të Republikës së Kosovës. Është rezultat që ne mendojmë veç qysh të mund të shkojmë diku jashtë sa për ta marrë ndonjë mëditje dhe nuk i lexojmë fare këto raporte, e pastaj themi “jo po e aprovojmë, jo s’po e aprovojmë..., jo jam për, jo jam kundër...” Unë personalisht jam fort kundër, por fatkeqësisht që vota ime s’mund ta rrotullojë këtë, se komplet bordet do t’i kisha ndryshuar. Asnjë bord, as Bordi i Trustit, asnjë bord në Republikën e Kosovës deri më sot nuk e ka shkarkuar asnjë drejtor hajdut. Pse? Sepse anëtarët e bordit kanë qenë edhe më hajna se drejtorët. Vidh drejtori - vidh bordi, vidh bordi - vidh drejtori! Prandaj kanë bërë aleancë hajdutët me hajdutë. Edhe sa ta vazhdojmë këtë aleancë, kështu kemi për të shkuar teposhtë sikur në ski. Kështu që unë jam absolutisht kundër kësaj, por fatkeqësisht s’kam çfarë të bëj, përveç t’i tregoj popullit të shkretë, që kuku për ju kënd na e keni zgjedhur këtu në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk e kisha në plan të flas dhe kurrësi nuk do të dal më kreative se kolegu Zeka tani me këto krahasime që i bëri shumë të arsyeshme.

Unë desha që si anëtare e Komisionit Funkcional për Administratë Publike, ndër të tjera, vetëm të jap sqarim dhe ta bashkëngjis edhe një informacion që e dha zoti Abdixhiku, që ne as nuk e kemi në plan legjislativ deri në fund gati të vitit të këtij sesi ndryshimin e Ligjit për pagat. Pra, vetëm mund të flasim, qysh e kam dëgjuar ministrin, po të ishte këtu ministri i Administratës Publike që tha se do ta përmirësojmë me ligj. Pra është e pamundur, sepse nuk do

të vijë deri në korrik, edhe kur të vijë një herë në lexim të parë e në të dytë, pastaj do të ketë diskutime. Pra, deri në fund të këtij viti vetëm mund të vajtojmë në këso forme.

Nëse do të kishte vullnet më të madh, pra të kishte qenë këtu kryeministri, unë do ta kërkoja këtë, për ta bërë një balancim të shëndoshë, tamam politik, edhe në mes të të gjithë zyrtarëve në vendin tonë, që kanë grada të njëjta e paguhen ndryshe, pra kanë vende të punës të njëjta e paguhen ndryshe-ndryshe, ne e kishim vënë në plan legjislativ shumë më herët Ligjin për pagat dhe këto ka mundësi të rregullohen. Pra, sot veç mund të flasim dhe të vajtojmë për këtë gjendje, mirëpo nëse kemi vullnet, kryeministri po të dojë e kthen në agjendë pak më të shpejtë dhe ne punojmë pak më shumë si deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, i fundit fjalën e ka kërkuar Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa për ta përmbledhur edhe një herë: Çështja e Trustit nuk rregullohet me ligje të tjera hiç, rregullohet me këtë taksë, që po e diskutojmë sot, dhe çfarë po themi edhe një herë si komision, në të cilin kemi pajtueshmëri unanime prej të gjitha partive politike, përfaqësuesit tuaj politik aty në komision, është se gjatë shkurtit, ose marsit, nëse nuk gaboj, e kemi grupin punues që merret me këtë taksë operationale dhe në momentin e parë që e përfundojmë brenda grupit punues, sepse kjo punë do pak studim, s'mund ne veç ta ulim taksën, duhet të konsultohemi pak me institucionet tjera, sa është niveli i pagave në Bord të BQK-së, sa është paga për guvernatorin atje, sa është paga për anëtarët e bordit, vijmë me një taksë të re dhe e prezantojmë në Parlament.

Më pas, është detyrim i votës së thjeshtë të këtij Parlamenti për ta votuar taksën e re dhe nëpërmjet kësaj takse të re reduktohen automatikisht edhe pagat tek anëtarët e Trustit. Pra, është e padrejtë të vendosim për t'u marrë me këtë si çështje të parë në vitin 2018 dhe brenda marsit, brenda tre muajve të parë pra të këtij viti, do ta zgjidhim këtë problem.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Ismajl Kurteshi. Urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë veç desha të them nga kjo që e tha në fund deputeti Abdixhiku, ne tani po kërkojmë ta votojmë një taksë që është e pastudiuar dhe mendoj se është e padrejtë të kërkohej prej deputetëve të votojmë diçka për të cilën nuk janë të sigurt, as komisioni dhe askush tjetër. Mendoj që duhet të ndërrohet rendi i gjërave. Së pari, të bëhet studimi, pastaj komisioni të vijë me rezultate të studimit dhe të kërkojë nga deputetët ta votojnë atë variant, të cilin ata e kanë nxjerrë në studimet që i kanë bërë. Kështu po më duket që po shkon mbrapshtë, një herë ta votojmë, e pastaj ta studiojmë, ky nuk është rendi i gjërave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj është paraqitur në ndërkohë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Besoj që edhe diskutimet e deputetëve e kanë një qëllim, i cili është për t'u respektuar, duke e marrë parasysh edhe të kaluarën, edhe tendencat që të përmirësohet sidomos çështja e pagave që janë në shpërputhje të madhe me njëra-tjetrën. Është biseduar edhe në të kaluarën, por si duket nuk ka vullnet të përgjithshëm, duke i marrë për bazë interesat e ngushta dhe tash logjikën e kësaj Qeverie, sidomos me rritjen e pagave që ka ndodhur me frymën e njëjtë, siç ka vepruar Trusti Pensional i Republikës së Kosovës.

Me vite të tëra nuk është ditur se sa paguhen anëtarët e Trustit Pensional, udhëheqësit apo edhe vetë trupat menaxhuese që janë aty. Nuk është vetëm çështja e pagave. Çështja është edhe e beneficioneve që gëzojnë ata dhe të cilat ia ndajnë vetvetes pa pasur një bazë strikte ligjore, duke i mundësuar vetvetes shuma marramendëse në krahasim me organizatat tjera buxhetore që paguhen apo institucionet në Republikën e Kosovës.

Andaj, një studim i mirëfilltë, por edhe një vullnet ndryshe, jo duke ruajtur individë të caktuar, qoftë brenda Trustit Pensional, apo qoftë edhe brenda bordeve të ndryshme të tjera për ta lënë në pafundësi zgjidhjen e kësaj problematike. Kjo është shndërruar në gangrenë të Buxhetit të Republikës së Kosovës, është shndërruar në një monopol dhe njëherë e përgjithmonë duhet t'i japim një kah. Nëse pritet Ligji për nivelimin e pagave, kjo nuk do të ndodhë.

Unë edhe këtu publikisht po e përmend, me këtë Qeveri nuk do të ndodhë, nuk ka ndodhur as në të kaluarën, por nuk do të ndodhë as tash. Kështu që është në dorën e deputetëve, në vullnetin e deputetëve, i bie përgjegjësia ndoshta edhe Komisionit për Buxhet nëse mund ta shtyjë këtë gjë përpara, por ajo që shihet dhe që ka qenë evidente, kësaj organizate buxhetore ia kanë lakmi edhe bordet e shteteve që ndoshta janë më të zhvilluarat, sesi paguhen e si trajtohen këto taksa, që janë paratë e taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kolegë të tjerë të paraqitur për fjalë, kështu që unë propozoj që të shkojmë drejtpërdrejt në procesin e votimit.

Në sallë janë 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

A ka deputetë pa kartelë? Nuk ka!

Atëherë, në këtë proces votimi kanë marrë pjesë 62 deputetë. 50 janë për, 8 kundër dhe 4 abstenime edhe 1 pa kartelë, 9 kundër. Do të thotë 63 deputetë kanë marrë pjesë në votim.

Konstatoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi kërkesën e fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operationale prej 0,071% dhe taksës investive prej 0,331% për vitin 2018. Faleminderit!

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb.

Gjithashtu, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar 2018, ka vendosur që Komisioni ad hoc, i cili do të formohet në këtë seancë t'i shqyrtojë edhe aplikacionet e kandidatëve për një anëtar të këtij bordi nga komuniteti shumicë, do të thotë nga komuniteti shqiptar.

Tani unë ftoj kryetarët, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb dhe për një anëtar të Bordit nga komuniteti shumicë, shqiptar. E ftoj kryetarin, ose përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që t'i propozojë tre anëtarë. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Për pjesëmarrje në këtë komision i propozoj deputetët: Fitore Pacolli, Valon Ramadani dhe Sali Zyba.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së i ka propozuar për kryetar dhe anëtarë të komisionit, Imet Rrahmanin kryetar dhe Lirije Kajtazin anëtare. Ndërkaq, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka propozuar zëvendëskryetarin e parë dhe një anëtar, do të thotë për zëvendëskryetar të parë Nait Hasanin dhe për anëtare deputeten Blerta Deliu-Kodra.

Grupi Parlamentar i Listës serbe e ka propozuar zëvendëskryetarin e dytë, zotin Igor Simiq. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka propozuar një anëtar, deputetin Rasim Selmanaj.

E ftoj kryetarin, ose përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të “Nisma për Kosovën” që ta propozojë një anëtar, deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Kryesues!

Me sa e di unë, ne e kemi dhënë emrin e Milaim Zekës atëkohë kur është kërkuar, si duket është përvjedhur diçka në Administratë. Është Milaim Zeka.

KRYESUESI: Atëherë, Milaim Zeka. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “6+” që ta propozojë një anëtar. Fjalën e ka deputetja Duda Balje, si përfaqësuese e grupit.

DUDA BALJE: Po, faleminderit!

Grupi Parlamentar “6+” e propozon zotin Albert Kinolli për anëtar të komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë propozoj që të votojmë menjëherë, meqë... Po? Do t’ia jap fjalën edhe një herë deputetit Glauk Konjufca për një sqarim.

GLAUK KONJUFCA: Për shkak se ka ndodhur një gabim teknik, kemi të bëjmë me emra të tjerë në këtë komision. Për shkak të anëtarëve që i përkasin vetë komisionit që ka lidhje me mediet dhe me Administratën, duhet të jenë Shqipe Pantina, Fisnik Ismaili dhe Valon Ramadani.

KRYESUESI: Në rregull. Faleminderit! Atëherë, lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! A ke deputetë pa kartelë? Nuk ka! Atëherë, në këtë votim kanë marrë pjesë 69 deputetë. 69 janë për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti serb dhe një anëtar të këtij Bordi nga komuniteti shumicë shqiptar.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc që të veprojë në përputhje me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës. Faleminderit!

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit për Ankesa

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 dhjetor 2017, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t’i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Ankesave.

Tani unë i ftoj kryetarët, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që t’i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Ankesave. Së pari, e ftoj kryetarin, ose përfaqësuesin, e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që ta propozojë zëvendëskryetarin e parë dhe dy anëtarë. Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, zëvendëskryetare e parë e këtij komisioni le të jetë deputetja Shqipe Pantina, kurse si anëtarë le të jenë Valon Ramadani dhe Fisnik Ismaili.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar dy anëtarë, deputetin Arben Gashi dhe deputetin Armend Zemaj, ndërkaq Grupi

Parlamentar i PDK-së i ka propozuar kryetarin dhe një anëtar, Xhevahire Izmaku kryetare, Andin Hoti anëtar.

Grupi Parlamentar i Listës serbe e ka propozuar për anëtare deputeten Jelena Bontiq; Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka propozuar për anëtar deputetin Rasim Selmanaj. Unë nuk e kam përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të “Nisma për Kosovën”, kështu që kërkoj nga kryetari i Grupit Parlamentar “Nisma” që ta propozojë një anëtar në këtë komision. Deputeti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: E propozoj deputetin Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka kërkuar deputetja Duda Balje. Urdhëroni!

DUDA BALJE: Zoti Albert Kinolli.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqë e kemi kompletuar listën e emrave, procedojmë me votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

A ka deputetë pa kartelë? Nuk ka të deklaruar.

Atëherë, në votim kanë marrë pjesë 71 deputetë. Të gjithë janë për, nuk ka asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar në Bordin e Ankesave.

Kërkohet nga ky komision që të veprojë në përputhje me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve.

Tani me këtë unë mbyll punimet e kësaj seance.

Meqë Kryesia e ka caktuar edhe një seancë tjetër të re, unë propozoj që ne ta vazhdojmë menjëherë punën, meqë kemi edhe kuorum, me pikat jashtë rendit të ditës, pastaj të marrim pauzë dhe të vazhdojmë sipas rendit të ditës që e ka përgatitur Kryesia e Kuvendit. Nëse pajtoheni, do të vazhdonim menjëherë.

Atëherë, i pyes përfaqësuesit e grupeve parlamentare, kryetarët e grupeve parlamentare. Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Ne propozojmë që të ketë një pauzë, megjithatë, ndërmjet këtyre dy seancave dhe të vazhdohet pas një ore.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, deputeti Armend Zemaj me kartelën e Avdullah Hotit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Zoti nënkryetar, mendoj se duhet t'i përmbahemi orarit, ashtu edhe jemi të përgatitur. Nuk kemi çfarë hyjmë në pikat paraprake pa qenë Qeveria e pranishme. Pyetjet parlamentare, është edhe interpelanca, kështu që ne dëshirojmë t'i përmbahemi orarit në fjalë.

KRYESUESI: Nga PDK-ja, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne i mbështetim kolegët e dy grupeve tjera parlamentare. Besoj që mund të shkojmë në pauzë tash dhe të vazhdojmë prej orës 14:00, siç ka qenë e paralajmëruar edhe në dokumentet e seancës tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe e ka kërkuar fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Parlamentarna grupa Srpska lista podržava predlog da narednu sednicu nastavimo u 14:00 časova. Hvala!

KRYESUESI: Nga AAK-ja, Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Edhe ne pajtohemi që seanca të vazhdojë në orën 14:00.

KRYESUESI: “Nisma për Kosovën”, Bilall Sherifi!

BILALL SHERIFI: Po, edhe “Nisma” pajtohet me këtë propozim.

KRYESUESI: “6+”, Albert Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” pajtohet me propozimin e parafolësve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, shihemi në orën 14:00.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*